


**UDHËZUES PËR
ORGANIZATAT E
SHOQËRISË CIVILE TË
CILAT MBËSHTESIN
FËMIJËT DHE TË RINJTË
ROM DHE EGJIPTIANË NË
BALLKANIN PERËNDIMOR**





**UDHËZUES PËR
ORGANIZATAT E
SHOQËRISË CIVILE TË
CILAT MBËSHTESIN
FËMIJËT DHE TË RINJTË
ROM DHE EGJIPTIANË NË
BALLKANIN PERËNDIMOR**

Autori: Znj. Violeta Kola

Publikoi: ARSIS, 2017.

Të drejtat e Autorit © ARSIS, 2017.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e publikimit nuk mund të riprodhohet, korigjohet, ose të transmetohet në ndonjë formë ose nga ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjimi, regjistrimi ose tjetër, pa pëlqimin paraprak të autorit.



Ky publikim u hartua në kuadër të projektit “Rreziku i të Rinjve nga përjashtimi i shoqërisë” financuar nga Bashkimi Evropian. Bashkimi Evropian jo detyrimisht ndan të njëjtat pikëpamje me ato të paraqitura në këtë publikim.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje: Informacion i Përgjithshëm mbi Udhëzuesin	6
2. Përmbledhja Ekzekutive	8
3. Fjalori	10
4. Përmbledhje e situatës në vendet e Ballkanit Perëndimor, bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe normativën ligjore kombëtare	12
5. Të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në rajon dhe në secilin	15
5.1 Situata e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në secilin vend dhe në rajon	17
6. Përgjegjësitë dhe detyrat e ndërmarra nga OJQ-të për të siguruar mbrojtjen, zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë	22
6.1. Detyrat e ndërmarra nga OJQ-të në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe pabarazia shoqërore. Një tjetër rol i ndërhyrjes së OJQ-ve krahasuar me funksionet e institucioneve shtetërore	22
6.2. Bashkëpunimi dhe partneriteti për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të të rinjve të rrezikuar Rom dhe Egjiptianë	25
7. Shërbime alternative për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë	28
7.1. Parimet e detyrueshme të Organizatave Jo Fitimprurëse mbi ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë	28
7.2. Proçedurat (e Rekomaduar) në lidhje me qasjen e adaptuar ndaj fëmijëve dhe të të rinjve Rom gjatë ofrimit të shërbimeve	29
7.3. Shërbimet mbështetëse të drejtpërdrejta, që OJQ-të mund të ofrojnë, për fuqizimin e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë	30
7.3.1. Fuqizimi i fëmijëve dhe i të rinjve Rom dhe Egjiptianë nëpërmjet fuqizimit të familjeve të tyre	30
7.3.2. Fuqizimi i komunitetit Rom dhe Egjiptianë me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut për zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve	33
7.3.3. Shërbimet mbështetëse, për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, në komunitetin e tyre, qendrat sociale të kujdesit ditor dhe të rrugëve	35
8. Standartet e punës së OJQ-ve me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë	40
9. Parimet dhe vlerat e përgjithshme të punës, Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve, Protokollin për ruajtjen e fëmijëve dhe të të rinjve, Kodi i Sjelljes dhe Etikës	44
9.1. Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve	44
9.2. Protokollin për sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve	51
9.3. Kodi i Sjelljes dhe Etikës për punonjësit që u ofrojnë shërbime fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë	58
9.4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjve nëpërmjet përzgjedhjes së stafit (Udhëzime dhe proçedura për OJQ-të)	60
9.5. Kodi Profesional i orfruesve të shërbimeve, fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë	63
10. Konkluzionet e përgjithshme të punës, me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, të Organizatave të Shoqërisë Civile	65
11. Rekomandime	66
12. Bibliografia dhe Referencat	68
13. ANEKSET	71

1. HYRJE: Informacion i përgjithshëm mbi Udhëzuesin

Udhëzuesi u drejtohet në mënyrë të veçantë Organizatave Jo Qeveritare (OJQ-të) që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë e rrezikuar Rom dhe Egjiptianë, por gjithashtu u adresohet edhe organizatave, institucioneve apo personave të tjerë që punojnë me fëmijët/të rinjtë Rom dhe Egjiptianë dhe që e zotërojnë ndjenjën e përgjegjësisë për integrimin dhe mbrojtjen e tyre kundër diskriminimit, dhunës, abuzimit, neglizhencës ose shfrytëzimit. Udhëzuesi mund të shërbejë dhe si instrument për ata që ofrojnë ose praktikojnë dhënien e shërbimeve sociale, duke demonstruar sesi ata mund t'u vijnë në ndihmë dhe t'u japin mbështetje fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Ky dokument i publikuar jep rekomandime mbi vendosjen e standarteve më të mira, teknike dhe proceduriale që duhen aplikuar në punën e OJQ-ve ose të Organizatave të ngjashme, dhe që mund të bëjnë të mundur një mbrojtje më të mirë të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë me anë të ofrimit të shërbimeve me cilësi dhe standarte më të larta. Udhëzuesi synon zhvillimin e këtyre standarteve dhe procedurave të cilat rekomandohen të njihen, të ndiqen dhe të zbatohen nga OJQ-të duke ua ofruar shërbimet fëmijëve dhe të rinjve të rrezikuar Rom dhe Egjiptianë por edhe fëmijëve dhe të rinjve të tjerë të cilët kanë nevojë të mbrohen dhe të integrohen në Shoqëri. Udhëzuesi vë theksin tek ato praktika të mira që tashmë aplikohen nga OJQ-të dhe organizatat e tjera të komunitetit Rom që sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve/e të rinjve Rom dhe Egjiptianë të cilët rrezikojnë përjashtimin nga shoqëria.

Parimi më kryesor i këtij Udhëzuesi, në fund të fundit është përfitimi, nga fëmijët dhe të rinjtë, i interesave më të mira.

Vizioni i tij është krijimi i një mjedisi të favorshëm, për edukimin e sigurt dhe të shëndetshëm të fëmijëve dhe të të rinjve, duke inkurajuar potencialin e tyre të plotë fizik dhe psiko-social, për pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat e shoqërisë që ndikojnë në jetën e tyre dhe për garantimin e një vlerësimi të progresit të arritur, i realizuar në përputhje me të drejtat e njeriut në fushat kryesore të shërbimeve publike, që kanë të bëjnë me fëmijët / të rinjtë¹.

Udhëzuesi nxjerr vlerën e saj brenda kuadrit të projektit "Fuqizimi Social i të Rinjve në Rrezik" (ARYSE) i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga rrjeti i OJQ-ve të Ballkanit Perëndimor, që kanë punuar me fëmijët dhe të rinjtë e rrezikuar nga përjashtimi social për vite me radhë. Projekti drejtohet nga OJQ (NGO) Juventas (Mal i Zi) dhe partnerët e tjerë në këtë projekt janë: ARSIS (Shqipëri), Organizata Margina (Bosnjë dhe Hercegovina), HOPS (Maqedoni), Labyrinth (Kosova), Prevent (Serbia) dhe Fondacioni SHL në Gjermani. Projekti trajton çështjet problematike që prekin fëmijët dhe të rinjtë të cilët janë në kontakt/konflikt me ligjet dhe rregullat, përdorin drogë, jetojnë

¹ Axhenda Kombëtare, për të Drejtat e Fëmijëve, Shqipëri 2017-2020 - (The Albanian National Agenda for Children's Rights 2017-2020 in English)

në familje që janë në kontakt/konflikt me sistemin ligjor dhe/ose përdorin drogë, fëmijët e braktisur në rrugë, fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë si edhe fëmijët që nuk gëzojnë kujdestarinë e prindërve.

Udhëzuesi përbëhet nga 8 kapituj, të cilët paraqesin të gjitha shqetësimet dhe problematikat e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në rajon, nismat e ndërmarra nga qeveritë për përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Udhëzuesi rekomandon disa procedura, teknika dhe ndërhyrje të caktuara operative që OJQ-të mund të vënë në zbatim me qëllim minimizimin e diskriminimit, pabarazisë, shfrytëzimit dhe të përjashtimit social të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Udhëzuesi është produkt i nxjerrë nga një proces i vazhdueshëm këshillimi dhe konsultimi me partnerët brenda rjetit dhe duke konsideruar të gjitha dokumentet ndërkombëtare, raportet, studimet, sondazhet në rajon dhe legjislacionin kombëtar mbi të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë. Udhëzuesi bazohet në praktikën më të mirë rajonale dhe ndërkombëtare mbi përfshirjen, zhvillimin dhe integrimin social të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Ky dokument nuk i përmend të gjitha metodat, teknikat dhe rrugët e ndryshme, që disa OJQ kanë ndjekur gjatë gjithë kohës për sigurimin dhe mbrojtjen e atyre në nevojë, veçanërisht të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë. Ky dokument parashtron disa udhëzime të cilat mund të përdoren nga OJQ-të, në mënyrë që të bëhet lehtësisht i mundur misioni i tyre, për mbrojtjen, zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë me të drejtat e tyre të barabarta, pa vuajtur nga diskriminimi, veçimi ose etiketimi.

2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në Ballkanin Perëndimor, çështja e komunitetit Rom, mbrojtja e të drejtave të tyre dhe përfshirja në shoqëri si të barabartë shihet si një proces i vazhduar dhe tentativë serioze për zhvillimin e demokracisë shoqërore. Vëndet në rajon kanë ratifikuar Konventën Ndërkombëtare dhe dokumente të tjera me qëllim që t'u ofrojnë mbrojtje Romve dhe grupeve të tjera në rrezik. Për më tepër, vendet e Ballkanit Perëndimor u bënë pjesë e Dekadës së Përfshirjes së Romve 2005-2015 dhe Kuadrin e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romve deri në vitin 2020. Dekada e Përfshirjes së Romve është një iniciativë politike e cila synon çrrënjosjen e diskriminimit dhe të të gjitha pengesave që i kalojnë Romët në disavantazh krahasuar me pjesën tjetër të shoqërisë. Fokusi i saj konsiston në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, strehim, mbrojtje dhe përfshirje sociale. Brënda kuadrit të Dekadës së Përfshirjes Sociale të Romve, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor hartuan Strategjitë e tyre Kombëtare për Integrimin e Romve dhe Planet e Veprimit për mbrojtjen, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e Romve dhe të grupeve të tjera në rrezik. Brënda po këtij kuadri, vëndet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar progres të mirë në adaptimin dhe fuqizimin e legjislacionit në lidhje me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të komunitetit Rom. Këto vende kanë ndryshuar ose kanë hartuar ligje të reja posaçërisht për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Ka pasur një angazhim serioz nga vëndet e rajonit për të mbrojtur, zhvilluar dhe integruar fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, grupet e tjera në rrezik si dhe individët në shoqëri, përmes zbatimit të legjislacionit dhe shumë politikave dhe programeve socio-ekonomike. Ky progres tregohet në të gjitha vëndet e rajonit duke i krahasuar me një dekadë më parë. Por ky progres është akoma i brishtë dhe i kthyesëm.

Progresi i arritur deri tani është shumë i vogël krahasuar me përhapjen dhe përkeqësimin e fenomenit të përjashtimit nga shoqëria e cila prek tërë komunitetin Rom, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë të cilët janë më të prekshëm dhe të pambrojtur nga përjashtimi social. Ata vazhdojnë të jenë të lënë pas dore, të dhunuar, të shfrytëzuar nga familjet e tyre, të diskriminuar dhe të pambrojtur në mjediset shoqërore dhe në rrezik të madh duke jetuar të bllokuar në rrugë. Treguesit për këtë situatë janë kushtet e dobëta të jetesës, mungesa e kujdesit shëndetësor, niveli i ulët i aksesit në sistemin arsimor, shkalla e lartë e papunësisë së të rinjve, diskriminimi dhe shkalla e ulët e qasjes në tregun e punës, mungesa e arsimit profesional dhe kualifikimit si dhe mbrojtja e pamjaftueshme sociale dhe ligjore.

OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në njohjen, gjetjen dhe lehtësimin e çështjeve sociale dhe problematikave shqetësuese që prekin fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë. Ka një marrëdhënie të ngushtë dhe bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve, veçanërisht ndërmjet OJQ-ve Rome dhe komunitetit Rom. Këto organizata luajnë një rol tepër të rëndësishëm dhe janë aktorët potencial kyç në luftën kundër diskriminimit dhe përjashtimit social të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor gjenden një numër i konsiderueshëm i Organizatave Rome dhe jo Rome, të cilat operojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, fokusi i tyre është, mbrojtja, zhvillimi dhe integrimi i fëmijëve dhe i të rinjve Rom dhe Egjiptianë në jetën sociale. OJQ-të, në shumë drejtime, janë ofruesit kryesorë të shërbimeve siç janë, mbështetja praktike, informimi, këshillimi, shërbimet shëndetësore dhe sociale si dhe këshillat ligjore. OJQ-të ushtrojnë ndikim të madh në sigurimin e praktikave dhe modeleve më të mira për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë. Aktivitetet e tyre tregojnë një përmirësim mjaft të madh, në rajon, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në veçanti.

Aktivitetet e tyre kanë patur një ndikim mjaft të madh në zvogëlimin e pabarazisë në aspektin e zhvillimit njerëzor dhe ekonomik të komunitetit Rom dhe Egjiptianë, si dhe në zvogëlimin e hendekut ekzistues midis kushteve të jetesës dhe të mirëqënies së popullit Rom dhe jo Rom².

Mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjve, si dhe promovimi i mirëqënies së tyre është përgjegjësi e të gjithëve duke përfshirë, në procesin e vendim marrjes, të gjitha strukturat dhe shërbimet. Duke patur parasysh këtë, cilido qoftë në kontakt me fëmijën duhet të luajë një rol tepër aktiv në identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjes dhe ofrimin e ndihmës konkrete në një mënyrë të koordinuar dhe bashkëpunuese. Të gjitha institucionet përkatëse dhe profesionale duhet ta dinë rolin e tyre dhe të profesionistëve të tjerë, me qëllim që bashkëpunimi të jetë sa më efektiv.³

2 http://ec.europa.eu/governance/social-ngos_en.pdf

3 Udhëzues i procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme & referimin e fëmijëve në situatë rruge, OSCE, Tiranë 2015

3.FJALORI

Lista e terminologjisë kryesore dhe përkufizimet e tyre lidhur me përmbajtjen e këtij dokumenti.

Fëmijë - Konventa përcakton si fëmijë një person nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur ligjet e një vendi të caktuar, vendosin si moshë ligjore për të rritur, një moshë më të re. (Konventa mbi të Drejtat e fëmijës e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Neni 1, 2 Shtator 1990)

Të Rinjtë – Kombet e Bashkuara përcaktojnë si rini ato persona që gjenden midis moshës 10-24 vjeç. Megjithatë, sipas Këshillit Evropian një person deri në moshën 30 vjeç konsiderohet gjithashtu i ri. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor përcaktojnë si rini grupmoshat 15/16 – 30 vjeç.

Fëmijë/të rinj – në këtë dokument termi “fëmijë” dhe “të rinj”, të shkrirë në një binom, Kombet e Bashkuara dhe Këshilli Evropian, përcakton grupmoshat 10-18 dhe 15-18, ndërsa Konventa për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara, në Nenin 1, datë 2 Shtator 1990 grupmoshat e lartpërmendura i përkufizon si fëmijë.

Fëmijë në rrezik - përcaktohet “fëmija” që vuan privimin ose shkeljen e të drejtave dhe të mbrojtjes siç është përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Fëmija nuk është në gjendje të kujdeset për vete ose për arsye të ndryshme ka kapacitete të vogla për t’u kujdesur për veten.

Të rinj në rrezik- përcaktohet “i ri në rrezik” ai që vuan privimin ose shkeljen e të drejtave dhe të mbrojtjes siç është përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për shkak të kushteve të jetesës: kur është i pastrehë, i braktisur, i varur nga substancat narkotike, i papunë ose punon në rrezik të lartë si dhe kur është në kontakt / konflikt me ligjin.

Mbrojtja e fëmijës – është përcaktuar veprimi i ndërmarrë kundër të gjitha formave të dhunës, që ushtrohen ndaj fëmijës, siç janë abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhenca, rrëmbimi, shfrytëzimi seksual, puna e rëndë, trafikimi si dhe praktikat e tjera të dëmshme tradicionale si gjymtimi i organeve gjenitale dhe martesat e fëmijëve.

Interesi më i mirë i fëmijës/të rinjve – Duhet të jetë shqetësimi kryesor në marrjen e vendimeve që mund të prekin ato.

Konfidencialiteti – I gjithë informacioni i mbledhur gjatë ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimit të rasteve, të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijëve/të rinjve dhe për ti mbrojtur ata nga dëmtimi dhe rreziku. Mënyra ose gjendja e mbajtjes së informacionit të fshehtë ose privat duke mos e përhapur ose përdorur këtë informacion për asnjë lloj arsyeje, përveç asaj për të cilën është siguruar.

Abuzim i Fëmijës: Abuzimi ose keqtrajtimi, përbën të gjitha format e abuzimit fizik dhe/ose emocional ose seksual, neglizhenca ose shfrytëzimi tregtar i fëmijëve, që rezultojnë të gjitha të jenë në dëm të gjendjes shëndetësore, rrezikojnë jetën e tyre, çenojnë zhvillimin, ose dinjitetin e tyre në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie ndaj fëmijëve, marrëdhënieje besimi, ose marrëdhënieje autoriteti. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1999)

Parandalim: – Akti ose mënyra e zbatimit të politikave për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve/të rinjve nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë ndaj abuzimit dhe ndaj rreziqeve kërcënuese të fëmijëve / të rinjve.

Diskriminimi: është veprimi që përkufizohet si një sjellje negative e pajustificuar ndaj një grupi ose

anëtarë të cilët identifikohen në grup.

Ngacmimi - përcaktohet një mënyrë keqtrajtimi agresiv dhe i mërzitshëm i kryer në mënyrë të vazhdueshme, nga një fëmijë ose grup fëmijësh, kundrejt një fëmije tjetër i cili konsiderohet i pambrojtur ose i pafuqishëm për të reaguar.

Veçimi - është tërësia e akteve ose lënia e dikujt mënjanë, për shkak të varfërisë, përkatësisë etnike, besimit dhe qëndrimit.

Përrjashtimi shoqëror – konsiderohet veprimi i përrjashtimit nga sistemi shoqëror mbizotërues dhe nga të drejtat dhe privilegjet e tij, zakonisht si rezultat i varfërisë ose faktit që i përket një grupi shoqëror minoritar.

Braktisja - është fenomeni i tërheqjes së mbështetjes ose heqjes së ndihmës nga dikush, pavarësisht detyrimit, besnikërisë ose përgjegjësisë.

Neglizhenca - është dështimi kronik për të siguruar zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat: në shëndetësi, arsim, zhvillim emocional, ushqim, strehim dhe kushte të sigurta jetese, në kontekstin e burimeve normale, që familjet ose kujdestarët kanë në dispozicion, dhe shkaktojnë ose kanë shumë mundësi të shkaktojnë dëmtim të shëndetit të fëmijës ose zhvillimit fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror.

Shfrytëzimi – Shfrytëzimi, qoftë tregtar qoftë çdolloj tjetër, i një fëmije, i referohet përdorimit të fëmijës/të të rinjve në punë ose aktivitete të tjera me qëllim përfitimi. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, punën dhe prostitucionin e fëmijëve, punën ose shërbimet e detyrueshme, skllavërinë ose mënyrat e ngjashme, dhe heqjen e organeve të fëmijëve.

Standart - i referohet të gjitha kriterëve, niveleve të cilësisë dhe karakteristikave të përcaktuara si rregullore në ofrimin e shërbimeve të ndryshme.

Përfituesi - një person, fëmijë ose një i rritur i cili gëzon të drejtën e përfitimit të diçkaje, si për shembull të një shërbimi apo të një ndihme financiare.

Menaxhim rasti: është një proces i ofrimit të shërbimeve ndaj një fëmije i identifikuar si rast që ka nevojë për përkujdesje, mbrojtje dhe mbështetje. Është një sistem i standartizuar i përdorur për rastet në rrezik, në mënyrë që ato të trajtohen me kompetencë, në kohë dhe në përputhje me standartet e ofrimit të shërbimeve.

Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore: Çdo fëmijë ka të drejtë të gëzojë shëndetin më të mirë të mundshëm. Qeveritë duhet të sigurojnë një kujdes shëndetësor me cilësi të lartë, ujë të pastër, ushqim të ngrënë dhe një mjedis të pastër në mënyrë që fëmijët të mund të qëndrojnë të shëndetshëm. (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 24).

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës: Qeveritë duhet të bëjnë gjithçka që munden për të siguruar që fëmijët të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe keqtrajtitimit nga prindërit e tyre ose nga çdokush tjetër që kujdeset për ta. (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 19).

Rasti/et: Fëmijët /të rinjtë dëshmojnë të jenë në një situatë me rrezik të lartë dhe se kanë nevojë urgjente për mbrojtje.

Rast emergjent: Fëmija /i riu konsiderohet si rast emergjent kur nuk i është dhënë asnjë trajtim mjekësor ose tjetër dhe si pasojë, i kërcënohet jeta nga një dëmtim i rëndë, mund të shkaktohet një dëmtim i përhershëm ose i nënshtrohet një keqtrajtimi që konsiderohet si vepër penale.

Pjesëmarrja: Çdo fëmijë duhet të jetë i lirë të thotë çfarë mendon, ndjen dhe dëshiron si dhe merr pjesë në vendimmarrje për çështje që ndikojnë në jetën e tyre.

4. Përmbledhje e situatës në vendet e Ballkanit Perëndimor, bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe normativën ligjore kombëtare

Cështja e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit Rom ose Cigan siç i referohemi zakonisht, u trajtua zyrtarisht për herë të parë në vitin 1977 në Rezolutën e Nënkomisionit të OKB-së për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjes së Minoritetit Rom. Më vonë, në gusht të vitit 1991, Nënkomisioni tërhoqi vëmendjen për mbrojtjen e komunitetit Rom dhe të drejtat e tyre civile, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Të gjitha përpjekjet dhe gjykimet për mbrojtjen e komunitetit Rom u intensifikuan me Rezolutën "Për mbrojtjen e Romve (Ciganëve)", e miratuar më 4 mars 1992 nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Ndër të tjera, Rezoluta ftoi shtetet që të miratojnë të gjitha masat e nevojshme me qëllim shmangien e çdo lloj diskriminimi ndaj komunitetit Rom. Fakti, që Bashkimi Ndërkombëtar i Romve, në mars të vitit 1979, u njoh nga Kombet e Bashkuara, si një OJQ që përfaqëson komunitetin Rom, dhe në mars të vitit 1993 u klasifikua si një OJQ e kategorisë së dytë, përforcoi të gjitha përpjekjet për çështjen e Romve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre nga të gjitha vendet e Evropës, duke përfshirë këtu edhe vendet e Ballkanit Perëndimor⁴. Një përparim i madh u bë në vitet 2010 dhe 2011, lidhur me zhvillimin e disa angazhimeve aktuale nga institucionet evropiane, ndërkohë që ballafaqohesh me çështjen e përjashtimit të komunitetit Rom. Kuadri i BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romve deri në vitin 2020 përbën një lëvizje e cila u kërkua nga, aktivistët Rom në të gjithë Evropën. Këshilli i Evropës, me anë të "Deklaratës së Strasburgut", u kërkoi autoriteteve politike të ndërmarrin veprime dhe masa konkrete, për popullin Rom, për trajtimin e kësaj çështje shqetësuese⁵.

Projekti i parë, ku morën pjesë shumë shtete të Evropës, dhe që synonte përmirësimin e stilit dhe kushteve të jetesës së popullit Rom, reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit nga shoqëria, përmes reformave politike dhe programeve, ishte Dekada e Përfshirjes së Romve që zgjati nga 2005 deri në vitin 2015. Dekada ishte një angazhim politik i nëntë shteteve të Evropës Qendrore dhe Juglindore për të zvogëluar pabarazinë në aspektin e zhvillimit njerëzor dhe ekonomik të popullit Rom, lehtësimin dhe zvogëlimin e hendekut ekzistues midis kushteve të jetesës dhe mirëqënies së popullit Rom dhe atij jo Rom. Ajo u angazhua intensivisht në ndërmarrjen e aksioneve kundër varfërisë dhe përjashtimit social duke zbatuar reformat politike dhe programet e hartuara për "çrrënjosjen" e rrethit vicioz të varfërisë, skamjes dhe të përjashtimit social, në të cilin, gjejnë veten shumë Rom. Nëntë vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore të cilat ishin partnere në këtë projekt, zhvilluan një Plan Veprimi Kombëtar për Dekadën që përcaktonte qëllimet dhe treguesit në fushat prioritare të Dekadës Rome: Arsim, Punësim, Shëndetësi dhe Strehim fusha këto të cilat janë identifikuar si katër "fusha prioritare" edhe brenda Kuadrit Normativ të BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romve deri në vitin 2050⁶.

Strategjitë Kombëtare të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore së bashku me Planet e tyre të Veprimit për zbatimin e Strategjive të hartuara brenda Kuadrit Normativ të Dekadës së Romve (me përjashtim Kosovën) dhe qasja strategjike në Evropa 2020, mbulon çdo zonë që jetohej nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë si dhe të rinjtë që gjenden në rrugë. Këto dokumente të cilat bazohen

4 Ma. Elisabeta Osmanaj: "E drejta për arsim të komunitetit Rom në kuadrin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian". - "The right to education of the Roma community in the framework of the integration of the Republic of Albania into the European Union".

5 Raport: Të drejtat njerëzore të komunitetit Rom dhe Komuniteteve shtetëtare në Evropë, Këshilli i Evropës, Shkurt 2012. - Human Rights of Roma and Travelers Communities in Europe, Council of Europe, February 2012

6 Dekada e përfshirjes së Romve Shqipëri-PKV 2010-2015 - (Decade of Roma Inclusion in Albania - PKV 2010-2015)

në mënyrë thelbësore, në të drejtat e njeriut, veprojnë si një nxitje për qeveritë për të gjetur zgjidhje për të gjitha shqetësimet që prekin fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, strehimit, mbrojtjes dhe përfshirjes shoqërore.

Këto dokumente janë një orientim i mirë në ndërmarrjen e veprimeve në fusha të caktuara të politikave specifike për komunitetin Rom dhe Egjiptianë si regjistrimi civil, aksesimi në drejtësi, arsimit, dialogu ndërkulturor, punësimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, mbrojtja sociale dhe pjesëmarrja në vendimmarrje, etj. Të gjitha vendet e rajonit po punojnë me Njësinë e Veprimit për Integrimin e Romve të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) 2020 (RI 2020) për të zhvilluar standarte rajonale për buxhetin e politikave të integritit Rom dhe Egjiptianë⁷.

Të gjitha vendet e rajonit kanë ratifikuar të gjitha traktatet universale ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Legjislacioni dhe praktikat përkatëse kombëtare janë në përputhje të plotë dhe sipas sistemit ligjor të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale në katër fushat e përmendura. Parimet themelore të anti-diskriminimit janë të përfshira në Kushtetutën e Ballkanit Perëndimor dhe në të gjithë legjislacionin dhe dokumentet përkatëse. Pavarësisht mënyrave dhe formave të ndryshme të trajtimit të diskriminimit në përgjithësi dhe diskriminimit të pakicave në veçanti, Kushtetuta e vendeve të Ballkanit Perëndimor ka marrë një angazhim serioz për sigurimin dhe garantimin e barazisë për të gjithë qytetarët në aspektin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, strategji të mira mbi të drejtat e pakicave dhe barazisë gjinore. Kushtetuta e Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës kanë lejuar në një mënyrë apo tjetër mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lirive themelore, barazisë dhe integritit të popullsisë Rome dhe Egjiptianëve ose të pakicave dhe grupeve të tjera. Shihet të tregohet një kujdes i veçantë në çështjen e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të këtij komuniteti në procesin e vendimmarrjes.

Në të gjitha vendet e rajonit është bërë një përparim i mirë në miratimin e legjislacionit që synon mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të popullsisë Rome. Të gjitha vendet kanë miratuar Ligjet për anti-diskriminimin, kanë krijuar institucione të veçanta për trajtimin e të gjitha pretendimeve për diskriminim dhe kanë miratuar ligje për ndihmë juridike falas. Megjithëse asnjë nga ligjet përkatëse nuk parashihet ofrimin e ndihmës juridike falas specifikisht rasteve të diskriminimit me bazë përkatësinë etnike, nuk do të thotë që ato e përjashtojnë këtë lloj ndihme në raste të tilla të ngjashme. (BRPI)⁸

Brenda kuadrit të Dekatës së Romve, ligjet janë rishqyrtuar dhe ndryshuar me qëllim që të mundësojnë sigurim social, sigurim shëndetësor, arsim, punësim dhe strehim etj. Këto janë ligjet më të rëndësishme të miratuara në rajon për mbrojtjen e komunitetit Rom dhe të grupeve në rrezik. Kuadri ligjor, për zhvillimin dhe integrimin e popullsisë Rome dhe Egjiptiane në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, është mjaft i favorshëm dhe siguron mbrojtjen e tyre nga varfëria ekstreme dhe përjashtimi i shoqërisë. Në ditët e sotme, ndjekin studimet në shkolla të mesme dhe Universitete, një numër më i madh të rinjsh Rom, përmes mbështetjes së OJQ-ve ndërkombëtare.

Në vende të caktuara të rajonit, profesionistët Rom bëjnë pjesë në strukturat e ministritve të linjës, punojnë për forcat e policisë dhe në sektorët e administratës lokale dhe rajonale. Gjithashtu Romët japin kontributin e tyre në mënyrë aktive, në rajone të caktuara, edhe në sektorin privat. Këto janë përmirësime të mëdha krahasuar me kushtet dhe situatën e një dekade më parë.

Ky progres i arritur është një testament për çfarë mund të bëhet dhe arrihet nëse komunitetet, familjet, politikëbërësit dhe individët bëhen bashkë për të ndaluar edhe format më ekstreme të përjashtimit social.

7 Raport: Të drejtat njerëzore të komunitetit Rom dhe Komuniteteve shtegtare në Evropë, Këshilli i Evropës, Shkurt 2012. - Human Rights of Roma and Travelers Communities in Europe, Council of Europe, February 2012

8 Praktikant më të mira për integrimin e Romve (BPRI). Raporti rajonal mbi antidiskriminimin dhe pjesëmarrjen e Romve në vendimmarrjen lokale, Maj 2013, © OSCE/ODIHR 2013 (Best Practices for Roma Integration (BPRI): Regional Report on Anti-Discrimination and Roma Participation in Local Decision-Making, May 2013. OSCE/ODIHR 2013)

Sidoqoftë, angazhimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i përditësuar në mënyrë që përparimet të mos dobësohen dhe të bëhen të brishta dhe të thyeshme.

Ky progres mund të jetë i prekshëm dhe i dobët nëse konsiderojmë përhapjen dhe thellimin e fenomenit të të përjashtimit nga shoqëria që prek sektorët jetësorë për Romët sidomos fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë si arsimi, punësimi, shëndetësia, strehimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale⁹. Kushtet në të cilat gjen veten komuniteti Rom dhe Egjiptianë në të gjitha vendet e rajonit, kërkon një përmirësim të thellë, me qëllim që ky komunitet të mund të jetojë një jetë dinjitoze në një shoqëri demokratike.

Pavarësisht kuadrit legjislativ të favorshëm dhe të përshtatshëm dhe të gjitha përpjekjeve për të përmirësuar kushtet sociale dhe ekonomike të popullit Rom, shumë çështje sociale dhe shqetësime, që kanë lidhje veçanërisht me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, vazhdojnë të jenë të përhapura dhe të zbuluara në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Sfida për secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor është zbatimi i ligjeve të miratuara, përshtatja e një qasjeje ndërsektoriale të organizuar mirë në mënyrë që këto ligje, veçanërisht ato që garantojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom të jenë të aksesueshme nga çdo individ.

⁹ Harta dhe analiza Maestrale (Maestral mapping and analysis)

5. Të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në rajon dhe në secilin vend .

Cështjet dhe shqetësimet kryesore të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë lidhur me arsimin, shëndetësinë, punësimin, strehimin dhe mbrojtjen sociale.

» E drejta e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë për arsim

Megjithëse, arsimi është një sektor që ka shënuar një progres të konsiderueshëm, përfshirja në të, e personave në rrezik, sidomos ato Rom dhe Egjiptianë, mbetet akoma një çështje shqetësuese për Ballkanin¹⁰ Perëndimor. Referuar vlerësimeve, 60-70% e fëmijëve Rom, kryesisht vajza, të grupmoshave 6-16 vjeç nuk e ndjekin arsimin e detyrueshëm. Ato nuk kanë ndjekur as shkollën fillore ose e kanë braktisur atë dhe si pasojë kanë një nivel arsimor shumë të ulët. Sondazhe të ndryshme theksojnë se në vendet e Ballkanit Perëndimor, çdo brez ka rreth 20.000 të rinj që nuk ndjekin arsimin e mesëm. Janë mesatarisht 25-30% të të rinjve Rom të moshës 16-19 vjeç që arrijnë deri në arsimin e mesëm, krahasuar me shifrën e 65% të të rinjve jo-Rom që regjistrohen në shkollë. Analfabetizmi që llogaritet të ketë prekur 25-30% të popullsisë, ka prekur më së shumti fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe ata në rrezik. Mbi 60% e Romve analfabetë i përkasin grupmoshës 15-25 vjeç. Varfëria, mungesa e strehimit dhe e banimit, dhuna në familje, veçimi, diskriminimi, ngacmimi, etj. me bazë përkatësie etnike ose gjendjes socio-ekonomike, mungesa e personelit të kualifikuar në arsim, pamundësia për të komunikuar në gjuhën zyrtare janë arsyt kryesore që fëmijët dhe të rinjtë Rom braktisin shkollën. Të shumta janë programet në të gjitha vendet e rajonit tw cilwt janw pwrpjekur ta trajtojnë fenomenin e "braktisjes nga fëmijët/të rinjtë Rom dhe Egjiptianë", duke përfshirë mësues dhe studentë, por nuk kanë patur shumë efekt. Sistemi arsimor dhe social në Ballkanin Perëndimor nuk e ka gjetur ende mekanizmin e duhur për të garantuar përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor si dhe t'i pengojë ata që të braktisin shkollën.

» E drejta e të rinjve Rom dhe Egjiptianë për Punësim

Tregu i punës paraqet shumë sfida për integrimin e tw rinjve Rom dhe në shumicën e rasteve veprohet duke i përjashtuar Romët dhe Egjiptianët nga vende të respektuara, jo vetëm në Ballkan, por kudo në Evropë. Nuk ka shifra të sakta për nivelin e papunësisë së të rinjve Rom dhe Egjiptianë, në Ballkan, dhe të rinjve që jetojnë në rrugë. Në disa nga vendet e rajonit, niveli i papunësisë së të rinjve Rom është rreth 4-5 herë më i lartë krahasuar me papunësinë e personave jo-Rom. Në disa vende, dy nga tre Rom janë të papunë. Niveli i papunësisë për të rinjtë është shumë i lartë. E njëjta gjë vlen edhe për njerëzit e paarsimuar dhe të pakualifikuar, për të varfërit dhe për shtresat e tjera të pambrojtura, veçanërisht për vajzat dhe gratë për shkak të diskriminimit gjinor, martesës së hershme dhe të detyruar si dhe shtatzënisë. Një e dhënë jo zyrtare e vlerësuar, tregon se 70% e të rinjve Rom dhe Egjiptianë nuk kanë një punë të formalizuar, kështu që ata zyrtarisht rezultojnë të papunë.

Të rinjtë Rom dhe Egjiptianë si dhe të gjithë të rinjtë e tjerë që jetojnë në rrugë, në përgjithësi, nuk janë të barabartë në fushën e punësimit, kanë qasje të kufizuar në normativën ligjore, e cila garanton mbrojtje nga papunësia, ose ndiqen nga shfrytëzimi dhe diskriminimi në vendet e tyre të punës.

10 Raport: Të Drejtat e Romve dhe të Komuniteteve Shtegtare në Europë", Këshilli i Europës, Shkurt 2012- www.commissioner.coe.int (Report: Human Rights of Roma and Travelers Communities in Europe, Council of Europe, February 2012, www.commissioner.coe.int)

Diskriminimi dhe mungesa e kualifikimit, pengojnë dhe e bëjnë procesin e qasjes së rinisë Rome dhe Egjiptiane në punët e kualifikuara dhe të paguara, të pamundur¹¹. Prandaj, të rinjtë Rom kërkojnë kryesisht tregun informal të punës (riciklimi, tregtia ambulatore) dhe punët informale që ofrojnë pagesa të shpejta, edhe pse rrezikojnë të ballafaqohen me ligjin për shkak të natyrës së paligjshme ose të kriminalizuar të punës, (shitje droge, prostitucion, rrëmbim, parkim, etj.). Fenomeni i lypjes është një shqetësimi shumë i madh i cili ka prekur më së shumti fëmijët Rom, veçanërisht vajzat rome dhe nënat me foshnje të porsalindura. Papunësia, varfëria, diskriminimi, puna në tregun e zi dhe në rrugë, i ekspozojnë lehtësisht, fëmijët dhe të rinjtë Rom, përpara rreziqeve shumë të mëdha, siç mund të jenë, trafikimi dhe prostitucioni. Nuk janë publikuar ende statistika të sakta, por sondazhet tregojnë se më shumë se 40-50% e fëmijëve Rom dhe të rinjve që jetojnë në rrugë, janë të ekspozuar dhe preken nga fenomeni i trafikimit dhe i prostitucionit si pasojë e varfërisë dhe e skamjes.

» E drejta e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë për kujdes shëndetësor

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht nga mbështetja dhe mbrojtja e normativës ligjore, dukuria e diskriminimit të Romve në sistemin e kujdesit shëndetësor është mjaft i pranishëm. Kjo mund të vërehet në nivelin e përfshirjes së këtij komuniteti në institucionet shëndetësore (Infermieri), siqëndrat shëndetësore, spitalet, martenitetet dhe veçanërisht në shërbimet shëndetësore të specializuara. Romët përballen me diskriminim pothuajse në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, madje dhe në ofrimin e shërbimit të urgjencës. Për më tepër, familjet Rome nuk kanë kapacitete financiare të mjaftueshme për të blerë ilaçe dhe medikamente të cilat u nevojiten për të trajtuar sëmundjet. Fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptianë kanë tregues për një shëndet më të dobët në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Shumë nga problemet shëndetësore të shfaqura, shkaktohen nga varfëria, kequshqyerja, neglizhimi, dhuna, punët e vështira ose të rrezikshme, orët e gjata në punë, kushtet ekstreme të banimit dhe higjiena. Për shkak të mungesës së dokumenteve të identitetit dhe mos pasja e një vendbanimi të qëndrueshëm, populli Rom është i privuar nga një shërbim shëndetësor standart¹². Ata nuk janë të përfshirë në skemat e kujdesit shëndetësor, sepse nuk kanë mundësi të paguajnë kontributet e sigurimeve shëndetësore, ose nuk janë të regjistruar as si të papunë, as si punëkërkuar. Mundësia e marrjes së trajtimit të specializuar dhe kujdesit shëndetësor, nga të rinjtë që përdorin substanca narkotike, alkool ose janë të prekur nga sëmundjet ngjitëse dhe / ose seksualisht të transmetueshme, është mjaft e kufizuar dhe kjo përbën një çështje shqetësuese dhe shumë problematike. Për të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, nuk janë ndërmarrë aksione dhe masa të mjaftueshme në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues, kujdesit shëndetësor seksual, riprodhimit dhe planifikimit familjar.

» E drejta e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë për banim, identitet ligjor, mirëqënie dhe kujdes social

Familjet Rome nuk kanë vendbanim të qëndrueshëm. Diskriminimi i Romve në lidhje me strehimin dhe vendbanimin është mjaft i përhapur në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Një analizë krahasuese e bazuar në një studim të UNDP dhe Bankës Botërore në vitin 2011, tregon se mesatarisht 30% e Romve jetojnë në shtëpi të shkatërruara ose në barrake dhe shifrat sipas vendeve janë 36% në Shqipëri, 36% në Bosnje dhe Hercegovinë, 38% në Serbi dhe 42% në Mal të Zi. Mbi 70-80% e familjeve Rome jetojnë në vendbanime joformale dhe në prona të të tjerëve, gjë që çon direkt në kërcënimin e dëbimit me forcë. Në disa nga vendet e rajonit, numri i dëbimeve me forcë është rritur shumë

11 Ma. Elisabeta Osmanaj: "E drejta për arsim e komunitetit rom në kuadrin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" ("The right to education of the Roma community in the framework of the integration of the Republic of Albania into the European Union")

12 Udhëzues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, viktime të trafikimit në Europë (Guidelines on the protection of the rights of child victims of trafficking in Europe)

vitet e fundit. Vendbanimet e Romve nuk përfitojnë nga shërbimet publike si uji i pijshëm, energjia elektrike, sistemet e kanalizimeve, mbledhja e mbeturinave dhe mirëmbajtja e akseve rrugore¹³.

Familjet e reja rome nuk kanë të drejtë të pajisen me shtëpinë/apartamentin e tyre dhe të jetojnë nëpër banesa të përshtatshme, jetën e tyre. Ata janë të detyruar të jetojnë në familje të përbëra nga shumë anëtarë, në hapësira dhe vende të mbingarkuara dhe nën minimumin e jetesës. Vështirësitë e kushteve të jetesës çojnë në dhunë, divorc, neglizhencë dhe braktisje të fëmijëve. Burimet jo zyrtare tregojnë se mbi 60% e fëmijëve dhe e të rinjve Rom janë të paregjistruar, pa shtetësi dhe pa kombësi. Joshtetësia e tyre dhe mungesa e dokumenteve personale është një fenomen i vazhdueshëm në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Të rinjtë pa një identitet ligjor privohen nga e drejta e përfitimit nga skemat e mbrojtjes sociale dhe të drejtat njerëzore të tjera të cilat janë të garantuara me ligj. Atyre, kur arrijnë moshën e duhur¹⁴, u refuzohen të gjitha të drejtat themelore, për arsim, kujdes shëndetësor, banim, asistencë sociale, pjesëmarrje ose votim.

Për shkak të mosarsimit të tyre të mjaftueshëm, të rinjtë Rom kanë mundësi të kufizuara të jenë pjesë e ligjeve që garantojnë shërbimet e nevojshme sociale. Të gjitha procedurat e aplikimit për të përfituar nga skemat e mbrojtjes dhe të kujdesit social, ballafaqohen me shumë pengesa diskriminuese dhe burokratike duke e bërë këtë përfitim të vështirë për t'u marrë. Rinia rome dhe Egjiptiane që jeton në kushte të tilla jashtëzakonisht të këqija detyrohen të braktisin familjet e tyre dhe dalin në rrugë nga ku më pas vijnë të gjitha telashet. Ata janë në kontakt të vazhdueshëm/konflikt me ligjet dhe me pasojat përkatëse që rrjedhin nga një shkelje e tillë. Edhe programet e integruara për rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre janë të mangëta kështu që jo rrallëherë ata e zgjidhin duke kryer vepra penale.

5.1. Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në secilin vend dhe në rajon

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Shqipëri

Ekziston një kuadër ligjor relativisht i plotë për mbrojtjen sociale, zhvillimin dhe integrimin social të fëmijëve dhe të rinjve në përgjithësi në Shqipëri, me theks të veçantë në fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë. Një sërë ligjesh, strategjish dhe programesh janë përshtatur dhe zbatuar për të lehtësuar dhe nxitur përfshirjen e tyre në arsim, regjistrim civil, punësim dhe strehim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje ligjore etj. Janë themeluar disa qendra publike dhe jopublike të banimit dhe të kujdesit ditor, për të ofruar shërbime multidisiplinare dhe mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar, braktisur dhe të lënë pas dore të cilë janë në kontakt / konflikt me ligjin, fëmijët që jetojnë në rrugë, etj. Këto janë kryesisht fëmijë rom dhe Egjiptianë dhe gjenden në këtë situatë që në fazat e para të jetës së tyre për shkak të varfërisë së skajshme. Përkundër të gjitha ligjeve që kalojnë në favor të tyre, situata reale me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë është shumë problematike. 34% e popullsisë Rome i përket grupmoshës 15 vjeçare dhe si e tillë preket kryesisht nga çështjet sociale. Fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptianë kanë tregues më të ulët të shëndetit në krahasim me fëmijët e komunitetit jo-rom. Përsa i përket kujdesit shëndetësor, mendojmë se përderisa dallimi në lidhje me vaksinimin ndërmjet fëmijëve Rom dhe jo-Rom është i papërfillshëm, qasja e tyre në shërbimet shëndetësore është një çështje shumë problematike, 59% e Romve raportojnë se nuk kanë të drejtë të marrin ilaçe. Përsa i përket arsimit, UNDP ka realizuar një studim sipas të cilit 48% e Romve të moshës 7-15 vjeç shkojnë në shkollë, në Shqipëri, dhe kjo shifër pëson ulje me 13% për grupmoshat 16-19 vjeç.¹⁵ Braktisja e shkollës nga fëmijët Rom të moshës 10-16 vjeç arrin në shifrën e 30% për djemtë dhe 44,6% për vajzat. 96% e vajzave Rome dhe 68% e djemve Rom të moshës 16 vjeç e kanë ndërprerë fare shkollën. 43% e Romve kanë ndjekur studimet e 4 viteve të para të

13 UNDP, INSTAT- Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në censusin 2011- Prill, 2015, (UNDP, INSTAT- Roma and Egyptians in Albania: The socio-demographic and economic profile based on the 2011- April census, 2015)

14 Raport: Të Drejtat e Romve dhe të Komuniteteve Shtegtare në Evropë, Këshilli i Evropës, Shkurt 2012- (Report: Human Rights of Roma and Travelers Communities in Europe, Council of Europe, February 2012)

15 UNDP- Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri, Tiranë, 29 shkurt 2012 (Roma report in Albanian.pdf) (UNDP - A needs assessment study on Roma and Egyptian communities in Albania, Tirana, February 29, 2012)

arsimit fillor, 21% kanë mbaruar të tërë ciklin nëntë-vjeçar. 55% e vajzave mbi moshën 15 vjeç nuk kanë vajtur fare në shkollë, dhe vetëm 18% e tyre kanë mbaruar të paktën vitin e parë të shkollës elementare. Komuniteti Egjiptianë qëndron në mes të dy grupeve të tjera, dhe shifrat janë në rang mes 80% dhe 49%. Qasja dhe integrimi i tyre në arsimin e mesëm është një sfidë e madhe.

Situata kritike në sektorin e arsimit çon në një situatë kritike në tregun e punës. 37% e fëmijëve dhe e të rinjve 25 vjeç Rom dhe Egjiptianë nuk kanë një punë të formalizuar dhe diskriminimi kundër tyre në terren arrin në nivelin 24%, për shkak të se shumica e Romve të diskriminuar thjesht ndalojnë kërkimin e një pune ose deklarojnë se punojnë për pak orë dhe si rrjedhim nuk identifikohen si të papunë.¹⁶

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Bosnje dhe Hercegovina

Bosnje dhe Hercegovina iu bashkuan Dekadës së Përfshirjes së Romve në vitin 2008. Por Komisioni i Evropës, siç raportohet në Progres Raportin e Bosnjes dhe Hercegovinës në 2012, ka vërejtur një progres të kufizuar në fushën e arsimit, punësimit dhe shëndetësisë krahasuar me angazhimet e tyre politike. Për më tepër, pjesëmarrja e përfaqësuesve të komunitetit Rom, në procesin e vendim marrjes, mbetet shumë e ngadaltë. Vërehet një përparim shumë i vogël, në përmirësimin e gjëndjes së grave Rome dhe fëmijëve të cilët në mënyrë të vazhdueshme vuajnë nga diskriminimi dhe dhuna në familje.

Sipas një studimi rajonal (BRPI) në vitin 2011, rezultoi se, vetëm 61% e fëmijëve Rom të moshës 7-15 vjeç janë regjistruar në shkollë, krahasuar me shifrën prej 96% të fëmijëve jo-Rom. Regjistrimi i të rinjve Rom të moshës 16-19 vjeç arrin 15% krahasuar me 72% të fëmijëve jo-Rom. Studimi rajonal raporton për nivelin e papunësisë së të rinjve Rom të grupmoshës 15-24 vjeç, i cili ka arritur në 69% krahasuar me 56% të popullsisë jo-Rome të së njëjtës moshë. Studimet e kohëve të fundit tregojnë një rënie të ndjeshme të nivelit të varfërisë, megjithatë, akoma vazhdon e pranishme, bazuar në të ardhurat minimale të komunitetit Rom, krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë jo-Rome, niveli i varfërisë arrin në 42% për komunitetin Rom dhe 14% për atë jo-Rom. Studimi i kryer në vitin 2011 (BRPI) nxori rezultate të përziera: 70% e Romve kanë sigurim shëndetësor, por 68% nuk arrijnë të blejnë ilaçet bazë. Niveli i vaksinimit të fëmijëve Rom 6 vjeçarë arrin në 82% krahasuar me 97% të fëmijëve të së njëjtës moshë, të cilët jetojnë në lagjet përreth zones së Romve, por niveli i qasjes në shërbimin shëndetësor për Romët dhe Egjiptianët është shumë i ulët po të krahasohet me atë të njerëzve jo-Rom. Mbi 36% e Romve jetojnë në shtëpi të shkatërruara ose barrake dhe nuk kanë as kushtet minimale bazë të jetesës¹⁷. Siç po ndodh zakonisht në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, varfëria dhe Standarti i ulët i jetesës kanë bërë të mundur ekspozimin e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë para fenomenit të rrugës.

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Maqedoni

Pavarësisht zbatimit të Strategjive Kombëtare për përfshirjen e Romëve dhe ligjeve të amenduara për ekzekutimin e këtyre strategjive, fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në Maqedoni po përballen me shumë vështirësi, diskriminim dhe përjashtim. Studimi i vitit 2011 raporton se niveli i Romëve që ndjekin arsimin fillor është rreth 60% krahasuar me nivelin prej 90% të popullsisë etnike maqedonase jo-Rome. Ky vlerësim duket në përputhje me rezultatet e raportuara në sondazhin rajonal për Romët, kryer në vitin 2011 dhe përqindja për fëmijët e moshës 7-15 vjeç Rom që ndjekin shkollën është 74%. Ky studim tregoi që niveli i regjistrimeve, në shkollë, i fëmijëve Rom të moshës 16-19 vjeç është 27% krahasuar me 65% të popullit jo-Rom. Të dhënat

16 Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: Profili socio-demografik dhe ekonomik bazuar në censusin 2011- Prill, 2015, UNDP, INSTA. Roma and Egyptians in Albania: The socio-demographic and economic profile based on the 2011- April census,- (UNDP, INSTAT- 2015)

17 Praktikat më të mira për integrimin e Romve (BPRI) Raporti rajonal mbi antidiskriminimin dhe pjesëmarrjen e Romve në vendimmarrjen lokale, Maj 2013, © OSCE/ODIHR 2013 ((Best Practices for Roma Integration (BPRI): Regional Report on Anti-Discrimination and Roma Participation in Local Decision-Making, May, 2013. OSCE/ODIHR 2013)

zyrtare tregojnë se, 35%, i të gjithë fëmijëve të regjistruar në arsimin fillor, si fëmijë me sëmundje mendore janë fëmijët Rom. Niveli i papunësisë i të rinjve Rom të moshës 15-24 vjeç është 71 %. Programet e Punësimit me objektiv komunitetin Rom ka patur pak sukses në inkurajimin e tyre për tu bërë pjesë e këtyre programeve. Rezultatet e sondazhit të vitit 2011 treguan një nivel varfërie prej 41% në komunitetin Rom krahasuar me 14% në popullsinë jo-Rome, duke u bazuar në të ardhurat. Përsa i përket shëndetit, niveli i vaksinimit të foshnjave të porsalindura dhe i fëmijëve në përgjithësi (93%) si dhe qasja në sigurimin shëndetësor (92%) është pak më i mirë krahasuar me atë jo-Rom (99 dhe 97% përkatësisht). Megjithatë, tërheqja në mjekimin bazë dhe marrjen e ilaçeve është shumë problematike dhe 2/3 e Romëve deklarojnë se përballen me mungesa të mëdha. Përafërsisht ¼ e familjeve Rome në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë jetojnë në lagje ose vende shumë të varfra pa kushte higjieno-sanitare dhe në mungesë të plotë të infrastrukturës publike për mirëmbajtjen e vendbanimeve të tyre. Ata janë përballur me dëbime me forcë dhe me prishjen e vendbanimeve të tyre të në mungesë të procesit të legalizimit dhe kjo do të thotë që qindra fëmijë dhe të rinj Rom dhe Egjiptianë duhet të përballen me çështjen e strehimit të pasigurt.

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Kosovë

UNDP raportoi në vitin 2011 që ¼ e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptianë nuk e kanë ndjekur arsimin fillor, ndërsa 62% e djemve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë, dhe 78% e vajzave Rome, Ashkali dhe Egjiptianë nuk kanë arritur të ndjekin studimet e tyre deri në arsimin e mesëm. Shifrat tregojnë se 75% e fëmijëve e kanë mbaruar 4-vjeçarën e arsimit fillor dhe 25% kanë vazhduar studimet deri në arsimin 9-të vjeçar dhe vetëm 1.4 % e fëmijëve dhe e të rinjve kanë vazhduar më tej studimin, ose kanë arritur të mbarojnë arsimin 9-të vjeçar. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga ESP dhe UNDP (2005) mbi nivelin e aftësisë së tyre në shkrim dhe lexim, paraqesin një pozicion të pafavorshëm të arsimimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Për më tepër, ka një përkeqësim të ndjeshëm të të treguesve arsimor në vitet e fundit. UNDP ka vlerësuar, se 58% e popullsisë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane, në vitin 2010, kanë qenë të papunë në krahasim me mesataren prej 48% në gjithë Kosovën. Ky studim ka nxjerrë që shifra e papunësisë prej 75% të të rinjve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë janë të moshës 15-24 vjeç¹⁸. Rezultatet e studimit të publikuara nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor të kryer nga UNDP dëshmuar faktin se të gjithë punonjësit Rom, Ashkali dhe Egjiptianë (nëse janë të punësuar) bëjnë punë të rëndomta. Sipas KFOS në Kosovë, (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur), shqetësuese është mungesa e regjistrimit civil të fëmijëve 0-6 vjeç Rom, Ashkali dhe Egjiptianë. 14.7% nuk janë regjistruar në regjistrin e lindjeve. Fëmijët e kësaj moshe kalojnë shumë probleme shëndetësore, pasi gjatë kësaj faze kryhen shumë vakcina dhe mosmarrja e tyre mund të rrisë normën e vdekshmërisë foshnjore për shkak të disa epidemive, por gjithashtu mund të çojë edhe në probleme shëndetësore afatgjata pavarësisht faktit se i pavaksinuari mund të jetë me fat dhe nuk preket nga sëmundjet epidemike. Gjithashtu mund të marrim në konsideratë edhe faktin që fëmijët e kësaj moshe mund të bie lehtësisht pre e fenomenit të trafikimit të fëmijëve. Ndërkohë, organet e rendit dhe të ligjit mund të hasin vështirësi në gjetjen dhe mbrojtjen e tyre, gjë që e përkeqëson më tepër situatën¹⁹. Situata e sigurimit të strehimit dhe vendbanimit për familjet Rome dhe Egjiptiane është një tjetër çështje me interes të madh. Mbi 50% e familjeve Rome dhe Egjiptiane nuk zotërojnë një hapësirë të nevojshme, adeguate dhe të përshtatshme për jetesë, që të mund të garantojnë mirëqenien e fëmijëve të tyre. Mbi 42% e vendbanimeve të tyre janë joformale dhe ambjentet e jetesës nuk janë të sigurt. Vendbanimet Rome nuk përfitojnë nga shërbimet publike siç janë energjia elektrike apo ndriçimi publik, mirëmbajtja, etj.

18 Praktikrat më të mira për integrimin e Romëve (BPRI): Raporti Rajonal për Anti-diskriminimin e Pjesëmarrjes së Romëve në vendimarrjen Lokale. Maj, 2013 OSCE/ODIHR2013. (Best Practices for Roma Integration (BPRI): Regional Report on Anti-Discrimination and Roma Participation in Local Decision-Making, May, 2013. OSCE/ODIHR 2013

19 Situata e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë (The situation of Roma, Ashkali and Egyptian communities in Kosovo, (KFOS - SOROS), 2009

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Malin e Zi

Shumë studime dhe raporte tregojnë se shumica e popullsisë Rome ende jetojnë në kushte tepër të varfra. Fuqia e tyre e dobët ekonomike, mungesa e arsimit, niveli i ulët i punësimit, hapësirat e pamjaftueshme të jetesës dhe kushtet e banimit, përjashtimi social i bazuar në stereotipe dhe paragjykitime etnike, stili i tyre specifik i jetesës dhe veçanti të tjera janë disa nga arsyet për pozitën e tyre të vështirë në shoqëri. Në këto kushte, fëmijët nuk shkojnë rregullisht në shkollë edhe pse shteti ka lehtësuar tërheqjen e tyre në arsim. Problemet në lidhje me arsimin janë gjithashtu të shumta: prindërit analfabetë të cilët nuk janë në gjendje të ofrojnë mbështetje për fëmijët, mungesa e edukimit parashkollor, cilësia e dobët e klasave të ofruara për Romët i dekurajojnë ata nga edukimi i mëtejshëm, kufizimet financiare, mungesa e aftësive të mësuesve për t'u marrë me fëmijët Rom, mungesa e njohjes së gjuhës malazeze, që sjellin si pasojë nivelin e lartë të braktisjes së shkollës. (shkaktuar nga martesat e hershme dhe nga lypja)²⁰.

Studimet e kryera, në vitin 2011, nga UNDP, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian, tregojnë se 55% e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë të moshës 7 dhe 15 vjeç regjistrohen në arsimin e detyrueshëm dhe vetëm 13% e të rinjve të moshës 16-19 vjeç regjistrohen në arsimin e mesëm.

Varfëria ekstreme i lë ata të mbërthyer në një situatë të tmerrshme banimi duke jetuar në kampe me të gjithë familjarët e tjerë dhe me një nivel të ulët higjienë. Shëndeti i komunitetit Rom në Mal të Zi është i lidhur ngushtë me kushtet e këqija të jetesës së kombinuar me nivelin arsimor të pamjaftueshëm, për të mos u përmendur kujdesi i specializuar shumë i shtrenjtë. Kjo çon në gjendje të keqe shëndetësore, vdekje të parakohshme, rrezik gjatë lindjes dhe ul më tepër pritshmërinë e të bërit jetë në krahasim me mesataren kombëtare²¹. Komuniteti Rom në Mal të Zi është relativisht i mbuluar nga skemat e sigurimeve shëndetësore dhe të vaksinimit (përkatësisht 84% dhe 94%) dhe raportimet tyre tregojnë se shëndeti i komunitetit Rom është më pozitiv se popullsia jo-Rome që jeton aty pranë. Megjithatë, informacioni në dispozicion sugjeron që gjendja shëndetësore e Romve është shumë më e keqe se ajo e popullsisë së përgjithshme në Mal të Zi.

Studimet e UNDP-së, Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian raportojnë se 42% e komunitetit Rom të anketuar jetojnë në shtëpi të shkatërruara ose në lagje të varfëra krahasuar me 12% të popullit jo-Rom që jeton aty pranë. Niveli i papunësisë për Romët është 44% në krahasim me 30% të popullsisë jo-Rome që jeton aty pranë dhe arsyet për këtë, janë jo vetëm mungesa e kualifikimeve të nevojshme të komunitetit Rom dhe Egjiptianë për tregun e punës, por edhe diskriminimi i tyre.

» Situata e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në Serbi

Brenda kuadrit të Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2005-2015, janë miratuar 19 ligje dhe mbi 6 strategji kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe grupeve etnike. Të gjitha këto dokumente, veçanërisht ato të hartuara në kuadrin e Dekadës së Romve, shtrojnë çështjet problematike të fëmijëve Rom dhe Egjiptianë në lidhje me mbrojtjen dhe kujdesin social.

Duke iu referuar Raportit të Vlerësimit të Nevojave në Serbi, të tetorit të vitit 2013, ka shumë fëmijë Rom që nuk janë të regjistruar në shkollë dhe shumë prej tyre janë regjistruar por e kanë braktisur atë që në fazën e parë. Burime të ndryshme tregojnë se 35 deri në 60% e fëmijëve Rom nuk regjistrohen në shkollë. 38% e fëmijëve Rom nuk ndjekin programin e detyrueshëm parashkollor, 26% e fëmijëve Rom nuk ndjekin arsimin fillor (CARE Srbija, NSHC, 2011) dhe 38% e të rinjve braktisin arsimin e mesëm. (Instituti i Shoqërisë së Hapur, 2010).

²⁰ Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komunitetit Rom dhe grupeve të tjera të prekura në Malin e Zi, Instrumenti për asistencë para anëtarësimit (IPA II) 2014-2020, Komisioni Evropian. (Promotion and protection of human rights of Roma and other vulnerable groups MONTENEGRO, Instrument for pre-assessment assistance (IPA II) 2014-2020, European Commission)

²¹ Ibid.

Popullsia Rome në Serbi ka nivelin më të lartë të varfërisë, papunësisë dhe sëmundjeve në rritje krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë jo-Rome. Sipas vlerësimeve, 2/3 e fëmijëve Rom jetojnë në varfëri ekstreme. Komuniteti Rom është 7.5 herë më i ekspozuar ndaj kërcënimit të varfërisë krahasuar me popullin jo-Rom në Serbi, ku shkalla e papunësisë për komunitetin Rom është 4 herë më e lartë se norma mesatare e papunësisë në vend. Për shkak të pashtetësisë së tyre (mungesa e një identiteti ligjor), fëmijët dhe të rinjtë Rom janë të privuar nga shumë të drejta në lidhje me shëndetin, mbrojtjen sociale, punësimin, strehimin, të drejtat e votimit etj. 60 - 80% e Romve jetojnë në kushte të papërshtatshme dhe të pasigurta për jetën dhe 70% e vendbanimeve të tyre janë joformale. Për më tepër, 30% e viktimave, të identifikuar, të trafikimit të qënieve njerëzore janë vajzat dhe gratë Rome dhe 72% e të rinjve, të identifikuar si viktima të trafikimit të qënieve njerëzore në Republikën e Serbisë janë fëmijët dhe të rinjtë Rom. Parametrat e gjëndjes shëndetësore së fëmijëve dhe e të rinjve Rom, janë të një niveli më të ulët në krahasim me shumicën e popullësisë serbe jo-Rome. Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve Rom është rreth 3 herë më e lartë se mesatarja kombëtare. Përsa i përket kujdesit shëndetësor, numërohen një listë e gjatë shërbimesh të cilat komuniteti Rom nuk i përfiton në qendrat shëndetësore, dhe si rrjedhim niveli i vdekjeve dhe i sëmundjeve për Romët është shumë i lartë krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë jo-rome.

6. Përgjegjësitë dhe detyrat e ndërmarra nga OJQ-të për të siguruar mbrojtjen, zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë

Garantimi, i mbrojtjes sociale, zhvillimit dhe integritetit të fëmijëve dhe i të rinjve Rom dhe Egjiptianë në shoqëri, nëpërmjet dispozitave kushtetuese dhe ligjore nuk rezultojnë të jetë mënyra më e përshtatshme. Mbrojtja, përfshirja sociale, zhvillimi dhe integriteti i fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë përbën një proces të vazhdueshëm ku përfshihen shumë aktorë të sektorit publik dhe privat. OJQ-të janë aktorët kyç të cilët mund të ushtrojnë ndikim të madh, pasi luajnë rol të rëndësishëm në mobilizimin e shoqërisë, komuniteteve Rom dhe Egjiptiane, veçanërisht duke nxitur mediat dhe të gjithë aktorët e tjerë që janë pjesë dhe kanë ndikim në strukturat e vendimmarrjes lokale dhe kombëtare në secilin nga vendet e rajonit. Përpjekjet e tyre intensive për të organizuar dhe vënë në lëvizje të gjithë këta aktorë me qëllim që të ushtrojnë ndikim te institucionet shtetërore për të ekzekutuar të gjitha garancitë kushtetuese dhe ligjore, janë një nga prioritetet kryesore të OJQ-ve.

6.1 Detyrat e ndërmarra nga OJQ-të në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe pabarazia shoqërore.

(Një tjetër rol i ndërhyrjes së OJQ-ve krahasuar me funksionet e institucioneve shtetërore.)

Shërbimet parandaluese të ofruara nga OJQ-të

Këto shërbime përfshijnë:

Rritja e ndërgjegjësimit

Rritja e ndërgjegjësimit së shoqërisë në mbrojtje të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë kundër diskriminimit dhe përjashtimit social është një nga detyrat më të rëndësishme të ndërmarra nga OJQ-të dhe organizatat e tjera që punojnë me fëmijët. Roli i OJQ-ve është të marrë përsipër përgjegjësinë për rritjen e ndërgjegjësimit së shoqërisë dhe përfshirjen e tyre në aksione pozitive që arrijnë të sigurojnë mbrojtjen sociale dhe integritetin e fëmijëve dhe të të rinjve Rom në shoqëri.

- » OJQ-të mobilizojnë shoqërinë civile në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe çdo fëmijë apo individ në rrezik, kundër braktisjes dhe neglizhencës. Ata ndërmarrin veprime në ngritjen e ndjeshmërisë së shoqërisë për të reaguar kundër moszbatimit ligjit ose kundër dhunimit të të drejtave të Romëve dhe Egjiptianëve nëpërmjet organizimit të aksioneve qytetare.
- » Teknikat e ndërhyrjes: njoftime publike dhe deklarata në rastet kur evidentohet diskriminim, peticione, konferenca për shtyp, botim të dokumenteve mbi kushtet e jetesës, mbi veçimin dhe diskriminimin në shkollë, mbi institucionet shëndetësore dhe të punësimit, mbi banimin dhe mbrojtjen sociale etj. Teknikat për rritjen e ndërgjegjësimit përfshijnë protesta dhe marshime të mirë organizuara për problematikat e caktuara, sidomos në rastet kur komuniteti Rom dëbohet me forcë nga vendbanimi i tyre, për çështjet e strehimit etj.
- » OJQ-të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve në respektimin e të drejtave të njeriut, kulturës dhe të vlerave të komunitetit Rom dhe Egjiptianë, duke kontribuar kështu

- në ndryshimin e imazhit negativ të këtyre komuniteteve në një imazh më të mirë.
- » Teknikat e ndërhyrjes: panaire etno-kulturore dhe kulinare, forume dhe diskutime, ekspozita, forum me median etj. Këto teknika/mekanizma krijojnë mundësi të mira për komunitetin Rom për të shprehur dhe ndarë vlerat e tyre shpirtërore dhe thesaret kulturore si dhe për të ndryshuar të gjitha paragjykimet që janë manifestuar dhe kultivuar kundër tyre. Përmirësimi i imazhit ndikon në zvogëlimin e diskriminimit dhe të veçimit si dhe inkurajimin e afrimit, në shoqëri, të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë.
 - » Praktikrat e mira: Krijimi i klasave dhe ekipeve sportive miqësore nëpër shkolla ndikon pozitivisht në uljen e diskriminimit, ngacmimit dhe të veçimit të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në mjediset shkollore.

Rritja e ndërgjegjësimit

Rritja e ndërgjegjësimit ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është strategjia më e rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë nga diskriminimi dhe përjashtimi social si dhe kryen një promovim të një mirëkuptimi më të mirë të kulturës, traditës dhe vlerave të tyre në shoqëri.

- » OJQ-të rrisin ndërgjegjësimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në lidhje me të drejtat e tyre si dhe i nxisin të marrin pjesë në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit. OJQ-të janë aktorët kyç në procesin e çrënjosjes së të gjitha pengesave që komuniteti Rom takon gjatë ofrimit të shërbimeve. Teknikat: fushatat ndërgjegjësimi, fushata mediatike, publikime dokumentesh, shkëmbim informacioni etj.
- » OJQ-të luajnë një rol kyç në procesin e ndërgjegjësimit të shoqërisë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mbi luftën kundër fenomenit të diskriminimit dhe të veçimit si dhe në promovimin e trajtimit në mënyrë të barabartë të njerëzve, respektimin e diversitetit kulturor dhe reklamimin e dialogut ndërkulturor.
- » OJQ-të janë të parët që përballen me çështjet problematike të popullsisë Rome dhe janë të aftë për ta bërë komunitetin Rom të vetëdijshëm për nevojat e tyre dhe kapacitetet në gjetjen e zgjidhjes së problemeve si dhe i inkurajojnë për zhvillimin e tyre²².
- » OJQ-të janë angazhuar tërësisht për rritjen e ndjeshmërisë së shoqërisë dhe përfshirjen e tyre, sidomos të komunitetit Rom dhe Egjiptianë, në aksionet që garantojnë mbrojtje dhe integrim social të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në shoqëri.
- » OJQ-të fuqizojnë Romët dhe Egjiptianët, sidomos të rinjtë, që të kenë ndikim në procesin e vendimmarrjes rreth çështjeve të rëndësishme të jetës. Ato janë të një rëndësie të madhe, pasi ndikojnë në ndërtimin e konfidencës dhe të besimit tek fëmijët dhe tek të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në kapacitetet dhe vlerat individuale, ashtu si edhe identiteti i përkatësisë etnike, kulturore dhe traditës Rome dhe Egjiptiane. Ndërtimi i vetëbesimit lehtëson sfidat e përballjes me diskriminimin dhe dhunën si dhe nxit për një qasje pozitive në shoqëri.
- » Teknikat/metodat e ndërhyrjes: programe informative për të drejtat e njeriut dhe ligjet që promovojnë përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë, trajtim të barabartë dhe mos diskriminim (broshura, postera, këshilla ligjore dhe administrative, takime, diskutime etj.

22 Udhëzues praktik për OJQ-të për të parandaluar diskriminimin kundër komuniteteve Rome NET-KARD

- » rogramet e trajnimit (ngritja e kapaciteteve, inkurajimi i pjesëmarrjes në strukturat vendimmarrëse, lobimi dhe përkrahja, forcimi i udhëheqjes së Romve dhe Egjiptianëve, sidomos udhëheqësit e rinj, forcimi i rolit të ndërmjetësimit Rom, duke patur parasysh format e ndryshme të diskriminimit, abuzimit, shfrytëzimit, neglizhencës, vlerat qytetare, etj.)

Lobimi dhe Përkrahja

- » OJQ-të kanë një rol të pazëvendësueshëm në ushtrimin e një ndikimi në politikat sociale dhe ekonomike në dobi të mbrojtjes dhe integritit në shoqëri të Romve dhe Egjiptianëve. Ata llojnë dhe përkrahin aktet ligjore dhe nënligjore në interes të zhvillimit, mbrojtjes sociale dhe integritit të rinisë Rome dhe Egjiptiane në jetën shoqërore. Ato gjithashtu ndërmarrin iniciativa ligjore të cilat garantojnë zgjidhje për çështjet problematike me të cilat, fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, përballen në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor, punësimit, strehimit, mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.
- » Teknikat e ndërhyrjes: pjesëmarrja në tryeza të rumbullakëta konsultimi, forume dhe borde këshillimore, organizimi i dëgjësive publike, takime me ekspertë, fushata mediatike, fushata përkrahjeje, propozime të akteve ligjore, amendime, etj.
- » OJQ-të mobilizojnë të gjitha institucionet publike dhe private që kanë përgjegjësinë për të mbrojtur të drejtat e komunitetit Rom dhe Egjiptianë si dhe të gjitha kategoritë e tjera në rrezik. Duke u mbështetur në të drejtën kushtetuese, ato mobilizojnë më së shumti strukturat e antikorrupsionit dhe të drejtësisë për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në rastet kur evidentohen shkelje e të drejtave të njeriut të çdo lloji apo forme.
- » Teknikat/mekanizmat e ndërhyrjes: OJQ-të paraqesin kërkesa, ankesa, njoftime dhe forma të tjera të pranuarra institucionalisht nga këto struktura dhe si rrjedhojë adresojnë akte ligjore, vendime të padrejta, pezullim të çështjeve, mobilizim të institucioneve legjislative etj. me qëllim mbrojtjen në përgjithësi të komunitetit Rom dhe Egjiptianë dhe në veçanti mbrojtjen e fëmijëve.

Monitorimi dhe Analiza

Synimet, i vënë para përgjegjësisë OJQ-të, që të angazhohen për të ushtruar një ndikim mbi qeverinë me qëllim që këta të fundit të përmbushin detyrën e tyre të mbrojtjes dhe përkujdesjes së qytetarëve dhe se OJQ-të janë aty për ta lehtësuar këtë proces përmes ndihmës dhe ofritit të shërbimeve të drejtpërdrejta alternative. Për të përmbushur këtë mision, ato vazhdimisht kryejnë analiza dhe monitorime mbi forcimin e ligjit kombëtar dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe aplikimin e dokumenteve ndërkombëtare (Konventa, Rezoluta, etj.) në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë. Ato luajnë një rol të domosdoshëm në monitorimin e strategjive lokale dhe kombëtare të hartuara në Dekadën e Përfshirjes së Romve dhe të Normativës së BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritit të Romve deri në vitin 2020.

- » Teknikat/metodat e ndërhyrjes: OJQ-të organizojnë sondazhe, studime, botojnë dokumente, vëzhgime, analiza e nevojave, raportime periodike. Ata përkrahin dhe ushtrojnë presion në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në mënyrë që analiza dhe gjetjet e tyre të merren në konsideratë duke i transferuar ato në politika më të mira sociale në shërbim të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.
- » OJQ-të organizojnë aksione qytetare (protesta, marshime, etj.) në rastet kur qeveria merr iniciativa ligjore që ndikojnë ose shkelin interesat qytetare. Ata marrin pjesë aktivisht në tryeza të rumbullakëta teknike, në forume këshillimi, në borde këshillimi, në të gjitha aksionet e mire formalizuara ku ata të kenë mundësi të ndajnë dhe diskutojnë mendimet dhe praktikën e tyre mbi Standartet, politikën, legjislacionin në lidhje me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe të fëmijëve të tjerë në rrezik të përjashtimit social.

6.2 Bashkëpunimi dhe partneriteti me qëllim mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në rrezik.

Roli i OJQ-ve është i një rëndësie të madhe jo vetëm në monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë, por edhe në mobilizimin dhe pozicionimin e të gjithë aktorëve publikë dhe privatë, në mënyrë të tillë që qasja në shërbimet e integruara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe të fëmijëve të tjerë në rrezik, të mund të garantohet dhe të arrihet.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me strukturat shtetërore

Institucionet shtetërore kanë për detyrë të garantojnë mbrojtjen, zhvillimin dhe integrimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe të çdo individi ose grupi njerëzish në rrezik nëpërmjet zbatimit të legjislacionit, politikave dhe programeve socio-ekonomike që ata ndjekin.

Përveç kësaj, duke bashkëpunuar dhe organizuar aktivitete me strukturat shtetërore, OJQ-të mund të bëjnë monitorimin e punës së institucioneve shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në rrezik dhe njëkohësisht ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për ta.

- » **Disa forma bashkëpunimi midis OJQ-ve dhe strukturave të shtetit dhe aktorëve të tjerë**
- » Organizimi i grupeve teknike dhe task-forcës, etj. Që të realizojnë një ndërhyrje të mire koordinuar në situata të caktuara ose raste që u vijnë në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë që kanë nevojë për mbrojtje.
- » Organizimi i grupeve teknike për raste të caktuara që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe të dokumenteve strategjike ose për disa çështje të tjera që kërkojnë angazhimin e ekspertëve të OJQ-ve për të aplikuar praktikat më të mira nga projektet dhe programet e tyre;
- » Organizimi i grupeve të përbashkëta teknike për punën në terren për identifikimin e fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në rrugë, duke i dhënë disa të dhëna rreth tyre dhe duke u ofruar në çast ndihmën e parë.
- » Bashkë-menaxhimi i rasteve të caktuara (kur evidentohen fëmijë / të rinj në rrezik, fëmijë / të rinj që kanë nevojë për mbrojtje) me strukturat shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve përmes ofimit, nga ana e OJQ-ve, të të gjitha burimeve njerëzore dhe materiale në zotërim të tyre.
- » Përgjegjësi e përbashkët në ngritjen dhe zhvillimin e Planit Individual për Mbrojtjen dhe Kujdesin e 15-18 vjeçarëve dhe Plani Individual për Mbrojtjen dhe Kujdesin e 18-30 vjeçarëve.
- » Sigurimi i ekspertëve dhe lehtësimi i procesit të analizës së nevojave sociale të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë përmes përfshirjes së komunitetit. Teknikat: vizita në terren dhe vëzhgime, grupet e fokusit, intervistat, studimet, etj;
- » Ngritja e kapaciteteve të ofruesit të shërbimeve private dhe publike, për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në rrezik. Teknika: trajnime, seminare, workshops, praktika të mira etj.
- » Denoncimi në strukturat përkatëse kur një fëmijë abuzohet ose supozohet të jetë abuzuar dhe ka nevojë për mbrojtje.
- » Ngritja e shërbimeve alternative komunitare si dhe shërbimet e tjera që mungojnë, për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me OJQ të tjera të ngjashme

Aktivitetet e OJQ-ve janë të shumta dhe të ndryshme, por shpesh ato nuk janë të organizuara ose të koordinuara mirë, kështu që burimet e tyre mund të jenë efektivisht të shfrytëzueshme për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Zëri i këtyre organizatave duke u përpjekur të zvogëlojnë ngërçin e kushteve të jetesës dhe mirëqënien midis popullit Rom dhe jo-Rom, bëhet i fuqishëm nëse të gjithë OJQ-të përpigën të ndjekin të njëjtën metodologji dhe të jenë të mire sinkronizuar si brenda vendit ashtu edhe në rajon. Një harmonizim i tillë mund të sjellë si rezultat kryerjen e një pune më të mirë dhe më efikase me fëmijët dhe të rinjtë Rom ku shumica e tyre janë migrues, nuk kanë një vendbanim të qëndrueshëm, nuk njohin kufij kombëtar dhe janë pa shtetësi.

Organizatave e Shoqërisë Civile (OSHC) kanë përgjegjësi të plotë në përmirësimin e partneritetit dhe arrijnë e një organizimi dhe koordinimi të mirë midis tyre. Secila prej tyre duhet të koordinohet me organizatat e tjera, veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe në fusha të tjera të të drejtave të njeriut në mënyrë të tillë që të:

- » Garantohen shërbime cilësore për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në përputhje me Standartet e BE-së.
- » Sigurohen ndërhyrje sociale më të mira dhe efikase për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë
- » Zhvillohen dhe të forcohen kapacitetet njerëzore si dhe të shkëmbehen eksperiencat.
- » Mundësohet shumëfishimi i të gjitha burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion.

Rrugët e bashkëveprimit dhe të bashkëpunimit

- » Projekte të përbashkëta rajonale.
- » Ndarja e strukturave të përbashkëta të vendimmarrjes për çështje të rëndësishme të të drejtave të fëmijëve.
- » Ndarja dhe shkëmbimi i informacionit, shpërndarja e praktikave të mira dhe e modeleve pilot.
- » Ndarja e dokumenteve të publikuara që kanë të bëjnë me çështjet e një interesi të madh e të përbashkët
- » Rrjet Komunikimi
- » Ndarja e grupeve të përbashkëta të task-forcës në rastet e situatave problematike të tilla si: emergjencat natyrore, emergjencat civile, emigracioni i paligjshëm, trafikimi i fëmijëve ose shfrytëzimi në të dy anët e kufijve shtetërorë etj.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me OJQ-të dhe Komunitetin Rom dhe Egjiptianë.

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, lëvizja Rome dhe për njerëzit Rom është bërë më e fortë dhe kjo ka mundësuar njohjen e disa prej nevojave të këtij komuniteti, dhe lobimin në nivele të ndryshme për hartimin dhe zbatimin e politikave në interes të këtij komuniteti, si dhe monitorimin e strategjive lokale dhe kombëtare në të mirë të popullit Rom. Në interes të fuqizimit të komunitetit Rom, nevojitet një bashkëpunim më i mirë i organizatave jo-Rome me ato të komuniteti Rom, veçanërisht në sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijëve si arsimi, shëndetësia, mbrojtja dhe përfshirja sociale dhe drejtësia, etj.

Disa nga aksionet dhe aktivitetet e përbashkëta që mund të realizohen janë:

- » Trajnime për të ndërtuar dhe për të forcuar kapacitetet për udhëheqjen e Romve
- » Fushata ndërgjegjësimi për prindërit Rom në mënyrë që fëmijët e tyre të regjistrohen në shkollë në kohë.

- » Zvogëlimin e fenomenit të "braktisjes" duke luftuar diskriminimin, ngacmimin dhe veçimin në shkolla me mënyra më efikase.
- » Kurse gjuhe për prindërit Rom në mënyrë që ata të mund tu vijnë në ndihmë fëmijëve të tyre në mësimet e shkollës.
- » Influencim në përfshirjen e gjuhës Rome në programin e shkollës.
- » Reduktimi i dhunës, shfrytëzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve dhe të rinjve Rom.
- » Reduktimi i fenomenit të martesës së hershme. Duhet promovuar një kulturë e re për krijimin dhe planifikimin familjar
- » Krijimi i traditave pozitive të familjes dhe sidomos për fuqizimin e vajzave dhe grave.

Bashkëpunimi dhe partneriteti me shtypin dhe median

Shtypi dhe media janë një partner kyç për OJQ-të në krijimin dhe transmetimin e një imazhi të ri të ndryshuar të komunitetit Rom, në mënyrë që ata të mund të aktivizohen në përkrahjen e çështjeve Rome dhe veçanërisht në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë nga diskriminimi dhe veçimi.

- » Shtypi dhe media janë një partner kyç për OJQ-të në krijimin dhe transmetimin e një imazhi të ri të ndryshuar të komunitetit Rom, në mënyrë që ata të mund të aktivizohen në përkrahjen e çështjeve Rome dhe veçanërisht në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë nga diskriminimi dhe veçimi.
- » OJQ-të mund të çojnë përpara lëvizjen e organizmave shtetërore përmes medias dhe gjetjes së zgjidhjeve të domosdoshme për problematikat e thella kronike që prekin fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, siç janë dëbimi me forcë, braktisja ose neglizhimi, dhuna policore dhe brutaliteti, diskriminimi në qasjen e punësimit, diskriminimi në institucionet shëndetësore etj.
- » Pjesëmarrja aktive e shtypit dhe mediave është e domosdoshme veçanërisht në ndryshimin pozitiv të imazhit të popullit Rom dhe Egjiptianë dhe promovimin e një imazhi të rrënjësor mbi vlerat kulturore, traditat dhe kapacitetet individuale të popullsisë Rome dhe Egjiptiane.
- » Bashkëpunimi me median në promovimin e imazhit të vërtetë të komunitetit Rom duke ekspozuar dhe ndarë traditat, praktikat dhe aktivitetet e tyre, madje edhe shqetësimet e tyre, mund të inkurajojë një respekt më të thellë për diversitetin dhe të nxisë dialogun ndërkulturor në shoqëri.
- » Organizatat jofitimprurëse (OJF) mund të bashkëpunojnë me median televizive për ndryshimin e paragjytimeve të kultivuara nga shoqëria kundër komunitetit Rom duke shprehur dhe ndarë trashëgiminë e tyre kulturore, traditat dhe vlerat njerëzore në shoqëri.
- » OJQ-të Rome janë ndërmjetësuesit më të mirë midis gazetarëve dhe komunitetit dhe janë pikërisht këto OJQ që gazetarët u referohen kur trajtojnë çështjet Rome dhe shqetësimet e tyre kryesore²³.
- » Mediat elektronike kanë një rol të rëndësishëm në trajtimin e çështjeve problematike të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe vendosjen e shoqërisë në lëvizje për të ardhur në mbrojtjen e tyre. Ato mund të ndikojnë veçanërisht në parandalimin e diskriminimit, brutalitetit dhe dhunës, shfrytëzimit dhe neglizhencës kundër tyre.
- » Teknikat e bashkëpunimit: reportazhe, kronika, lajme dhe informacione, intervista, foto, biseda në studio etj.

²³ Udhëzues praktik për OJQ-të për parandalimin e diskriminimit kundër Komunitetit Rom NET-KARD (Practical guide for NGOs to prevent discrimination against the Roma communities NET-KARD)

7. Shërbime alternative për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë

uke iu referuar analizave dhe vëzhgimeve të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, vlerësohet se gjendja e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë është shumë problematike në vendet e rajonit pavarësisht strategjive të mira për përfshirjen e Romve dhe Egjiptianëve, kuadrit ligjor të kompletuar dhe praktikave të mira të ndërhyrjes. Këta njerëz ndeshen me shumë vështirësi dhe mangësi që çojnë në shkelje të dinjitetit dhe integritit të tyre dhe më keq akoma, çojnë në përjashtimin social. Për t'i bërë gjërat më mirë, përveç lobimit për gjetjen e zgjidhjeve të përhershme të këtyre çështjeve të lartpërmendura, OJQ-të kanë bërë të mundur krijimin e shërbimeve alternative komunitare dhe të shërbimeve të tjera që mungojnë.

SHEMBULL I MIRË:

ARSIS - Organizata Sociale për Mbështetjen e të Rinjve në Shqipëri e themeluar për shërbimin e emergjencës 72- orëshe për fëmijët dhe të rinjtë në rrezik (kryesisht Rom dhe Egjiptianë), fëmijët e braktisur, të dhunuar të neglizhuar, fëmijë dhe të rinj në kontakt/konflikt me ligjin, nëna të dhunuara me fëmijë. Gjatë qëndrimit të tyre në qendrën e urgjencës për 72-orë, fëmijët/të rinjtë marrin gjithçka nevojitet nga shërbimet multi-disiplinare. Ndërkohë, strukturat e shtetit dhe aktorët e tjerë reagojnë duke ofruar zgjidhje më të qëndrueshme për rastet e analizuara. ARSIS është e pranishme në qendrat sociale publike të fëmijëve në rrezik dhe kujdesit rinor.

7.1 Parimet e detyrueshme të Organizatave Jo Fitimprurëse mbi ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë

- » Ka një respekt që shpërblehet dhe tregohet për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sidomos kundrejt fëmijëve dhe të rinjve pavarësisht gjëndjes së tyre sociale.
- » Çdo fëmijë i vetëm ose i ri trajtohet me respekt të madh dhe në përputhje të plotë me zhvillimin individual të tij / saj, nevojat dhe të drejtat e tij/të saj për mbrojtje dhe zhvillim. Fëmijët / të rinjtë në nevojë trajtohen me respekt si qenie njerëzore me vlera të mira.
- » Të gjithë fëmijët / të rinjtë marrin të njëjtin nivel shërbimi dhe ndihme dhe për këtë nuk pësojnë diskriminim në lidhje me gjëndjen, përkatësinë etnike, gjininë, fenë, moshën, vendndodhjen ose kapacitetin dhe aftësinë.²⁴

²⁴ Protokollin e punës për mbrojtjen e Fëmijëve - Labor Protocol for the Protection of Children, UNICEF, BE, Albania 2015.

- » Shërbimet janë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë fëmijët / të rinjtë.
- » Shërbimet janë të një cilësie të lartë dhe në përputhje të plotë me Standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- » Siguria është e garantuar në rastet kur dhunohen të drejtat e njeriut. Ofrohet mbrojtje për të gjitha format e dhunës dhe brutalitetit, abuzimit, diskriminimit, shfrytëzimit, veçimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtave.
- » Mundësi të barabarta për zhvillimin dhe integrimin shoqëror.
- » Respektimi i personalitetit të fëmijës / të të rinjve dhe zhvillimi i individualitetit, pavarësisë dhe vlerave të tyre pavarësisht etnisë, kombësisë, fesë dhe kulturës.
- » Fëmijët / të rinjtë inkurajohen të shprehin lirisht mendimet, kërkesat, bindjet e tyre etj.
- » Fëmijët / të rinjtë dhe familjet e tyre përfshihen në vendimmarrje për çështje që janë në interes të fëmijëve / të rinjve.
- » Mendimet, sygjerimet dhe propozimet e bëra nga fëmijët dëgjoen dhe merren në konsideratë.
- » Mendimet dhe propozimet e bëra nga të rinjtë merren shumë parasysh.

7.2. Proçedurat (Rrekomanduara) për mënyrën e përshtatshme të qasjes kundrejt fëmijëve dhe të rinjve Rom kur ofrohen shërbimet.

Fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë përballen me varfërinë, neglizhencën, shfrytëzimin, diskriminimin dhe dukuritë e tjera të këqija sociale, të cilat i bëjnë ata të dobët dhe të pambrojtur. Ata janë vazhdimisht në kërkim të forcës dhe dashurisë njerëzore që u mungon në familjet e tyre dhe kjo mund të kompromentojë komunikimin e bërë me ta nëse nuk zbatohen disa procedura, të cilat duhet të jenë të qarta, mbi qasjen e tyre. Duke u përpjekur të shmangë çdo situatë komprometuese dhe/ose çdo situatë të cënueshme që mund të çojë në lëndim nga në keqkuptim, punonjësit që punojnë për OJQ-në duhet të jenë në përputhje me kodin e sjelljes dhe etikës dhe për këtë arsye rekomandohet që disa procedura të respektohen:

Gjithësesi, të punësuarit kanë detyrimin të:

- » Veprojnë si një ekip multidisiplinar në ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.
- » Bëjnë një prezantim të organizatës që ofron shërbimet. Simboli i tyre duhet të ekspozohet dukshëm në mënyrë që të jenë të identifikuar.
- » Bëjnë të qartë dhe të kuptueshëm pozicionin në institucionin që ata përfaqësojnë për palët e treta.
- » Prezantojnë qëllimin e ndërhyrjes dhe të shërbimeve që po ofrojnë për të arritur këtë qëllim. Ai / ajo duhet të sigurohet që informacioni u shpënda në të gjithë grupin e synuar dhe u kuptua nga të gjithë pjesëmarrësit.
- » Tu garantojnë fëmijëve dhe të rinjve që gjithçka është bërë për interesin e tyre më të mirë, për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre.
- » Ofrojnë shërbimet në hapësira të hapura, mjaft të dukshme për palët e treta dhe në prani të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të tjerë si dhe me pëlqimin e anëtarëve të familjes. Ofrimi i shërbimeve në hapësirë të hapur monitorohet lehtë, është gjithëpërfshirës dhe në respektim të Politikës së Ruajtjes dhe së Fshehtësisë.
- » Kushtojnë respektin e duhur ndaj fëmijës / të riut, pavarësisht reagimit ose sjelljes së tij / saj.
- » Vendosin komunikim me fëmijën nëse ai dhe familja e tij e lejon këtë..

7.3. Shërbime të drejtpërdrejta që OJQ-të mund të ofrojnë me qëllim fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.

Shumë shërbime mungojnë dhe për të zbutur këtë, OJQ-të kanë bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta mbështetëse. Qëllimi i tyre është që të forcohen fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.

Shërbimet e OJQ-ve ofrohen në përputhje dhe pajtueshmëri me legjislacionin kombëtar dhe Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara dhe praktikat më të mira deri tani. Standartet e shërbimeve miratohen nga qeveria dhe është e detyrueshme që ato të zbatohen në përputhje me licencën e OJQ-ve.

- » Veprimet ndërhyrëse të ndërmarra nga OJQ-të për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.
- » Duke fuqizuar familjet e tyre.
- » Duke fuqizuar komunitetet ku ata jetojnë.
- » Duke ofruar programe, ndihma direkte dhe qendra të kujdesit ditor.

7.3.1 Fuqizimi i fëmijëve dhe i të rinjve Rom dhe Egjiptianë me anë të fuqizimit të familjes së tyre

Familja është mjedisi natyror në të cilën janë rritur fëmijët dhe të rinjtë, në të cilën kanë një jetë dhe mbrojtje të mirë, kështu që duhen bërë shumë përpjekje për të forcuar dhe përkrahur familjet e fëmijëve dhe të të rinjve. Çdo veprim ndërhyrës për mbrojtjen e familjes duhet të ketë në qendër të vëmendjes fëmijët dhe të rinjtë dhe interesin më të mirë për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre.²⁵

Mbrojtja e familjes jepet pas një analize të hollësishme të nevojave të fëmijëve/të të rinjve dhe një vlerësim të mundësive reale që familja ka në përmbushjen e këtyre nevojave.

Analiza e nevojave kryhet pas disa vizitave në familjen e fëmijës/të të riut.

Vizitat në familje do të bëjë të mundur kryerjen e një investigimi mbi kushtet e jetesës dhe angazhimin e anëtarëve të familjes në procesin e fuqizimit të fëmijës/të të riut, një vëzhgim dhe hetim për lidhjen midis anëtarëve të familjes dhe për disa nga çështjet shqetësuese të këtyre marrëdhënieve, një vëzhgim mbi sjelljen e fëmijës/të të riut dhe marrëdhënia e tyre me anëtarët e tjerë të familjes.

- » Të ndërhysh menjëherë që në momentin e parë sapo të kesh identifikuar, një rrezik kundrejt fëmijës dhe/ose të rinjve në familje, mund të jetë parandaluese, pasi situata do të përkeqësohet dhe rreziku do të ishte edhe më i madh.
- » Ndërhyrja në kohë për fuqizimin e familjeve Rom dhe Egjiptiane, është një strategji e rëndësishme parandalimi.

25 (Procedurat Standarde të Riintegritit të Familjes Retrak, Maj 2013) -Retrak Family Reintegration Standard Operating Procedures, May 2013

Aksionet e ndërhyrjes në familjet Rome dhe Egjiptiane përfshijnë:

Punën parandaluese

Rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim fuqizimin e kujdesit ligjor të prindërve/kujdestarëve të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë

Kjo përfshin:

- » Rritje të ndërgjegjësimit në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e tyre për një prindërim të mirë;
- » Rritje të ndërgjegjësimit për rolin dhe përgjegjësitë e tyre si anëtarë të familjes me qëllim që të sigurojnë mbrojtje, mirëqenie dhe zhvillim për fëmijët e tyre / të rinjtë;
- » Rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka arsimit, veçanërisht për vajzat;
- » Për të ndryshuar qasjen e zakoneve të këqija të jetesës;
- » Rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka kualifikimi profesional për të rinjtë duke u sjellë shembuj të rasteve të të rinjve që kanë marrë arsim dhe më pas janë punësuar në institucione të ndryshme shtetërore, në fushën e biznesit dhe në sektorë të tjerë të ekonomisë etj.;
- » Rritje të ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor siç është kujdesi kundrejt virusit HIV-AIDS, etj.;
- » Rritje të ndërgjegjësimit për marrjen e masave parandaluese mjeksore për ruajtjen e shëndetit seksual, riprodhimin dhe planifikimin familjar etj.;
- » Teknikat e ndërhyrjes: trajnime, fushata ndërgjegjësimi, broshura, postera, diskutime, vizita në shkolla dhe biznese të suksesshme, takime me mësues, biznesmenë, të rinj të arsimuar Rom dhe Egjiptianë, takime ballë për ballë dhe intervista të thella me familjet Rome etj.;
- » Ndarja e praktikave më të mira të prindërimit, arsimit, kujdesit shëndetësor, rritjes së mirë dhe mbrojtjes për fëmijët.

Shërbim i drejtpërdrejtë në arsim

Këto shërbime përfshijnë:

- » Lehtësim në procesin e regjistrimit të fëmijëve në shkolla sipas moshës dhe nivelit të arsimit, vëzhgimit të rregullt dhe monitorimit të pjesëmarrjes dhe progresit të tyre në studime
- » Kthimin, në shkollë, të fëmijëve që e kanë braktisur atë. Përsheptimi i procesit të regjistrimit në klasa të integruara, shkolla profesionale dhe trajnime afatgjata për të rinjtë mbi 14 vjeç. Ndjekje dhe mbështetje të përforcuar në klasa për fëmijët që ndjekin shkollën.
- » Teknika e përdorur: krijimi i një baze të dhënash për fëmijët / të rinjtë që marrin shkollim formal, mbajtjen e kontakteve periodike me shkollat dhe qendrat e trajnimit profesional për të kontrolluar pjesëmarrjen dhe progresin e tyre.
- » Sigurimi i të gjitha materialeve shkollore, uniformave dhe veshjeve falas.
- » Organizimi i programeve të ndryshme me partnerët e OJQ-ve dhe drejtuesit lokalë për të mbështetur, financiarisht me anë të bursave, fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.
- » Rimbursimi i tarifave për institucionet parashkollore dhe të kujdesit shëndetësor.
- » Mësimi i të drejtave qytetare në klasë.

Shërbimet shëndetësore

Këto shërbime përfshijnë:

- » Qasje e vazhdueshme në kujdesin shëndetësor për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë dhe familjet e tyre nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë me strukturat shëndetësore në nivel lokal.
- » Qasja në vizita shëndetësore me specialistë të ndryshëm, pavarësisht mungesës së

- dokumenteve administrative (lejet e banimit, dokumentet e identifikimit etj.)
- » Qasja në kujdesin shëndetësor për adoleshentët gjatë periudhës së shtatzënisë dhe paslindjes
 - » Rimbursimi i ilaçeve për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.
 - » Fushata dhe veprimtari në fushën e shëndetësisë për: trajtimin e hershëm, kujdesin shëndetësor parandalues, parandalimin e drogës, shëndetin riprodhues, kujdesi për fëmijët, ushqyerja me gji, stili i shëndetshëm i jetës, imunizimi dhe vaksinimi, ushqimi i nënës dhe fëmijës etj.
 - » Prezantimi i ndërmjetësve Rom për të lehtësuar qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor.
 - » Ofrimi falas i produkteve higjieno-sanitare dhe materialeve për anëtarët e familjes.

Fuqizimi ekonomik i familjes për të evituar rreziqet dhe implikimin e varfërisë si dhe parandalimin e veçimit të fëmijës nga familja e tij e vërtetë.

Familjet Rome dhe Egjiptiane, në përgjithësi, janë të varfëra dhe në rrethana tepër të ngushta. Duke pasur parasysh këtë, ekziston një nevojë urgjente për t'i angazhuar ato ekonomikisht, në mënyrë që të garantohet mbrojtja dhe zhvillimi i fëmijëve dhe i të rinjve të tyre. OJQ-të mbështesin fuqizimin ekonomik të familjeve Rome dhe Egjiptiane për të siguruar zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.

- » OJQ-të lehtësojnë procesin e regjistrimit të prindërve të tyre si punëkërkuar të papunë në strukturat përkatëse në nivel lokal.
- » OJQ-të lehtësojnë përgatitjen e të gjitha dokumenteve administrative dhe kjo i bën ata të përfitojnë nga skemat e asistencës ekonomike.
- » OJQ-të lehtësojnë procesin e gjetjes së burimeve alternative për ngritjen ekonomike të familjeve Rome nëpërmjet bashkëpunimit të mirë me aktorë të tjerë në nivel lokal ose OJQ të tjera. Këto burime mund të sillen përmes aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura, projekteve të biznesit ose mikrokredive.²⁶
- » OJQ-të lehtësojnë procesin e regjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve në Regjistrin e Gjëndjes Civile (pajisja e fëmijëve dhe e të rinjve me identitet ligjor). Ky regjistrim është bërë i mundur edhe pse ka mungesë të certifikatës së lindjes, ose fëmija ka lindur jashtë mjedisit të kujdesit shëndetësor ose përtej kufijve të një vendi, i cili mund të ketë nevojë për ndihmë juridike dhe administrative dhe shumica e Romve nuk dijnë ku ta gjejnë këtë ndihmë ose nuk mund ta përballojnë këtë.
- » OJQ-të përmirësojnë kushtet e banimit të familjeve të tyre:
 - » Përmes rimbursimit të qirasë së shtëpisë.
 - » Organizimit të aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit në procedurat e përfitimit nga programet e kujdesit dhe strehimit social.
 - » Përmes ndërhyrjes për rehabilitimin e banesës
 - » Përmes lehtësimit të përgatitjes së dokumenteve administrative për të përfituar strehim social, kredi të buta ose shpërblime në qira, etj.
 - » OJQ-të përkrahin me pako ushqimore bazë, familjet, gjatë kohës që anëtarët e tyre kërkojnë punë.

Fuqizimi i familjeve përmes partnerëve kyç dhe aktorëve mbështetës në komunitet

Në mënyrë që të ofrojnë mbështetje më të madhe për familjet, OJQ-të bashkëveprojnë dhe bashkëpunojnë me aktorët kryesorë në komunitet: organizatat me bazë komunitare, shkollat,

²⁶ Procedurat standarde të funksionimit të riintegritimit familjar Retrak, maj 2013 - Retrak Family Reintegration Standard Operating Procedures, May 2013

policinë, institucionet shëndetësore, institucionet fetare, institucionet e qeverisjes vendore dhe personat e tjerë me ndikim në komunitet.

Ky ndërveprim i bën familjet Rome dhe Egjiptiane që të qasen në të gjitha shërbimet e nevojshme.

Të gjitha lidhjet që u ofrohen familjeve në marrjen e shërbimeve të ndryshme duhet të dokumentohen dhe të dorëzohen në dosjen e fëmijëve / të rinjve, në mënyrë që më vonë të mund të kryhet monitorimi dhe vëzhgimi.²⁷

Instrumentet: Krijimi i bazës së të dhënave për shërbimet dhe rolet e ofruara nga të gjithë aktorët në nivel lokal, privat ose shtetëror, për marrëveshjet e bashkëpunimit për shërbimet e ofruara nëpër shtëpi.

7.3.2 Fuqizimi i komunitetit Rom dhe Egjiptianë për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut për zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve

OJQ-të veprojnë drejtpërdrejt me komunitetin Rom dhe Egjiptianë në procesin e fuqizimit të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë. Puna në komunitet bën që problematikat sociale të familjeve Rome dhe Egjiptiane si dhe njerëzve të afërt, të të mundësojnë përcaktimin e atyre fëmijëve dhe të rinjve që preken më së shumti prej tyre.

- » Fuqizimi socio-ekonomik i komunitetit ka një ndikim të mirë në parandalimin dhe reduktimin e rasteve të diskriminimit, dhunës, neglizhencës ose shfrytëzimit ndaj fëmijëve dhe ndaj të rinjve dhe e bën komunitetin Rom dhe Egjiptianë, një mjedis shumë më të sigurt.
- » Zhvillimi i punës në komunitet ka një ndikim të drejtpërdrejtë në fuqizimin e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë, duke siguruar mbrojtjen dhe integrimin e tyre në shoqëri. Vendosija e të gjitha burimeve të komunitetit në lëvizje mund të kontribuojë në mënyrë efektive për fëmijët dhe mbrojtjen e familjes. OJQ-të janë aktorë kyç në dhënien fund të të gjitha pengesave që has komuniteti Rom në qasjen në shërbimet në të gjitha fushat e zhvillimit. Është e rëndësishme që OJQ-të të bëhen të nevojshme për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve Rome dhe Egjiptiane për të pasur akses në të gjitha shërbimet e nevojshme dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës.

DOBRA PRAKSA:

Funksionimi i mirë i institucioneve Rome që veprojnë si ndërmjetësues në shkolla, institucione shtetërore lokale dhe qendrore siç është praktikuar kryesisht në disa vende evropiane, si dhe punësimin e Romve në administratën lokale si pika referimi për çështjet që prekin popullsinë Rome lokale, kanë ndikim në zvogëlimin e diskriminimit në shkolla, duke lehtësuar komunikimin dhe dialogun e ndërsjelltë dhe aksesin e popullsisë Rome dhe Egjiptiane në shërbimet publike dhe duke ndihmuar në konvertimin e interesave dhe pritshmërive të tyre më të mira në programet gjithëpërfshirëse të zhvillimit.

27 Procedurat standarte të funksionimit të riintegritimit familjar Retrak, maj 2013 - Retrak Family Reintegration Standard Operating Procedures, May 2013

Ndërhyrje parandaluese

Linja e ndërhyrjeve përfshin:

- » Zhvillimin e kapaciteteve individuale dhe aftësive për një komunikim më të mirë me fëmijët dhe familjet e tyre.
- » Zhvillimin e programeve me komunitetin për të kapërcyer traditat negative që pengojnë zhvillimin e fëmijëve si martesë dhe prindërimi i hershëm, pabarazia gjinore, patronizimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve, dhuna në familje etj. Parandalimi është çelësi strategjik për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës.
- » Sigurimin e mbështetjes për rritjen e ndërgjegjësimit dhe veprimeve të tjera të komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » Sigurimin e programeve të arsimit ligjor dhe programeve të edukimit për të drejtat e njeriut për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptianë si një masë parandaluese kundër viktimizimit dhe diskriminimit.
- » Forcimin e udhëheqjes së Romve në mënyrë që komuniteti i tyre të udhëhiqet dhe të mobilizohet për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Krijimi dhe promovimi i elitës intelektuale dhe ekonomike brenda komunitetit Rom do të lehtësonte zbatimin e integritit social dhe të gjitha politikat modernizuese në lidhje me shërbimet sociale.
- » Stimulimin dhe mbështetjen e shoqatave Rome që operojnë për mbrojtjen e fëmijëve.
- » Metodën e përdorura: trajnime / workshops që do të ndihmojnë përfaqësuesit e komunitetit Rom të kuptojnë përgjegjësitë e tyre dhe të gjitha përfitimet që mund të pasojnë nëse ka një ndjenjë më të fortë të përgjegjësisë për të punuar së bashku. Trajnimet do të ndikojnë pozitivisht në pjesëmarrësit nëse përdoren metoda interaktive duke përfshirë edhe situatat shembuj (madje edhe përvojat personale) ose studimet në terren.
- » Teknikat e ndërhyrjes: përhapja e shembujve të mirë. Përdorimi dhe shpërndarja e praktikave dhe modeleve të mira do të ishte një teknikë e përshtatshme ndërhyrjeje. Praktika e mirë është lehtësisht e kuptueshme pavarësisht nga niveli arsimor ose kulturor i individëve.
- » Fushata ndërgjegjësimi: postera, fletëpalosje, shfaqje televizive, takime, konsultime etj.

Shërbimet mbështetëse për komunitetin Rom dhe Egjiptianë

Këto shërbime përfshijnë:

- » Ofrimin e shpjegimeve komunitetit Rom për procedurat që duhet të ndiqen në rastet kur fëmijët dhe të rinjtë përballen me dhunën, abuzimin, diskriminimin dhe shfrytëzimin. Ofrimi i informacionit mbi strukturat kryesore që ofrojnë ndihmë në raste të tilla. Ofrimin falas në të gjitha rastet nëse kërkohet Shërbimi ligjor. Kjo lloj ndihme teknike mund dhe duhet të ofrohet edhe nga grupet e tjera (organizatat shëndetësore, shërbimet sociale, policia, etj.) duke punuar me këto komunitete.
- » Informimi i komunitetit Rom dhe Egjiptianë mbi mënyrën sesi mund të përfitojnë nga skemat e mbrojtjes dhe mbështetjes sociale, nga papunësia, nga shtatëzania dhe lindja si dhe nga skemat e tjera mbështetëse për të varfërit. Dhënia e asistencës në përgatitjen e të gjitha dokumenteve administrative të nevojshme për të përfituar nga programet sociale.
- » Dhënien e asistencës juridike dhe administrative, të tilla si orientimi i Romve drejt shërbimit ligjor falas, lehtësimin e procesit të marrjes së identitetit ligjor dhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve për procedurat administrative si: transferimi i lejes së qëndrimit, bashkimet familjare, marrja e kujdestarisë ligjore për fëmijët, divorcet, legalizimin e banesave etj.
- » Lehtësimin e qasjes në strehim dhe punësim (ofrimi i mbështetjes përmes trajnimeve, kurseve profesionale, bizneseve sociale, dhënies së mbështetjes për mikro-bizneset etj.)
- » Mobilizimin e komunitetit në ndërmarrjen e veprimeve pozitive së bashku me qeverinë lokale si: përmirësimi i infrastrukturës së vendbanimit, përmirësimi i higjienës së banesave, etj.

- » Angazhimin e prindërve Rom në këshillat e shkollave për të reduktuar diskriminimin, ngacmimin, ndarjen e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në shkolla dhe braktisjen e shkollës.

7.3.3 Shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në komunitetin e tyre, në qendrat ditore të kujdesit social, dhe në rrugë.

Puna në terren me komunitetin Rom dhe Egjiptianë mundëson që OJQ-të të njihen mirë me çështjet sociale që prekin fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë. Kjo i ndihmon ata të bëjnë një planifikim të të gjitha veprimeve dhe ndërhyrjeve për rehabilitimin, integrimin dhe zhvillimin e tyre.

OJQ-të ofrojnë shërbime multidisiplinare për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në komunitetin e tyre, rrugët, qendrat sociale të kujdesit ditor nëpërmjet programeve të tyre kombëtare dhe rajonale.

Shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë në komunitetin e tyre.

Disa nga ndërhyrjet përfshijnë:

- » Raportimin pranë strukturave korresponduese nëse ka dyshime mbi faktin që fëmijët / të rinjtë po dhunohen, abuzohen ose diskriminohen.
- » Dhënien e informacionit për fëmijët dhe të rinjtë mbi procedurat që duhet të ndjekin në rastet e dhunës, diskriminimit ose abuzimit. Fëmijët dhe të rinjtë janë mësuar se kujt dhe sesi duhet të drejtohen për problemet e tilla dhe për ti zgjidhur ato.
- » Dhënien e Informacionit fëmijëve dhe të rinjve mbi të drejtat e tyre njerëzore dhe të gjitha dispozitat e legjislacionit në mënyrë që ata të përfitojnë nga këto të drejta.
- » Lehtësimin e komunikimit midis fëmijëve dhe të rinjve me familjet e tyre në rast konflikti dhe duke u mundësuar që fëmijët dhe të rinjtë të kthehen sërish në familjet e tyre. Heqjen e fëmijëve dhe e të rinjve nga familjet e tyre do të ndodhë vetëm në rastet kur prindërit e tyre biologjikë dhe / ose të afërmit e tyre paraqesin rrezik për sigurinë dhe të mirëqenies afatgjatë të fëmijëve.
- » Rritjen e besimit dhe e vetëbesimit tek fëmijët dhe të rinjtë përmes zbatimit të programeve për zhvillimin e talenteve, shkathtësive dhe profesioneve të tyre dhe aktiviteteve të përbashkëta me bashkëmoshatarët jo-Rom në shkolla si: ekspozita të pikturave dhe vizatimeve, mini-koncerte, ndeshje sportive, etj.
- » Ndhimën për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë të ndjekin mësimet dhe të përparojnë përmes programeve të monitorimit dhe lehtësimit.
- » Trajtimin në grup bashkarisht me fëmijët dhe të rinjtë, i çështjes së diskriminimit në shkolla dhe ofrimi i mbështetjes për krijimin e klasave miqësore në shkolla dhe përfshirjen e prindërve Rom në këshillat përkatëse të shkollave.
- » Ndjekjen e përparimit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve/të rinjve në shkolla dhe përkrahjen e vazhdueshme me të gjitha materialet e nevojshme didaktike dhe edukative.
- » Dhënien e asistencës psiko-sociale për fëmijët dhe të rinjtë në kontakt / konflikt me ligjin dhe komisaritet e policisë.
- » Dhënien e mbështetjes në rastet që janë në gjyq përmes ndihmës psiko-sociale.
- » Aksionet e zbatimit për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve si lojëra krijuese dhe formuese, lojëra të jashtme dhe lojëra sportive, kampet verore, ecje dhe ekskursionet në vendet historike dhe arkeologjike, vizita në muze, galeri arti, kinema, teatër etj.

PRAKTIKË E MIRË:

Shkolla të lëvizshme. Këto shkolla kanë një program aq të gjallë saqë ato përfshijnë të gjitha fushat e arsimit dhe argëtimit, janë tërheqëse për fëmijët dhe nxisin kuriozitetin e tyre të marrin pjesë dhe studiojnë. Shkollat e lëvizshme janë kaq të dobishme për t'i bërë fëmijët të afrohen dhe të njohin njohuritë në rrethinën e tyre ku fëmijët janë të mirëpritur dhe të respektuar pa kushte. Kjo është një metodë e zhvillimit të madh jo vetëm për fëmijët dhe të rinjtë, por edhe për të rriturit në komunitet. Është veçanërisht tërheqëse për gratë Rome dhe Egjiptiane që nuk kanë pasur mundësi të shkojnë në shkollë. "Mrekullia" e këtij lloji edukimi është se "pakoja e tij magjike" është ofrimi i mundësive të mëdha për njohje, njohuri, zhvillim dhe argëtim. Të mësuarit rreth shkrimit, matematikës, shëndetit, botës, etj. është shumë intriguese dhe tërheqëse për fëmijët, të rinjtë, gratë që nuk kanë marrë asnjëherë arsimim formal ose e kanë braktisur atë plotësisht. Fëmijët nxiten që të regjistrohen në shkolla dhe t'i ndjekin ato përmes kësaj metode. Objektivi i përgjithshëm i shkollave të lëvizshme është të kontribuojë në humanizimin e jetës së rrugës dhe të çrrënjosë fenomenin e përdorimit të drogës dhe dhunës duke ndërtuar solidaritetin dhe respektin për veten.

Ndërhyrjet e OJQ-ve me qëllim fuqizimin e fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë në rrezik

Këto ndërhyrje realizohen duke:

- » Garantuar të rinjtë Rom dhe Egjiptianë që të afrohen dhe të marrin të gjitha përfitimet e siguruar nga ligjet për mbrojtje dhe mbështetje sociale.
- » Lehtësuar të rinjtë Rom dhe Egjiptianë që t'i qasen të gjitha shërbimeve publike siç janë arsimi, shëndetësia, punësimi, strehimi, mbrojtja sociale etj.
- » Mundësuar për të rinjtë Rom dhe Egjiptianë lidhjen me të gjitha shërbimet e tjera alternative si OJQ-të, bizneset, donatorët
- » Lehtësuar procesin e pajisjes së të rinjve Rom dhe Egjiptianë me identitet ligjor.
- » Siguruar informacion për të rinjtë Rom dhe Egjiptianë mbi kurset e trajnimit profesional dhe duke ua lehtësuar qasjen e tyre ndaj këtyre kurseve publike dhe private.
- » Lehtësuar procesin e përfshirjes në vazhdimësi në mënyrë që të rinjtë të përfitojnë nga mbrojtja e nevojshme sociale.

Shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë nëpër qendra ditore të kujdesit social dhe sjellja në qendrat sociale

Në kushtet e varfërisë absolute që prekin familjet Rome dhe Egjiptiane dhe për sa kohë qeveria nuk mundëson, atyre, mirëqënie dhe kushte normale jetese, ndërhyrjet e OJQ-ve, në ofrimin e shërbimeve në qendrat e kujdesit ditor janë të një rëndësie të veçantë. Këto qendra, pavarësisht rolit të tyre mbështetës në ofrimin e shërbimeve bazë dhe shërbimeve për zhvillimin dhe integrimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë si dhe familjeve të tyre, duhet të konsiderohen si një zgjidhje e përkohshme në krahasim me të gjitha përpjekjet e bëra për të ndikuar mbi situatën derisa të gjëndet një zgjidhje e përhershme dhe e qëndrueshme për garantimin e mbrojtjes së barazisë sociale dhe integrimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në shoqëri.

Qëndrat e kujdesit ditor dhe të takimeve ofrojnë shërbime multidisiplinare për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë si dhe grupet e tjera në rrezik:²⁸

- » Për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve;
- » Për zhvillimin e tyre fizik, emocional, social, dhe eksplorues;
- » Për të nxitur aftësinë e të lexuarit dhe të të mësuarit si dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre bazë për jetën;
- » Për vetë-pëmbushjen e tyre profesionale dhe vetë-aktualizimin bazuar në potencialet dhe interesat e tyre;

Llojet e shërbimeve që rekomandohen të ofrohen për fëmijët dhe të rinjtë në qendrat e kujdesit ditor

Këto janë:

- » Shërbimet e asistencës ligjore dhe administrative;
- » Mbështetje e vazhdueshme e shërbimeve bazë: ushqim, veshmbathje, higjenë, etj.;
- » Këshillim individual;
- » Puna në grup me familjet Rome;
- » Asistencë financiare;
- » Trajnim Profesional për të rinjtë dhe familjet;
- » Asistencë mjeksore;
- » Asistencë arsimore;
- » Fushata informimi në lidhje me ligjet për të drejtat e njeriut;
- » Riintegrimi në shkollë.

Qendrat e kujdesit ditor kanë detyrimin të ofrojnë shërbimet në përputhje me Standartet e miratuara të shtetit dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Qendrat operojnë përmes programeve të detajuara dhe planeve mujore për të gjitha shërbimet që ato ofrojnë.

Qendrat e kujdesit ditor zotërojnë dokumente që përcaktojnë dhe rregullojnë marrëdhënien me përfituesit. Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve, Kodi i Sjelljes dhe i Etikës, Kodi Profesional, Deklarata e Fshehtësisë, Procedurat për Mbajtjen e Fëmijëve të Sigurtë, Procedurat e Rekrutimit të Stafit, etj. Janë dokumente funksionale dhe të detyrueshme që duhet të zbatohen.

Qendrat e kujdesit ditor garantojnë sigurinë e fëmijëve. Të gjitha procedurat e ankesave për rastet e dyshuara ose rastet e abuzimit u bëhen të ditura stafit, përfituesve si dhe të tjerëve të cilët janë në marrëdhënie me fëmijët dhe të rinjtë në qendra.

²⁸ Përshtatur sipas Vendim Nr.231, datë 20.03.2013, Shqipëri "Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë në qendrat ditore publike dhe jopublike" (Adopted according to Decision No.231, dated 20.03.2013, Albania "On the standards of social care services for children in need at public and non-public day centers")

Qendrat ofrojnë shërbimet e tyre në ambiente të përshtatshme, miqësore dhe të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë.

Çdo rast/përfitues në qendra menaxhohet individualisht, duke marrë parasysh të gjitha specifikat dhe potencialet e rastit/përfituesit, nga një staf multidisiplinar profesionistësh, të cilët përfshijnë një gamë të gjerë të punonjësve socialë, psikologë, mësues, mjekë dhe avokatë, por jo vetëm. Ofruesi i shërbimit harton një plan kujdesi në bashkëpunim me secilin përfitues të shërbimit. Ky plan përcakton nevojat e vlerësuara të përfituesit, të gjitha aksionet e nevojshme për një zgjidhje ose pëmbushjen e këtyre nevojave dhe progresin/suksesin e matricave. Prindërit/kujdestarët ligjorë dhe familjet përfshihen në hartimin e planit të veprimit dhe përbëjnë elementin më të rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm gjatë menaxhimit të rasteve.

Çdo rast / përfitues merr pjesë drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vazhdueshme, në kontaktet periodike që kryhen dhe me personat e tjerë të përfshirë në jetën e tij/saj. Rekomandohet bashkëpunim me ofruesit e tjerë të shërbimeve në terren, pasi kjo tregon një qasje më të mirë dhe më të integruar të ofrimit të shërbimeve për secilin përfitues dhe gjithashtu rrit cilësinë e këtyre shërbimeve.

Shërbimet e ofruara nga profesionistët janë private dhe konfidenciale për përfituesit. Qendrat e kujdesit ditore kryejnë mbikëqyrje të profesionalizmit në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara.

Shërbimet e veprimtarive në terren për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë. Planet e ndërhyrjes për ndërprerjen e aktivitetit në rrugë

Në këtë dokument termi "fëmijë/të rinj në situatë ruge" i referohet fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë, të cilët kanë lidhje me rrugën dhe janë ose duke punuar ose duke jetuar në rrugë për një periudhë të përkohshme ose sezonale.

Puna në rrugë është një nga teknikat e përdorura për identifikimin dhe referimin e fëmijëve / e të rinjve në situatë ruge dhe, si pasojë, dhënien e ndihmës së menjëhershme. Puna në rrugë është një metodë shumë efikase për identifikimin e fëmijëve dhe të rinjve në rrezik. Shumica e fëmijëve / të rinjve në situatë ruge janë Rom dhe Egjiptianë, fëmijë të braktisur dhe të rinj pa kujdes prindëror dhe të lindur në familje që jetojnë në varfëri ekstreme. Institucionet shtetërore kanë përgjegjësinë të ndërhyjnë dhe të ofrojnë një zgjidhje për fenomenin e jetës në rrugë. OJQ-ve u rekomandohet që të përfshihen ose të përdorin këtë teknikë për të lehtësuar ndjeshëm punën e tyre në identifikimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom në nevojë, dhe si rrjedhojë të planifikojnë të gjitha aksionet e ndërhyrjes për mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre.

Në kategorinë e fëmijëve dhe e të rinjve në situatë ruge përfshihen:

- » Fëmijët dhe të rinjtë që ushtrojnë veprimtarinë e lypjes, për vete, në bashkëpunim me të tjerë, ose që mbahen për krahu nga të tjerë, të cilët japin sende të ndryshme ose kryejnë disa shërbime kundrejt një pagese simbolike.
- » Fëmijët dhe të rinjtë që kanë punë joformale në rrugë si mbledhja e materialeve plastike ose metalike për riciklim ose shesin në rrugë si ambulante.
- » Fëmijët dhe të rinjtë që shesin mallra pranë semaforëve në trafik, nëpër kafene, restorante apo vende të caktuara në rrugë ose ofrojnë shërbime të tilla si parkimi i makinave, transportimi i sendeve të rënda /mallrave ose pastrimi i këpucëve.
- » Fëmijët dhe të rinjtë shfrytëzohen seksualisht për përfitime ekonomike.
- » Fëmijët dhe të rinjtë që janë në konflikt me ligjin, duke kryer krime ruge si transport dhe / ose shitje droge.²⁹

²⁹ Udhëzuesi i procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në situatë ruge, OSCE, Tiranë 2015(OSCE - Guide to Procedures for Identification, Immediate Help and Referral of Children in Street Situation, Tirana 2015)

Puna në rugë kryhet gjithmonë në ekip dhe me një qasje ndërsektorale të miratuar. Rekomandohet që ekipi të jetë i përbërë nga specialistë të fushën e asistencës sociale (punonjës socialë, psikologë, avokatë, mësues, por jo vetëm), në mënyrë që të mundësohet një qasje profesionale për fëmijët dhe të rinjtë në situatë ruge. Procesi i mbrojtjes, zhvillimit dhe integritit të fëmijëve dhe i të rinjve Rom dhe Egjiptianë i nënshtrohet disa etapave. Faza e parë merret me identifikimin e fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë në situatë ruge dhe krijimin e një baze të dhënash e cila do të merret në konsideratë në momentin e hartimit të planit të ndërhyrjes. Faza e dytë përfshin vlerësimin dhe përcaktimin e kushteve dhe nevojave të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe më pas vazhdon me përgatitjen dhe zhvillimin e një plani ndërhyrjeje për mbrojtjen, zhvillimin dhe integritimin e tyre.

OJQ-të janë pjesë e gjithë këtij proçesi dhe kanë detyra të mirë përcaktuara, sidomos kur hartojnë planin e ndërhyrjes dhe zbatimin e veprimeve përkatëse.

Praktika e ndërhyrjes së OJQ-ve për fëmijët dhe të rinjtë në situatë ruge është si vijon:

- » Bashkëpunojnë në mbajtjen e fëmijëve / të rinjve të sigurt menjëherë pas identifikimit të tyre.
- » Ofrojnë ushqim, veshmbathje, kujdes shëndetësor nëse është e nevojshme në përputhje me situatën në të cilën, fëmijët dhe të rinjtë, gjenden.
- » Sigurojnë shërbimet psiko-sociale që të garantojnë mirëqënien psiko-emocionale të fëmijëve / të të rinjve.
- » Orientojnë fëmijët dhe të rinjtë për burimet alternative të shërbimit (qendrat e kujdesit ditor / qendrat e komunitetit etj.)
- » Lehtësojnë komunikimin me fëmijët / të rinjtë dhe familjet / të afërmit ose kujdestarët ligjorë dhe mundësojnë kthimin e tyre në familje nëse është e mundur.
- » Bashkëveprojnë, me të gjitha institucionet shtetërore dhe partnerët e tjerë, nëse shfaqet ndonjë rast i veçantë, deri në përfundimin e çështjes, duke ofruar kapacitetet dhe ekspertizën e tyre njerëzore dhe financiare.

8. Standartet e OJQ-ve në punën me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë (Rekomanduar)

Në detyrimin e tyre statutor dhe ligjor, për të lehtësuar problemet sociale, mbrojtjen, zhvillimin dhe integrimin e fëmijëve dhe e të rinjve Rom dhe Egjiptianë, OJQ-të veprojnë në përputhje me ligjet dhe Standartet shtetërore, protokollet e tyre dhe kodet e brendshme të punës. Çdo OJQ ka një qëllim të përcaktuar qartë, objekt të veprimtarisë së tij, mision dhe vizion me statut dhe me siguri përvojën e fituar dhe të konsoliduar gjatë praktikës së vet kështu që ka ndërtuar një model të përshtatshëm pune. Rekomandimet për Standartet e paraqitura më poshtë përbëjnë një model tjetër si referencë dhe mund të miratohet nëse i shërben interesit më të mirë të fëmijëve/të rinjve. Standartet monitorohen gjatë zbatimit me qëllim që të ngelen "të gjalla dhe aktive" dhe t'i shërbejnë qëllimit për të cilën janë krijuar. Rekomandohet që OJQ-të të përcaktojnë kushte periodike, në mënyrë të tillë që të mund të kryhet monitorimi, vlerësimi dhe zbatimi i tyre të cilat duhet të kryhen në përputhje me ndryshimet ligjore që mund të ndodhin dhe me situatat e reja që mund të përballen gjatë punës me fëmijët dhe të rinjtë.

Standartet e Aplikimit në OJQ-të, bën të mundur:

- » Shërbime cilësore sociale në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- » Shërbime sociale lehtësisht të arritshme për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të synuar Rom dhe Egjiptianë;
- » Respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht rangut, shoqëror, të tyre.
- » Siguri dhe mbrojtje nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, diskriminimit, shfrytëzimit, veçimit, shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve Rom dhe Egjiptianë.
- » Mundësi të barabarta për zhvillim social dhe integrim të fëmijëve, të rinjve, individëve dhe të grupeve në rrezik.

Standart – OJQ-ja vepron në fushën e shërbimeve sociale dhe / ose të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në rrezik

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Ofrimin e shërbimeve cilësore në përputhje me Standartet pasi OJQ-të janë organizata të regjistruara dhe të licencuara si ofrues të shërbimeve sociale dhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në rrezik.
- » Veprimin në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore për fëmijëve dhe të rinjtë.
- » Zhvillimin e teknikave efikase të ndërhyrjes për mbështetjen e fëmijëve dhe të të rinjve, familjeve dhe komuniteteve të tyre.
- » Ofrimin e shërbimeve me profesionalizëm.

Standart: Politika për Ruajtjen e Fëmijëve dhe të të Rinjve (Politikat e mbrojtjes së Fëmijëve)³⁰

- » Dokumenti i Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve është hartuar duke marrë parasysh Konventat Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve, legjislacionin kombëtar, praktikat më të mira, çështjet më problematike dhe shqetësimet e ndryshme në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve që çojnë në procedurat që duhet të ndiqen nga të gjithë.
- » Deklarata e Fshehtësisë rrjedh nga Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe garanton mbrojtjen e çdo informacioni ose të dhëne në lidhje me përfituesit fëmijët dhe të rinj.
- » Është e detyrueshme që këto dokumente të referohen dhe të zbatohen nga çdo punonjës që punon me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë dhe nga pala e tretë që për arsye të ndryshme komunikon me ta.

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Zotërimin, në formë të shkruar, nga ana e OJQ-ve, të dokumenteve "Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve" dhe "Deklarata e Fshehtësisë".
- » Shfaqjen dhe vënien në vend të dukshëm të dokumenteve "Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve" dhe "Deklarata e Fshehtësisë", me qëllim që të shikohet nga të gjithë të interesuarit.
- » Nënshkrimin, nga çdo punonjës, të këtyre dokumenteve "Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve" dhe "Deklarata e Fshehtësisë", pasi ti kenë lexuar, kuptuar dhe të jenë dakort me zbatimin e tyre.
- » Rishikimin periodik dhe ndryshimin nëse do të jetë e nevojshme, të dokumenteve "Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve" dhe "Deklarata e Fshehtësisë" me qëllim që të pasqyrohen në to të gjitha ndryshimet e mundshme të legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve që rrezikojnë përjashtimin social dhe / ose ndryshimet e mundshme të strategjive ndërhyrëse dhe programeve të OJQ-ve.

Standart: Procedurat e shkruara për punësimin e stafit.

OJQ-ja duhet të aplikojë një sistem të repte verifikimi gjatë rekrutimit të stafit përpara se ti punësojë ato. Shumë OJQ kanë procedurë të mira rekrutimi. Kriteret e qarta dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve janë ndihmë e mirë për tu siguruar që punonjësit kandidatë të tregojnë kredibilitet dhe të garantojnë ruajtjen e fëmijëve dhe të të rinjve. Procedurat janë të përcaktuara në përputhje me "Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve", me objektivat e organizatave dhe me forcën individuale të çdo punonjësi. Procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes kanë një efekt parandalues nëse aplikohen me rigorozitet dhe kanë parasysh rëndësinë që ka mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjve. Ato zvogëlojnë rrezikun nëse kontribuojnë në gjetjen e rasteve potenciale të fëmijëve në rrezik. Procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes rinovohen dhe përmirësohen vazhdimisht.

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Rekrutimin në bazë të kriterëve të qarta në përputhje me "Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve".
- » Punësimin e kandidatëve të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mirë përcaktuara, që zotërojnë të gjitha kualifikimet dhe eksperiencat e nevojshme për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik.
- » Patjen e vlerave dhe të qëndrimeve të përbashkëta ndërmjet kandidatëve dhe organizatës.
- » Zotërimin nga ana e kandidatëve e të gjithë informacionit të duhur mbi "Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të të Rinjve", "Kodin e Sjelljes dhe Etikës", dhe mbi të gjitha procedurat e nevojshme që duhen mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve.
- » Zotërimin nga ana e kandidatëve të një dokumenti në të cilin vërtetohet që nuk kanë

³⁰ "Manuali i Mbrojtjes së Fëmijëve në shkollë" - Fondacioni "Terre des hommes", Austrian Development Cooperation; Adopted from the Manual of Child Protection in Schools – "Terre des homes" Foundation, Austrian Development Cooperation

qënë asnjëherë të përfshirë në situata diskriminimi ose abuzimi (ekziston një verifikim dokumentesh personale të kandidatëve të cilat lëshohen nga institucionet përkatëse shtetërore).

- » Mirëpërcaktimin dhe paraqitjen e roleve dhe përgjegjësive të njerëzve të punësuar, veçanërisht pritshmërinë e aftësive të mira menaxhuese.

Standart: OJQ-të operojnë me staf dhe ekspertë të kualifikuar ndërkohë që ofrojnë shërbimet sociale fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Aplikimin e Standartet profesionale për punonjësit që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, në mënyrë që shërbimet cilësore të jenë në përputhje me Standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të shërbimeve.
- » Zotërimin e aftësive të lobimit dhe të përkrahjes të cilat ndikojnë në marrjen e vendimeve në interes të mbrojtjes së Romve, veçanërisht të fëmijëve dhe të rinjve në rrezik.
- » Ofrimin e shërbimeve sociale me qasje të integruar me qëllim që të garantohet një zhvillim më i mirë i Standarteve dhe një cilësi më e lartë shërbimeve sociale pasi zotërojnë edhe kapacitetet institucionale edhe burimet njerëzore.
- » Vlerësimin e performancës dhe vlerësimin e punonjësve e aplikojnë periodikisht për të siguruar cilësi të lartë të performancës së punonjësve pasi janë ato që punojnë direkt me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.

Standart: Udhëzues i shkruar mbi sjelljen kundrejt fëmijëve dhe të rinjve – Kodi i Sjelljes dhe i Etikës

- » Fëmijët janë të ekspozuar ndaj situatave të rrezikshme dhe të dëmshme: është detyrë e punonjësve dhe e të tjerëve që të minimizojnë rrezikun.
- » OJQ zbaton Kodin e Sjelljes dhe Etikës (të shkruar) në marrëdhëniet e krijuara në vendin e punës për të shmangur çdo situatë të mundshme të rrezikshme dhe të dëmshme që mund të shfaqet nga puna e përditshme dhe kontaktet e punonjësve të OJQ-ve dhe/ose të tjerëve që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë si edhe fëmijët e tjerë / të rinjtë në rrezik.
- » Kodi i Sjelljes dhe Etikës mbështetet në dokumentet ndërkombëtare dhe atyre ligjore kombëtare që merren çështjen e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve në rrezik.
- » Kodi i Sjelljes dhe Etikës përcakton qartë se çfarë e bën një sjellje të pranueshme dhe të papranueshme ndaj fëmijëve dhe të rinjve.
- » Kodi i Sjelljes dhe Etikës është i njohur, pranuar dhe i detyrueshëm për të gjithë të punësuarit dhe të tjerë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë.

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Udhëzues të shkruar që përcaktojnë sjelljen e duhur ndaj fëmijëve dhe të rinjve.
- » Zotërimin nga ana e Organizatës e një udhëzuesi mbi Standartet e duhura dhe të kënaqshme të sjelljes që një i rritur duhet të aplikojë ndaj fëmijëve.
- » Të gjithë punonjësit dhe palët e treta që punojnë ose janë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë janë plotësisht të vetëdijshëm për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Kodi i Sjelljes dhe Etikës dhe të gjitha procedurat disiplinore në rast të shkeljes së këtij kodi.
- » Ka një udhëzues mbi normat e pranueshme të sjelljes së fëmijëve dhe të rinjve ndaj fëmijëve dhe të rinjve të tjerë.

- » Ka alternativa, mënyra pozitive të edukimit të fëmijëve dhe pajisjen e tyre me normat e sjelljes që nuk kanë të bëjnë me ndëshkimin fizik ose forma të tjera të trajtimit poshtërues dhe degradues.
- » Organizata promovon një kulturë të dëgjimit dhe respektimit të fëmijëve dhe të të rinjve.

Standart: Procedurat e shkruara për sigurinë e fëmijëve

Parimi udhëzues i protokollit për sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve, është që, siguria e fëmijëve dhe e të rinjve është çështja më e rëndësishme për tu marrë në konsideratë. Fëmijët duhet të jetojnë dhe të rriten në një mjedis të sigurt dhe pozitiv që u inkurajon një atmosferë mesimi. Organizatat kanë detyrimin për të krijuar një mjedis të sigurt respektues për fëmijët dhe të rinjtë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e një fëmije ose të një personi të ri me shumë besim dhe vetëvlerësim.

Kriteret dhe treguesit për zbatimin e Standarteve, përfshijnë:

- » Organizata i ka shkruar të gjitha procedurat dhe nëpërmjet tyre vepron për të ruajtur sigurinë e fëmijëve.
- » Stafi dhe vullnetarët i njohin dhe i aplikojnë procedurat për sigurinë e fëmijëve dhe dinë si të veprojnë kur evidentojnë shqetësime rreth një fëmije, ku duhet të raportojnë dhe se si të marrin shënime.
- » Stafi dhe vullnetarët janë të informuar mirë dhe të trajnuar për të gjitha procedurat e raportimit.
- » Informacioni dhe rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve iu drejtohen të gjitha palëve të interesuara dhe çdo personi në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë.
- » Procedurat që synojnë raportimin dhe trajtimin e shqetësimit për dhunën ndaj fëmijëve janë përditësuar dhe të implementuara vazhdimisht.

Raportim i detyrueshëm për sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve.

- » Çdo punonjës dhe kushdo që punon ose është në kontakt me fëmijët, është mjaft i qartë për mënyrën e veprimit për mbrojtjen e fëmijëve në rastet kur evidentohen abuzime, dhunë, diskriminim ose lloje të tjera të sjelljes që prekin integritetin e fëmijëve dhe të të rinjve dhe që vihen re.
- » Raportimi për të gjitha llojet e ndryshme të shqetësimeve në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve është e detyrueshme për të gjithë punonjësit dhe të tjerët që punojnë ose janë në kontakt me fëmijët.
- » Çdo pretendim ose shqetësim në lidhje me abuzimin ndaj fëmijëve duhet të trajtohet seriozisht dhe po kaq e rëndësishme është dhe për të gjithë ata që ngrenë shqetësimin, për të ndjekur të plotë procedurën e raportimit në mënyrë rigorozë.
- » Çdo punonjës është trajnuar për të zbuluar shenjat e abuzimit dhe/ose të dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjve.
- » Kujdes i veçantë duhet të tregohet në lidhje me fshehtësinë dhe shkëmbimin e informacionit me njerëzit e duhur.
- » Organizata ofron trajnimet e duhura për të mbështetur stafin në detyrën e tyre dhe për të mbajtur të gjithë fëmijët të sigurt.³¹

³¹ Marrë nga "Si të zbatohet Standardet" – Koalicioni i Sigurisë së Fëmijëve): Taken from "How to implement the standards" – Keeping Children Safe Coalition, www.eepingchildresafe.org.uk.

9. Parimet dhe vlerat e përgjithshme të punës, Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve, Protokolle për ruajtjen e fëmijëve dhe të rinjve, Kodi i Sjelljes dhe Etikës

9.1 Politika për mbrojtjen e fëmijës (Shembull i rekomanduar)

Emri i Organizatës:

Kjo politikë u hartua dhe u aprovua:

Organizata (shëno emrin) që tani e tutje do të quhet organizatë, ka përparësi:

Misioni i Organizatës:

Vizioni:

Historiku

Abuzimi me fëmijët është një fenomen global. Kjo ndodh në të gjitha vendet dhe në të gjitha shoqëritë. Ajo përfshin abuzimin³² fizik, seksual, emocional dhe neglizhimin e fëmijëve dhe adoleshentëve. Është gjithmonë pothuajse e parandalueshme. Fëmijët dhe adoleshentët janë potencialisht të ekspozuar ndaj shfrytëzimit, abuzimit, dhunës dhe neglizhimit në familje, komunitete, institucione, organizata, vende private, vende publike të diktuara nga rrethanat e ndryshme, nga njerëz të ndryshëm, përfshirë të deleguarit, personelin ndihmës dhe personelin vartës të shoqatave. Për të adresuar dhe mbrojtur fëmijët dhe adoleshentët nga abuzimi dhe shfrytëzimi i mundshëm gjatë përfshirjes së tyre në Organizatën (vendosni emrin) është hartuar kjo Politikë e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Për zbatimin efektiv të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve, (në vijim, Politika), ai duhet të kuptohet me saktësi nga të gjithë ata që do ta aplikojnë. Organizata do të mundësojë të informohen për këtë politikë dhe të veprojnë në përputhje me të gjitha dispozitat e saj të gjithë punonjësit e saj, praktikantët, vullnetarët, konsulentët etj., me qëllim që të mos dëmtojnë fëmijët me të cilët janë në kontakt brenda apo jashtë punës së tyre.

Nevoja e një politike për mbrojtjen e një fëmije³³

"Të gjitha Organizatat dhe profesionistët që punojnë ose janë në kontakt me fëmijët janë të detyruar të garantojnë që veprimet e tyre janë "të sigurta për fëmijët" dhe për këtë arsye duhet të ketë një "Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve"³⁴. Eurochild ka nevojë për një "Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve" sepse:

³² Abuzimi ose keqtrajtimi i fëmijëve përbën të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe / ose emocional, abuzimit seksual, neglizhencës ose trajtimit neglizhent ose shfrytëzimit tregtar ose tjetër, duke rezultuar në dëm të vërtetë ose potencial të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekst të një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose fuqie. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1999) - Child abuse or maltreatment constitutes all forms of physical and/or emotional ill-treatment, sexual abuse, neglect or negligent treatment or commercial or other exploitation, resulting in actual or potential harm to the child's health, survival, development or dignity in the context of a relationship of responsibility, trust or power. (World Health Organization, 1999).

³³ Përshtatur nga "Politika e Mbrojtjes së fëmijëve" Eurochild. Eurochild është një rrjet organizatash dhe individësh që punojnë në të gjithë Evropën për të promovuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve - Adopted from "Child Protection Policy", Eurochild. Eurochild is a network of organisations and individuals working in and across Europe to promote the rights and well-being of children and young people.

³⁴ Mbrojtja e fëmijëve të sigurt: Standartet për Ruajtjen e Fëmijëve dhe si ti zbatojmë ato - Keeping Children Safe: 'Child Safeguarding Standards and how to implement them

Stafi i organizatës është i mbrojtur: Të gjithë fëmijët kanë të drejtën e lirisë nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, bazuar në UNCRC. Prandaj është përgjegjësi e OJQ-ve të sigurojnë që, të gjitha aktivitetet, politikat, projektet dhe programet e tyre janë “të sigurta për fëmijët”. Kjo do të thotë që stafi nuk përbën rrezik për fëmijët dhe që, programet, politikat dhe praktiket mund të projektohen dhe të zhvillohen në mënyrë të tillë që të promovojnë mbrojtjen e fëmijëve.

Fëmijët janë të mbrojtur: Disa fëmijë janë më të prekshëm nga abuzimi, shfrytëzimi, dhe keqtrajtimi nga duart e kujdestarëve, punonjësve të projektit dhe atyre që kanë akses në të dhënat e tyre personale. Shumë fëmijë të cilët po rriten në rrethana të cënueshme, e kanë përjetuar tashmë thyerjen e besimit ose abuzimin nga një marrëdhënie “i rritur-fëmijë” në formën e abuzimit fizik, psikologjik ose seksual.

Organizata dhe reputacioni i saj janë të mbrojtura: Organizatat që punojnë me fëmijët e cënuar kanë qenë, janë dhe do të vazhdojnë të jenë të prekshëm nga abuzimi derisa çështjet të dalin hapur. Organizatat pa politika mbrojtjeje, udhëzues dhe pa sisteme, janë akoma më të prekshme ndaj akuzave false ose keqdashëse të abuzimit.

Pa një politikë të përshtatshme dhe Standarte për mbrojtjen e fëmijëve, pohimet për abuzim, qoftë të vërteta apo të pabazuara, mund të shkatërrojnë reputacionin e një organizate. Kjo sjell implikime serioze për mbledhjen e fondeve, si dhe dëmtimin e reputacionit për të drejtat e fëmijëve në sektorin e OJQ-ve e marrë si një e tërë.

Kuadri ligjor dhe institucional i politikës (Protokollet, Strategjitë, Programet, Planet e Veprimit)

Dokumenti mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve / së të Rinjve të Organizatës (vendos emrin) është hartuar në përputhje të plotë me frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), “Konventa Evropiane për Kontaktin në lidhje me Fëmijët” të Këshillit Evropian 2005, Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve 2012-2015 dhe dokumente të tjera strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare që adresojnë mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Është nëpërmjet këtij dokumenti mbi Politikën, që organizata tregon përkushtim të madh në pasjen e të gjitha programeve dhe aktivitetëve të saj të udhëhëqura nga interesi më i mirë i fëmijës / i të rinjve³⁵ dhe të gjitha vendimet dhe veprimet e saj të bazuara në parimet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijës ose të të rinjve. Organizata deklaron se të drejtat e fëmijës për mbrojtje nga keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), janë të një rëndësie parësore në të gjithë punën dhe aktivitetet e saj dhe që mirëqenia e fëmijës duhet të jetë e mbrojtur dhe e promovuar. Ky dokument mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve/të të Rinjve tregon qartë se organizata është e vendosur dhe e palëkundur në përgjegjësinë e saj për sigurimin e mbrojtjes për fëmijët dhe të rinjtë duke u siguruar atyre një mjedis të sigurt dhe pozitiv.

Ky dokument mbi Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve / e të Rinjve duhet të lexohet dhe konsiderohet brenda një kuadri dhe konteksti më të gjerë të të gjitha politikave që kanë të bëjnë me punën me fëmijët dhe të rinjtë dhe dokumentet e tjera në pronësi të organizatës për zbatimin e këtij dokumenti (Kodi i Sjelljes dhe Etikës, Procedurat për mbajtjen e fëmijëve të sigurt, Procedurat e Rekrutimit të Stafit, etj). Stafi i organizatës është shumë i vetëdijshëm për shqyrtimin e faktorëve të tjerë që ndikojnë në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, siç janë ato që përdorin drogë dhe pije alkoolike, dhunë në familje, çështjet shëndetësore, ngacmimi seksual dhe shfrytëzimi etj.

³⁵ Termi “të rinjtë” në këtë dokument i referohet grupmoshës 10-18 vjeçare, të cilët sipas Këshillit Evropian quhen “të rinj”, ndërsa sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, ato konsiderohen fëmijë - The term “youth” in this document refers to the age group of 10-18 years old which according to the European Council are termed “youth” whereas according to United Nations Convention on the Rights of the Child, they are children.

Mesazhet kyçe të dhëna nga Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve /të Rinjve

- » Organizata është e vendosur në përfshirjen e të drejtave të fëmijës në programet dhe aktivitetet e saj dhe prandaj është e vendosur të luftojë me çështjet problematike të abuzimit të fëmijëve dhe të rinjve duke zbatuar me vetëdije një praktikë të hapur për menaxhimin e punës me fëmijët / me të rinjtë.
- » Organizata do të rrisë ndërgjegjësimin rreth abuzimit, shfrytëzimit dhe dëmtimit të fëmijëve / të rinjve. Ajo do të marrë të gjitha masat për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga të gjitha format e abuzimit, keqtrajtimit, diskriminimit dhe shfrytëzimit kudo që ofrohen shërbimet e saj.
- » Organizata është e përkushtuar seriozisht për të siguruar të gjitha mundësitë që fëmijët dhe të rinjtë të gëzojnë mirëqenien, të ndjehen të përfshirë, të sigurt, të mbrojtur dhe të respektuar si individë me të drejtat e tyre pavarësisht statusit të tyre shoqëror, përkatësisë etnike, fesë, pikëpamjeve dhe bindjeve.
- » Të gjithë të punësuarit dhe të tjerët që punojnë në organizatë janë të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në parandalimin e abuzimit ndaj fëmijëve dhe të rinjve. Organizata do të sigurojë minimizimin e rrezikut të abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunës kundër fëmijëve dhe të rinjve që në momentin që rekruton dhe përzgjedh anëtarët e stafit dhe të tjerët që mund të kontaktojnë me fëmijët dhe të rinjtë.
- » Të gjithë të punësuarit dhe të tjerët që punojnë në organizatë ose në kontakt me organizatën janë të qartë në lidhje me mënyrat se si ndiqen, trajtohen dhe raportohen shqetësimet e ndryshme rreth abuzimit të fëmijëve /të rinjve, dhunës dhe shfrytëzimit, në rastet kur ato zbulohen dhe evidentohen.

Parimet dhe vlerat kryesore të OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve

Bazuar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, kjo Politikë e Mbrojtjes së Fëmijëve merret me mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve siç përcaktohet nga "Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës", duke siguruar një kuadër gjithëpërfshirës për mbrojtjen, sigurimin dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve. Të gjithë fëmijët dhe adoleshentët e përfshirë në aktivitetet, projektet dhe programet e organizatës (emri i organizatës) kanë të drejtën të kenë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e tyre dhe interesat e tyre më të mira konsiderohen si përparësi kryesore; për të promovuar dhe mbrojtur zhvillimin e tyre në mënyrë që ata të mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë; të vlerësohet, respektohet dhe kuptohet brenda kontekstit të kulturës, fesë dhe përkatësisë etnike të tyre; të dëgjohen dhe të marrin pikëpamjet e tyre të konsideruara me kujdes dhe të inkurajohen e të ndihmohen për të marrë pjesë në vendimet që i prekin ato, duke përfshirë vendimet për mbrojtjen e fëmijëve.³⁶

DETYRË E PANEGOCIUESHME

Puna e OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve, ka detyrë absolute mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi nga brenda organizatave të destinuara për përfitimin e tyre. Kjo detyrë është e domosdoshme dhe e panegociueshme. Pa Standarte dhe mekanizmat e duhura për mbrojtjen, një organizatë jo vetëm që dështon në detyrën e saj primare të kujdesit, por gjithashtu mund të neglizhojë ose tenton të nxisë një mjedis abuzimi.³⁷

³⁶ Politika e Mbrojtjes së Fëmijës, Eurochild - Child Protection Policy, Eurochild.

³⁷ ibid

Prioritet i organizatës është të promovojë të drejtat e fëmijës dhe të kujdeset për mirëqenien e tyre duke marrë parasysh ndjenjat dhe nevojat e fëmijës dhe veçoritë individuale të tij/saj. Ky dokument mbi Politikën thekson faktin se organizata është e angazhuar fuqimisht për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve/të rinjve dhe se mbrojtja e tyre është preokupimi dhe shqetësimi i tyre kryesor.

Organizata bën të qartë që fëmijëve dhe të rinjve duhet t'u jepet mbrojtja duke u krijuar atyre një mjedis të sigurt dhe pozitiv dhe është angazhuar seriozisht për të mbrojtur dhe ruajtur të drejtat e tyre.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve / të Rinjve synon t'i fuqizojë fëmijët dhe të rinjtë duke i bërë ata të vetëdijshëm për të drejtat e tyre duke u krijuar një ambient të sigurt, në mënyrë që ata të mund të ushtrorjnë të drejtat e tyre, të angazhohen dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë. "Detyrimi për të respektuar të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar është e barabartë me detyrimin për ti mbrojtur. Mbrojtja efektive dhe e qëndrueshme për fëmijët mund të arrihet vetëm nëpërmjet dëgjimit të fëmijëve".³⁸

Organizata është e bindur dhe beson fuqimisht se është e papranueshme që një fëmijë të përjetojë keqtrajtime ose dhunime të çdo lloji. Organizata bën të ditur mjaft hapur se nuk do të ketë tolerancë ndaj abuzimit, dëmtimit ose shfrytëzimit të fëmijëve dhe të rinjve dhe është e angazhuar ashpër në marrjen e masave të forta dhe drastike (si p.sh. largimi nga puna, shkarkimi, denoncimi etj.) kundër çdo personi, ose të punësuar ose në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë, nëse prezenca e tij paraqet rrezik dhe ndikon në sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve. Politika siguron që organizata do të ndikojë shumë në parandalimin e keqpërdorimit dhe keqtrajtimit të të gjitha formave të saj, si fizike, emocionale ose seksuale dhe duhet të marrë të gjitha masat në parandalimin e të gjitha formave të abuzimit të fëmijëve dhe të rinjve.³⁹

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve / të Rinjve përcakton detyrën e saj për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve duke respektuar fshehtësinë, integritetin dhe personalitetin e fëmijëve dhe të të rinjve, duke mbrojtur informacionet veçanërisht nëse ka ndonjë dyshim ose besohet fuqishëm se fëmija mund të jetë keqtrajtuar ose mund të jetë në rrezik keqtrajtimi apo shfrytëzimi.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve / të Rinjve do të shërbejë më së miri në krijimin e një mjedisi të favorshëm për edukimin e sigurt dhe të shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimin e potencialit të tyre të plotë fizik dhe psiko-social, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që ndikojnë në jetën e tyre si në sigurimin e një vlerësimi të progresit në drejtim të të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në fushat kryesore të politikave publike që lidhen me to.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve / të Rinjve është hartuar dhe zhvilluar për të siguruar Standarte të larta profesionale të praktikës dhe sjelljes personale të të punësuarve dhe të tjerëve në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë që të mos ndodhë asnjë dëm të fëmijët dhe adoleshentët në çfarëdo shtate pasi ata përfshihen në aktivitetet, projektet dhe programet e organizatës. Dokumenti mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve / Rinisë siguron kontekstin për vendosjen e praktikave të mira në të gjitha çështjet dhe shqetësimet në lidhje me mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve..

Kujt i adresohet Politika për mbrojtjen e Fëmijës/të të rinjve?

Politika për mbrojtjen e fëmijëve / të rinjve është një dokument i detyrueshëm që duhet të zbatohet nga:

- » të gjithë të punësuarit, anëtarët e organizatës janë struktura udhëheqëse (Bordi, Këshilli), praktikantët dhe vullnetarët.
- » të gjithë ata njerëz që punojnë apo veprojnë në emër të organizatës si këshilltarët,

³⁸ Cituar nga Gerison Lansdown, bashkë-kryetar i Grupit Referencë të Pjesëmarrjes në Eurochild -Quote by Gerison Lansdown, Co-chair of the Eurochild Participation Reference Group

³⁹ For all abuse, signs and symptoms of it, neglect, mistreatment, causes of abuse, we recommend: Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijëve (Protocol of Child Protection), page 27-35, Albania 2015, h

ekspertët, instruktorët.

- » të gjithë të rriturit që shoqërojnë fëmijët në aktivitetet ose eventet e organizuara nga organizata.
- » të gjithë ata njerëz që marrin pjesë në eventet, takimet ose tryezat e rrumbullakëta që përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë, gazetarët, sponsorët, donatorët, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, përfaqësuesit e organizatave të tjera partnere etj. siç është rregulluar nga organizata.

Të gjithë individët e lartpërmendur dhe të tjerët në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë në aktivitetet e organizuara të organizatës pritet ta kenë lexuar dokumentin mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve / të Rinjve të organizatës dhe ta kenë nënshkruar deklaratën e angazhimit për t'iu përmbytur parimeve dhe procedurave të saj.

Organizata ka të drejtë të marrë masa dhe disiplinore dhe akte ligjore (denoncimi, raportimi, shkarkimi, etj.) kundër njerëzve për të cilët flet Politika në rast se ato janë të përfshirë në veprime që prekin mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve ose bëjnë shkelje të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve/të Rinjve.

Angazhimi i OJQ-ve në implementimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve/të Rinjve.

Organizata duhet të mundësojë mbrojtjen e fëmijëve / të rinjve duke zbatuar dokumentin mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve / të Rinjve përmes:

» Rritjen e Ndërgjegjësimit

Për të zbatuar Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve / të Rinjve, kjo Politikë duhet të kuptohet me saktësi dhe të jetë e qartë për të gjithë ata që kanë detyrimin ta zbatojnë atë. Organizata siguron të gjithë stafin e saj, praktikantët, vullnetarët, këshilltarët dhe ata që në një mënyrë ose në një tjetër janë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë gjatë programeve ose aktiviteteve të organizuara nga organizata, të jenë të mirë informuar për Politikën dhe të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e saj dhe të jenë të përkushtuar për të përmbytur këtë Politikë për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve/të rinjve. Të gjithë të punësuarit, vullnetarët, praktikantët nënshkruajnë një deklaratë mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve ku tregojnë se ata pranojnë përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe janë të përkushtuar për të mbrojtur dhe mbajtur fëmijët dhe të rinjtë të sigurt.

Sidoqoftë, të gjithë njerëzit që janë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë gjatë programeve dhe aktiviteteve të organizatave, kudo dhe kurdo që bëjnë pjesë, kanë detyrimin të nënshkruajnë një Deklaratë për Pranimin e Politikave.

Për të përmirësuar ndërgjegjësimin, zbatimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së fëmijëve, organizata promovon komunikim të hapur në mënyrë që pretendimet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për abuzimin e fëmijëve, të jenë të qëndrueshme, të hapura dhe të mund të trajtohen në mënyrën e duhur.

» Mirëpërcaktimi i Proçedurave dhe Kriereve

- Seleksionimi i punonjesve, vullnetarëve, të praktikantëve dhe partnerëve

Për të parandaluar fenomenet negative dhe për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve / të rinjve, organizata ka miratuar dhe zbatuar procedura të rrepta për rekrutimin e stafit (siç do ta gjeni bashkëgjatë këtë dokumenti për Politikën), procedurat e kontrolluara mirë për pranimin e vullnetarëve dhe praktikantëve bën të sigurt faktin që janë angazhuar njerëzit më kompetentë, në mënyrë që të gjitha situatat dhe shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve të mund të adresohen dhe të trajtohen sa herë dhe kudo që ndodhin, dhe askush nga stafi, vullnetarët dhe partnerët e tij nuk

duhet të përfshihet në sjellje që përbëjnë abuzime, dhunë dhe shfrytëzim ose ndonjë lloj tjetër sjelljeje që mund të keqinterpretohet, nga fëmijët / të rinjtë, familjet e tyre ose të mitur të tjerë, si një akt që mund të përbëjë apo të çojë në abuzim.

Organizata ka përcaktuar strukturën e saj (një bord kryesor) ose personin e kontaktit (koordinator) të cilit çdo punonjës ose çdo person tjetër mund t'i referohet në rast se dyshohet për ndonjë lloj abuzimi ose dëmi ose që mund të ketë ndodhur vërtet me fëmijën/të rinjtë. Çdo punonjës dhe persona të tjerë të përfshirë, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, janë të informuar mirë ku mund ti trajtojnë çështjet, shqetësimet, dyshimet ose pretendimet e tyre për abuzim, dëm ose keqtrajtim, të cilat janë procedurat e raportimit dhe renditjen e të gjitha veprimeve në vijim deri në trajtimin e situatës problematike..

- Promovimi i sjelljes profesionale dhe komunikimit etik (Kodi i Sjelljes dhe Etikës, Kodi Profesional)

Kodi i Sjelljes dhe Etikës përbën një kuadër të plotë të sjelljes për të gjithë të miturit në kontakt me fëmijët (përveç nëse janë fëmijët e tyre). Kodi i Sjelljes dhe Etikës është një udhëzues për të kuptuar se çfarë e bën një sjellje dhe praktikë të pranueshme kur punon me fëmijët dhe të rinjtë. Ky kod tregon rastet e sjelljeve ose praktikave që nuk janë të pranueshme kur punojnë me fëmijët dhe të rinjtë. Kodi i Sjelljes dhe Etikës është një element kyç i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në organizatë dhe i gjithë stafi duhet të pajtohet me të dhe të tregojë respekt të madh. Kur kodi zbatohet më së miri, zvogëlon dhe kufizon rrezikun e abuzimit të fëmijëve dhe të rinjve.

Të gjithë të punësuarit, vullnetarët, praktikantët dhe të tjerët duhet t'i përmbahen Kodit të Sjelljes dhe Kodit Profesional siç thuhet qartë në kuadrin e Politikës së Organizatës. Parashikimi i organizatës është që këto kode të mbrojnë mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve dhe të zvogëlojnë shumë rreziqet kërcënuese që mund të ndodhin.

- Mbajtja e fëmijëve dhe të rinjve të sigurt

Politika e organizatës ka deklaruar qartë se parimi i saj udhëzues është se siguria e fëmijëve / të rinjve është shqetësimi më i madh dhe se fëmijët duhet të jetojnë në një mjedis të sigurt dhe pozitiv që u inkurajon një atmosferë mësimi. Organizata ka pranuar të marrë përsipër përgjegjësinë dhe detyrimin e saj për të krijuar një mjedis i cili është i sigurt dhe i respektueshëm për fëmijët dhe të rinjtë dhe kontribuon në krijimin tek një fëmijë ose një person vetëbesim dhe vetëvlerësim. Organizata ka shkruar të bëjë të gjitha procedurat e saj funksionale për mbajtjen e fëmijëve / të rinjve të sigurtë.

Organizata monitoron dhe jep vlerësime të vazhdueshme mbi mbajtjen e fëmijëve të sigurt dhe përmirëson situatat në bazë të vlerësimit të kryer.

- Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit për mbajtjen e fëmijëve dhe të rinjve në mënyrë të sigurtë shënjestron të gjithë ata që janë të interesuar dhe çdokush në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë. Stafi i punësuar dhe vullnetarët janë të informuar dhe të trajnuar për procedurat e raportimit; ata janë të mirëinformuar mbi procedurat dhe zbatimin e tyre për Mbajtjen e Fëmijëve/e të Rinjve të Sigurtë. Ata dinë të veprojnë dhe të sillen në rast se ka shqetësime në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë, ku të raportojnë për gjendjen, si të mbajnë shënime, si të sigurojnë mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë e abuzuar. Të gjithë të punësuarit, vullnetarët dhe praktikantët duhet t'i kushtojnë vëmendje të madhe shenjave ose të dhënave që tregojnë se fëmija ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje dhe informon menjëherë Koordinatorin për Mbrojtjen e Fëmijëve.

» **Trajnimet**

- Trajnimi i Punonjësve dhe të tjerëve që janë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë

Organizata është plotësisht e vetëdijshme se veprimet e dhunës dhe abuzimit ushtrohen mbi fëmijët / të rinjtë në të gjitha shoqëritë, në të gjitha kulturat dhe në shumë organizata dhe për këtë arsye punonjësit dhe të tjerët, në çdo kohë, mund të përballen me problemet e abuzimit, dhunës dhe shfrytëzimit.

Për të parandaluar dhe trajtuar sjelljet që i ekspozojnë fëmijët ndaj rreziqeve të llojeve të ndryshme, organizata punon për krijimin e një sistemi të plotë mbrojtës të fëmijëve duke trajnuar punonjësit e saj dhe të palëve të treta që janë të lidhur në aktivitetet e organizatës si direkt ashtu dhe indirekt.

Edukimi dhe trajnimi i të punësuarve dhe të tjerëve në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë gjatë aktiviteteve të organizuara nga organizata është me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve kundër abuzimit, keqtrajtimit dhe shfrytëzimit si dhe për parandalimin e këtyre fenomeneve të këqija. Përmes këtyre trajnimeve organizata lufton injorancën që shoqëron abuzimin dhe dëmtimin e fëmijëve sa herë që ndodh dhe sa herë që organizata e sheh atë. Organizata trajnon stafin e saj dhe të tjerët që të marrin pjesë dhe mbajnë fëmijët dhe të rinjtë të sigurt gjatë gjithë kohës në mënyrë që abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi të mos ndodhin kurrë. Të punësuarit dhe të tjerët që ndërveprojnë me fëmijët dhe të rinjtë janë të trajnuar për të zbuluar dhe njoftuar çdo shenjë ose të dhënë abuzimi dhe dëmtimi në trupin e fëmijëve, se si të veprojnë dhe kujt ti drejtohen në rast se kanë dyshim për abuzim ose nëse abuzimi ka ndodhur vërtetë, si të mund të ndihmojnë fuqizimin e fëmijëve për të mbrojtur veten e tyre kur tu shfaqen përpara sjellje të tilla që i rrezikojnë. Të punësuarit dhe të tjerët në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë zotërojnë kapacitetet, për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë të rehabilitohen, integrohen, dhe identifikojnë të gjitha burimet për mbështetjen e tyre dhe të familjeve të tyre përmes trajnimeve.

- Trajnime për fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve për të mbrojtur veten e tyre nga abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi.

Politika pohon se rritja e ndërgjegjësimit i kthen fëmijët dhe të rinjtë në aktorë për të mbrojtur veten nga abuzimi, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi. Organizata mbështet dhe krijon hapësira për diskutime mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve duke përfshirë fëmijët dhe të rriturit dhe inkurajon shumë fëmijë dhe të rinj të ndihen të lirë dhe të gatshëm për të folur për atë që ata mendojnë apo ka ndodhur ose çfarë kanë përjetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë pa u paragjykuar. Fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për të mësuar rreth rreziqeve që mund të kërcënojnë jetën e tyre, të dinë si të mbrojnë veten dhe të kërkojnë mbrojtje nëse ndihen të kërcënuar ose të abuzuar, keqtrajtuar ose të shfrytëzuar. Fëmijëve dhe të rinjve u jepet informacion në lidhje me Politikën e Mbrojtjes, Kodin e Sjelljes, të gjitha procedurat dhe mekanizmat e ankimit, etj. në mënyrë miqësore të tillë që mbrojtja të sigurohet nëpërmjet përdorimit të tyre. Fëmijët dhe të rinjtë bëhen faktorë të ndryshimit të madh dhe sigurojnë mbrojtjen e jetës së tyre, anëtarëve të tyre të familjes dhe komunitetit nëse ato mbrohen nga abuzimi, diskriminimi dhe çdo lloj dëmtimi fizik, seksual, emocional ose neglizhent.

» **Monitorimi dhe vlerësimi/ Strategjia e Zbatimit: Proçedurat e raportimit**

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve/të Rinjve vazhdimisht do të jetë objekt i monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve rishikohet periodikisht (së paku një herë në tre vjet) në mënyrë që të pasqyrohet çdo ndryshim në legjisllacionin për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve për rrezikun e përjashtimit social dhe / ose ndonjë ndryshim në programet dhe strategjitë ndërhyrëse të OJQ-ve.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të vërë në dukje ato përvoja praktike të rasteve të cilat mund

të ndihmojnë në përditësimin e politikave dhe në ndryshimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të ushtrojë ndikim në strukturën / koordinatorin e mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë gjithmonë aktiv dhe efikas në pëmbushjen e funksionit të tij për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në të mirë të tyre.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimi do të nxjerrë hapur ato praktika të cilat kanë qenë të dëmshme në kundërshtim me Politikën dhe që kanë ndikuar në sigurinë e fëmijëve, dhe më pas do të ndikojë tek organizata duke implementuar masa parandaluese dhe duke ndërprerë marrëdhënien e punës, nëpërmjet veprimeve administrative dhe ligjore, me këdo që ka lejuar këto shkelje të ndodhin.

Ndërsa pret rezultatin e hetimit (që konsiderohet i domosdoshëm), organizata menjëherë pezullon çdo punonjës, vullnetar, anëtar të bordit, këshilltar etj., për të cilin dyshohet se ka shkelur Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Praktikat e mira për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve të zbatuara nga Politika do të shërbejnë për të pasuruar Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe do të përhapen vazhdimisht në mënyrë që ato të përdoren nga të gjithë njerëzit të cilëve u adresohet ky dokument mbi Politikën..

9.2. Protokoll për sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve.

OJQ-të kanë si detyrë garantimin e një ambjenti të sigurt⁴⁰ për fëmijët dhe të rinjtë me të cilët punojnë. Fokusi, i organizatave në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, është mbrojtja e këtyre fëmijëve dhe të rinjve nga të gjitha format e abuzimit, shpërfilljes, shfrytëzimit dhe dhunës, siç përcaktohet në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e fëmijës. Organizatat që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, kanë përgjegjësinë për t'i mbajtur fëmijët dhe të rinjtë të sigurtë duke u ofruar ndërhyrje zhvillimore.

» Protokoli dhe Parimet Udhëzuese

- » Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për mbrojtjen nga abuzimi dhe shfrytëzimi pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar apo politik, mosha, shëndeti fizik apo mendor, orientimi seksual, gjendja familjare dhe sociale, kultura dhe gjendja ekonomike.
- » Të gjithë fëmijët kanë të drejta për mbrojtje dhe siguri në çdo kohë dhe organizata ka për detyrë të ofrojë mjedise dhe programe të sigurta që garantojnë siguri për fëmijët dhe të rinjtë.
- » Mirëqenia e fëmijëve dhe e të rinjve është çështja më e rëndësishme për tu marrë në konsideratë.
- » Dinjiteti, integriteti dhe personaliteti i fëmijës dhe të rinjve respektohen në çdo kohë dhe interesi më i mirë i fëmijëve dhe i të rinjve përbën preokupimin kryesor të organizatës. Organizata nuk duhet të pasqyrojë kurrë ndonjë qasje, sjellje apo qëndrim diskriminues, degradues ose të turpshëm ndaj fëmijëve, të rinjve dhe të të dëmtuarve, të abuzuarve apo të shfrytëzuarve.
- » Mbrojtja e të dhënave personale, fshehtësia dhe privatësia e fëmijëve dhe të rinjve të dëmtuar, të abuzuar dhe të shfrytëzuar përbën një parim të detyrueshëm për organizatën.

40 UNICEF dhe të tjerët përdorin termin "mjedis mbrojtës" për t'iu referuar elementeve të ndryshme që i mbrojnë fëmijët nga diskriminimi, dhuna, shfrytëzimi, abuzimi, neglizhimi dhe mospërfillja e treguar nga familja, komuniteti, shoqëria, ligjet, politikat, shërbimet, strukturat, institucionet dhe mekanizmat e vendimmarrjes etj. Këto elemente funksionojnë veçmas dhe së bashku për të mbrojtur fëmijët. - UNICEF and others use the term "a protective environment" to refer to different elements protecting children from discrimination, violence, exploitation, abuse, neglect and disregard shown by the family, community, society, laws, policies, services, structures, institutions and decision-making mechanisms, etc. These elements work separately and together to protect children

» Parandalimi i dëmtimit të fëmijëve dhe i të rinjve nëpërmjet aktiviteteve të sigurta

- » Çdo punonjës, vullnetar, i brëndshëm/praktikant dhe të tjerë që punojnë, bashkëpunojnë dhe përfshihen në këshillim me organizatën, zgjidhen duke ndjekur një procedurë strikte verifikimi të historikut të së kaluarës të tij, si dhe ka nënshkruar Deklaratën e pranimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve / dhe çdo dokument tjetër që garanton mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve.
- » Çdo individ që vepron përtej strukturave të organizatës (gazetarët, partnerët, donatorët, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe subjektet e tjera private etj.) nuk mund të marrin pjesë në eventet dhe aktivitetet me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, pa miratimin paraprak të organizatës. Në çdo rast, pas miratimit të organizatës, ata duhet të nënshkruajnë një deklaratë besimi dhe një deklaratë tjetër mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve për të siguruar që prania e tyre nuk paraqet ndonjë rrezik për ta. Vizitorët monitorohen vazhdimisht pavarësisht nga qëllimi i pranisë së tyre.
- » Organizata do të bashkëpunojë me çdo shërbim individual, biznesi ose institucioni që ofron shërbime vetëm përmes një kontrate të nënshkruar, sipas të cilës ofruesit e shërbimeve bien dakord të jenë në përputhje me Standartet e pritshme të sjelljes dhe Politikat për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve.
- » Për çdo fëmijë dhe të ri (deri në moshën 18 vjeç) i cili dëshiron të përfshihet në aktivitetet dhe ngjarjet e organizatës, paraprakisht u merret pëlqimi i prindit/kujdestarit ligjor. Ky dokument siguron që fëmijët dhe të rinjtë të jenë të sigurt dhe që prindërit / kujdestarët ligjorë të miratojnë që fëmijët e tyre, të marrin pjesë në aktivitetet e organizatës.
- » Përveç miratimit të prindit/kujdestarit ligjor, organizata ka detyrimin të raportojë dhe të marrë miratimin e strukturave përkatëse (komuna, forcat e policisë) për të gjitha aktivitetet në natyrë larg vendbanimit të fëmijëve dhe të rinjve, në mënyrë që tu ofrohet mbrojtja maksimale nga çdo kërcënim i jashtëm.
- » Fotoreporterët, gazetarët ose të tjerët që dëshirojnë t'u afrohen fëmijëve dhe të rinjve për arsye të ndryshme, sidomos fëmijëve Rom dhe Egjiptianë dhe fëmijëve në rrezik, nuk do të lejohen të kontaktojnë fëmijët dhe të rinjtë (deri në moshën 18 vjeç) pa praninë e prindërve të tyre/ kujdestari ligjor ose pa pëlqimin me shkrim të tyre. Përfaqësuesit e organizatës mund t'i lejojnë këta persona të kontaktojnë me fëmijët dhe të rinjtë vetëm nëse kanë autorizimin me shkrim nga prindërit e tyre/ kujdestarët ligjorë.
- » Organizata ka për detyrë të garantojë shëndetin dhe jetën e mirë të fëmijëve dhe të rinjve në të gjitha aktivitetet e zhvilluara me ta, brenda dhe jashtë. Organizata duhet të informohet për parametrat shëndetësorë të fëmijëve për të siguruar mbrojtjen e tyre nga rreziqet e mundshme siç janë alergjitë ushqimore, ilaçet, agjentët atmosferikë (poleni, ndotja). Përveç numrave të kontakteve të urgjencës spitalore, organizata duhet të garantojë se përmban kuti të ndihmës së parë me të gjitha pajisjet dhe medikamentet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe shëndetit të të rinjve gjatë aktiviteteve dhe duhet të ketë punonjës së shëndetësis për të ndihmuar në këtë proces.
- » Në rast se organizata vepron në një qendër të kujdesit ditor dhe në përputhje të plotë me ligjin, është e detyrueshme që organizata të garantojë një mjedis të sigurt duke respektuar të gjitha rregullat e mbrojtjes nga zjarri (instalimi i aparateve të zjarrit, vendosja e sinjaleve emergjente etj.). Qendra duhet të sigurojë një mjedis miqësor për fëmijët dhe të rinjtë dhe t'i njoftojë me të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për të mbajtur veten të sigurt në rastet e tërmeteve (duke demonstruar dhe shfaqur imazhe, vizatime dhe udhëzime etj.).
- » Organizata garanton monitorimin dhe mbikëqyrjen e qëndrueshme të fëmijëve dhe të rinjve gjatë gjithë aktiviteteve nga punonjësit e saj, vullnetarët dhe praktikantët dhe nga sistemi i kamerave. Organizata siguron që fëmijët dhe të rinjtë të jenë gjithmonë të ruajtur dhe të ndjekur nga stafi i saj në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë të mbahen të sigurt gjatë aktiviteteve të organizuara brenda ose jashtë qendrës.
- » Për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitetet organizohen në mjedise të

hapura dhe të mbikëqyrura mire. Për hapësirat e hapura mbikëqyrja realizohet më mirë kështu fëmijët dhe të rinjtë nuk mund të drejtohen me qetësi.

- » Përdorimi i internetit në mjedisin e qendrës (nëse organizata vepron në qendrat e kopshteve të fëmijëve) është i kufizuar vetëm për qëllime arsimore dhe informative, në mënyrë që fëmijët të mos ekspozohen ndaj rrezikut apo dëmit.
- » Organizata vazhdimisht ofron programe arsimore dhe këshilluese për rreziqet kërcënuese që paraqiten nga ekspozimi dhe përdorimi i pakontrolluar i internetit.

» **Parandalimi nga dëmtimi i fëmijëve dhe i të rinjve nëpërmjet forcimit të stafit të përfshirë dhe qasja pozitive dhe profesionale me fëmijët dhe të rinjtë.**

- » Punonjësit, vullnetarët dhe të tjerët që punojnë me fëmijët e respektojnë Kodin e Sjelljes dhe Etikës në çdo rast dhe veprojnë në përputhje me dokumentet strategjike të organizatës dhe ligjet në fuqi.
- » Punonjësit, vullnetarët dhe të tjerët që punojnë me fëmijët janë të mirëinformuar për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në mbajtjen e fëmijëve të sigurt dhe inkurajohen ti kundëvihen dhe të raportojnë çdo sjellje të papërshtatshme të treguar ndaj tyre.
- » Punonjësit, vullnetarët dhe të tjerët që punojnë me fëmijët tregojnë shumë kujdes në mbikëqyrjen e fëmijëve dhe shmangien e situatave të mundshme që mund të lejojnë abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve.
- » Të punësuarit, vullnetarët dhe të tjerët që punojnë me fëmijët tregojnë shumë kujdes për të mos lejuar fëmijët dhe të rinjtë të jenë në shoqëri të njerëzve të panjohur në mjedise të mbyllura dhe hapësira të pargjistruara.
- » Stafi i organizatës dhe të tjerët në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë njihen me procedurat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe veprojnë në përputhje me to.
- » Stafi, vullnetarët, të brëndshmit/praktikantët dhe të tjerët në lidhje me organizatën e njohin Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve/të Rinjve dhe e zbatojnë atë në punë çdo ditë. Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve/ të Rinjve zbatohet në mënyrën më të mirë të mundshme nga çdo qelizë e organizatës.
- » Çdo punonjës, vullnetar, i brëndshëm/praktikant dhe njerëz të tjerë të përfshirë trajnohen vazhdimisht për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » Të gjithë anëtarët e stafit, vullnetarët dhe të tjerët në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë gjatë disa aktiviteteve, pavarësisht nga statusi i tyre brenda organizatës, kanë përgjegjësinë për të mbrojtur dhe mbajtur fëmijët të sigurt gjatë gjithë kohës.

» **Parandalimi nga dëmtimi i fëmijëve dhe i të rinjve përmes rritjes së ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë të rrezikuar nga abuzimi, shfrytëzimi dhe lëndimi**

- Fëmijët dhe të rinjtë:

- » Janë ndërgjegjësuar mbi të drejtën e tyre për t'u mbrojtur nga abuzimi, dëmtimi dhe shfrytëzimi;
- » Janë konsultuar dhe këshilluar që të mos i japin detaje personale një të rrituri, si p.sh. numrin e telefonit, adresën e e-mail, adresën e Facebook, e Twitter ose të ndonjë profili tjetër që kanë në rrjetet sociale.
- » Janë mirëinformuar se ku duhet të shkojnë dhe kujt ti kërkojnë ndihmë dhe këshilla në rast abuzimi, ngacmimi dhe kërcënimi.
- » janë këshilluar të mos flasin me njerëz të panjohur në mungesë të prindërve të tyre ose anëtarëve të stafit të organizatës.
- » janë trajnuar të zbulojnë sjelljet e papërshtatshme të të rriturve dhe ti raportojnë ato duke u ankuar.

- » janë këshilluar të tregojnë kujdes dhe të mos i mirëpresin ftesat për të udhëtuar me njerëz të panjohur ose ftesa të tjera për të shkuar në kinema ose në ambjentet pa mbikëqyrje.
- » Informacione të veçanta, mbi abuzimin dhe mbrojtjen e tyre, u dërgohen vazhdimisht komuniteteve lokale ku fëmijët dhe të rinjtë bëjnë pjesë, duke mitur gjithashtu edhe ndërgjegjësimin e tyre.

» Siguria e fëmijëve me anë të zbatimit të procedurave

Përvoja ka treguar se abuzimi i fëmijëve ka më shumë gjasa të ndodhë në organizatat që nuk marrin masa parandaluese në strukturën dhe sistemin e tyre, nuk kanë udhëzues ose procedura të formalizuara, për mbrojtjen e fëmijëve dhe e të rinjve dhe për trajtimin e çështjeve të tilla shqetësuese, ofrojnë mbështetje dhe mbikëqyrje të dobët dhe nuk e praktikojnë Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve. Procedurat e mbrojtjes së fëmijëve janë në përputhje me Standartet ndërkombëtare dhe mbështeten në praktikat më të mira të mbrojtjes së fëmijëve. Procedurat e mbrojtjes së fëmijëve janë vënë në dispozicion dhe janë promovuar duke përfshirë të gjithë partnerët (fëmijët, prindërit / kujdestarët ligjorë dhe konsulentët).

» Përcaktimi i Procedurave dhe Udhëzuesve:

- » ndihmojnë për të marrë një përgjigje të shpejtë ndaj shqetësimeve rreth sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve.
- » ndihmojnë organizatën që të përmbushin kërkesat ligjore ose të ndjekin udhëzimet praktike për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » orientojnë stafin dhe të tjerët që të veprojnë saktë dhe shpejtë, kur ka ndonjë shqetësim të fëmijët apo adoleshentët.
- » orientojnë fëmijët dhe të rinjtë që të raportojnë shqetësimet, problemet, dëmtimet dhe abuzimet.

» Monitorimi i strukturave për sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve

Secili punonjës dhe individ i lidhur institucionalisht me organizatën (të zgjedhur ose kontraktuar nga organizata) ka përgjegjësinë të sigurojë mbrojtje dhe siguri për fëmijët.

Organizata cakton një person kontakti (koordinator) ose një strukturë e posaçme⁴¹ (bordi kryesor) për administrimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit, dhunës, lëndimit ose shfrytëzimit të fëmijëve dhe të rinjve, në mënyrë që përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, të atribuohet siç duhet dhe të përcaktohet qartë.

- » Koordinatori për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve ka një rol kyç në parandalimin e dëmtimit të fëmijëve dhe të rinjve, prandaj rekomandohet që ai të jetë specialist në fushën e shkencave sociale, të drejtave dhe të së drejtës së fëmijëve.
- » Koordinatori (ose anëtarët e strukturës së posaçme) zgjidhet duke ndjekur të njëjtat procedura dhe kritere që organizata përdor për punësimin e stafit të tij dhe të tjerëve në marrëdhëniet e punës ose vullnetarizmin. Theks i veçantë vihet në monitorimin e marrëdhënieve me fëmijët dhe të rinjtë para dhe gjatë punës së organizatës, siç kryhen nga strukturat shtetërore.
- » Koordinatori dhe/ose anëtarët e strukturës së posaçme duhet të njihen mirë me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të gjitha

41. Në përputhje me programet dhe projektet, organizata ia delegon përgjegjësitë, jo një individ, por një strukturë të posaçme (bordit kryesor) për të monitoruar sigurinë e fëmijëve dhe e të rinjve, në mënyrë që të administrojë dhe vlerësojë çdo pjesë të informacioneve ose denoncimeve lidhur me shkeljen e sigurisë së fëmijëve dhe së të rinjve. - In accordance with the programmes and projects, the organization gives responsibility not to an individual, but to a certain structure (key board) to monitor children and youth safety, so that it can administer and evaluate every piece of information or denunciation regarding the violation of children and youth safety.

dokumenteve të tjera të nevojshme strategjike të organizatës.

- » Koordinator (ose struktura) zgjidhet nga Bordi Drejtues i organizatës bazuar në aftësitë dhe përvojën e fituar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve në rrezik.
- » Koordinator (ose struktura) vepron në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me detyrat e përcaktuara në këtë protokoll dhe në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rinjve.

» **Detyrat e Koordinatorit dhe/ose të strukturës për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve**

Koordinatori (ose struktura):

- » Merret, analizon dhe vlerëson çdo pjesë të informacionit, raport, denoncim, njoftim të abuzimeve qofshin të dyshuara ose që kanë ndodhur, njoftim për dhunën ose shfrytëzimin e fëmijëve dhe të rinjve me të cilët punon organizata dhe është përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes.
- » Konsulton çdo rast me udhëheqësit dhe drejtuesit e organizatës për qëllime vendimmarrëse, në mënyrë që zgjidhjet, të jepen në interesin më të mirë të fëmijës dhe të rinjve.
- » Bashkëpunon për të zgjidhur dhe/ose adresuar, çdo çështje të raportuar brenda organizatës, strukturave përgjegjëse shtetërore (Bashki/Komunë, Polici, organe hetuese, shërbime sociale), nëse konsiderohet e nevojshme, bazuar në rastin e vlerësuar.
- » Bashkëpunon për çdo rast për të cilin është marrë informacioni, por ai/ajo nuk e ka për detyrë dhe nuk merr përsipër përgjegjësinë për hetimin ose përpjekjen për të hetuar pretendimet e abuzimit apo neglizhimit dhe për të vendosur nëse një fëmijë apo i ri është abuzuar apo jo. Hetimi është detyrë e organeve shtetërore përkatëse.
- » Mban kontakt me prindërit / kujdestarët ligjorë dhe i informon ata për çdo shqetësim lidhur me sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve. Ai/ajo merret me ankesat e prindërve dhe kujdestarëve ligjorë dhe të tjerëve mbi sjelljet e papërshtatshme dhe/ose abuzive ndaj fëmijëve dhe të rinjve, brenda afateve të përcaktuara për zgjidhjen e ankesave. Ai/ajo tregon respekt të madh për kërkesën e fëmijës/të rinjve apo familjarëve për të mos e ndarë informacionin konfidencial me të tjerët, pavarësisht situatës.
- » Krijon dhe menaxhon bazën e të dhënave dhe formate të posaçme në mënyrë që të regjistrohen incidentet, shqetësimet, denoncimet dhe përgjigjet ndaj tyre, si dhe personat që i kanë raportuar ata si dhe fëmijët dhe të rinjtë e dëmtuar.
- » Mban dokumentacionin të sigurt dhe lejon qasje të kufizuar, në mënyrë që informacionet të mbahen konfidenciale dhe të mbrojtura.
- » Mbështet stafin dhe të tjerët që punojnë me fëmijët për të kuptuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në raportimin e ndonjë shqetësimi të vërejtur ose të informuar.
- » Përgatit informacione dhe raporte mbi strukturat drejtuese të organizatës

» **Proçedura e raportimit të abuzimit**

Abuzimi i fëmijëve shpesh mund të jetë i vështirë për t'u identifikuar dhe mund të paraqitet në shumë forma. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë tregues, në vetvete, nuk duhet parë si dëshmi bindëse abuzimi ose neglizhimi. Të gjitha shenjat dhe simptomat duhet të shqyrtohen në kontekstin total të gjendjes së fëmijës. Shenjat duhen gjithashtu të konsiderohen në kontekstin social dhe familjar të fëmijës, pasi abuzimi i fëmijëve nuk kufizohet në grup social, ekonomik apo kulturor.⁴²

⁴² Politikat dhe Proçedurat që mbështesin Mbrojtjen e Fëmijës në DCU "Mbani Fëmijët të Sigurt" - Policies and Procedures supporting Child Protection at DCU, "Keeping Children Safe"

Përderisa është e rëndësishme që gjithmonë të jetë e hapur për shpjegime alternative për shenja të mundshme fizike ose të sjelljes së abuzimit, një grup ose lloje shenjash ka të ngjarë të jenë më shumë tregues për abuzim.

» Faktorët që përbëjnë arsye të qënsishme për shqetësim:

- » tregim specifik ose zbulim nga fëmija që është abuzuar;
- » dëshmi nga personi ose personat që e ka/kanë parë fëmijën të abuzohet;
- » dëshmi, të tilla si një plagë ose sjellje, që është në përputhje me abuzimin dhe që nuk ka gjasa të shkaktohet në një mënyrë tjetër;
- » një dëmtim apo sjellje e vëzhguar, e cila, me një shpjegim të pafajshëm, rezulton që është në përputhje me abuzimin, por kur ka dhe prova vërtetuese që mbështesin shqetësimin se mund të jetë një rast abuzimi, p.sh. lloji i plagës; një shpjegim jo i besueshëm; prova të tjerë të abuzimit ose sjelljeve jo normale;
- » tregim konsistent, gjatë një periudhe kohore që një fëmijë ose një person i ri vuan nga neglizhimi emocional ose fizik.
- » Raportimi retrospektiv i abuzimit të një fëmije nga një i rritur;
- » Shkarkimi i pornografisë së fëmijëve;

Çdo pretendim apo shqetësim për abuzimin e një fëmije duhet të trajtohet seriozisht dhe prandaj është e rëndësishme për të gjithë ata që sjellin një shqetësim të tillë për të ndjekur procedurat për raportimin e abuzimit. Të gjitha kërkesat janë trajtuar me seriozitet, në mënyrë të paanshme dhe me konfidencialitetin maksimal. Dështimi për të dhënë informacion, për të vonuar ose për të parandaluar informacionin, mund të sjellë keqtrajtim dhe shfrytëzim të fëmijës ose të të rinjve dhe në disa raste mund të ketë pasoja kërcënuese për jetën e tyre.

Punonjësit dhe të tjerët që për arsye të ndryshme janë në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë kanë detyrimin të:

- » Raportojnë tek koordinatori / struktura çdo ngacmim të supozuar të fëmijës dhe të rinjve ose të dyshuar ose real, duke plotësuar një formular specifik në dispozicion në zyrën e koordinatorit.
- » Deklarojë me shkrim nëse dyshimet apo shqetësimet e abuzimit ndaj fëmijëve dhe të rinjve janë konstatuar gjatë punës së tyre ose janë raportuar nga të tjerët.
- » Komunikojë me shkrim çdo argument të mundshëm për të provuar se denoncimi nuk është marrë, por ka ndodhur ose është raportuar që ka ndodhur. Jepen informacion në lidhje me personin që ka zbuluar informacionin, kushdo qoftë, një fëmijë ose një i ri, një anëtar i personelit ose një person i rastësishëm, në mënyrë që provohet vërtetësia e denoncimit.
- » Kenë informacion mbi incidentin, informacionin ose raportin ku tregohet që fëmijët dhe të rinjtë, kanë komunikuar vetëm me personin e kontaktit dhe / ose në mungesë të tij / saj, nëse rasti është urgjent, ky informacion i raportohet krerëve dhe drejtuesve të organizatës ose vetëm personave të cilët kanë qasje në informacionet konfidenciale.
- » Duke marrë parasysh shenjat që sugjerojnë që një fëmijë apo i ri është i lënduar dhe ka nevojë për ndihmë, stafi dhe vullnetarët menjëherë e raportojnë situatën tek koordinatori (ose struktura).
- » Ankesat anonime, pavarësisht se janë të vështira për tu trajtuar, nuk do të injorohen në asnjë mënyrë, sepse, në të gjitha rastet, siguria dhe mirëqenia e fëmijëve është çështja dhe preokupimi kryesor. Çdo ankesë e ngjashme lidhur me sjelljen e papërshtatshme të miratuar nga individët brenda ose jashtë organizatës duhet të vihen në vëmendje të koordinatorit / strukturës me qëllim që të vlerësohen dhe të trajtohen.
- » Kur një ankesë, për abuzim, të fëmijëve ose të rinjve, nga një anëtar i stafit, pranohet, informacioni për nivelin e rrezikut ndaj fëmijës ose të rinjve, do të vlerësohet menjëherë

dhe me kujdes, por në të njëjtën kohë do të tregohet maturi për të mos arritur ndonjë përfundim që mund të penalizojë padrejtësisht anëtarin e stafit. Nëse vlerësohet se shqetësimi është i bazuar, rasti i raportohet strukturave shtetërore për hetim dhe mbrojtje të denoncimit.

- » Të gjitha akuzat për abuzim duhen gjithmonë të merren seriozisht. Treguesit e abuzimit nuk janë domosdoshmërisht fakte.
- » Pohimet për abuzime apo dëmtime edhe pas një periudhe të caktuar kohore nga ndodhja e tyre duhet të merren në konsideratë dhe t'i raportohen strukturave shtetërore.
- » Pavarësisht nga natyra e referimit dhe kujt i referohen pretendimet, do të ndërmerren veprime të përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. Të merren masa për të gjetur se çfarë ka ndodhur me fëmijën ose të rinjtë, në mënyrë që ai / ajo të mund të dërgohet për të marrë kujdesin, trajtimin dhe ndihmën e duhur për të kapërcyer traumën.
- » Një fëmijë/i ri që abuzohet ose dëshmon dhunën e kryer mund të humbasë vetëbesimin dhe të ndjehet i pafuqishëm dhe i pavlerë. Menjëherë, fëmijës ose të rinjve të prekur nga incidenti, do ti ofrohet mbështetja dhe ndihma e nevojshme, pas kryerjes së vlerësimit të gjëndjes. Kjo mund të përfshijë gjithashtu një vlerësim mjekësor dhe një trajtim psikologjik.
- » Koordinatorin do të jetë përgjegjës për kontaktimin e familjes (ose kujdestarit ligjor) të fëmijëve /të rinjve dhe informimin e tyre për incidentin si dhe për ndihmën e ofruar. Një raport shpjegues duhet të përpilohet nga ai / ajo për të dokumentuar detajet e incidentit. Gjatë gjithë procesit, duhet të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës.

» Deklaratat e pabaza të abuzimit, dëmtimit ose shfrytëzimit

- » Në rastet kur një punonjës, vullnetar ose një person në marrëdhënie kontraktuale ose bashkëpunimi me organizatën ka bërë qëllimisht një ankesë të pavërtetë abuzimi ose nëse ankesa është me qëllim tendencioz për çdo person tjetër, përveç të gjitha masave administrative që merren, çështja i referohet organeve kompetente shtetërore për shqyrtim.
- » Masat disiplinore dhe njoftimi për autoritetet shtetërore do të fillohen dhe zbatohen për cilindo person që viktimizon dikë tjetër me anë të një ankesë të pabazuar abuzimi, dëmtimi ose shfrytëzimi.
- » Nëse informacioni mbi abuzimin e fëmijëve rezulton i pavërtetë, ankuesi duhet të dëshmojë se personi që ka komunikuar çështjen nuk ka vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe në mirëbesim gjatë përgatitjes së raportit.

» Mbrojtja e Fshehtësisë dhe Privatësisë

Organizata angazhohet ti garantojë fëmijëve dhe të rinjve të drejtën e konfidencialitetit.

- » Për të mbrojtur fëmijën, të gjitha informacionet duhet të trajtohen me kujdes dhe me ndjeshmëri dhe duhet të diskutohen vetëm me personat që kanë qasje në informacionin e rezervuar.
- » Drejtuesi ose kreu i organizatës është përgjegjës për hartimin e një liste të individëve që do të kenë qasje në informacionin konfidencial dhe llojin e informacionit që mund të ndahet për secilën situatë.
- » Përhapja ose përdorimi i informacionit në lidhje me një fëmijë nën moshën 18 vjeç duhet të lejohet vetëm pasi prindërit / kujdestarët ligjorë të jenë njoftuar dhe ta kenë miratuar. Gjithësesi, kërkesa për mosshpërndarje të informacionit të dhënë nga fëmijët dhe të rinjtë ose anëtarët e tyre të familjes, duhet të respektohet. Përrjashtohen nga ky rregull i përgjithshëm vetëm rastet e veçanta që lidhen me sigurinë ose parandalimin e një krimi, pas një vendimi të Bordit Drejtues.
- » Raportet mbi incidentet dhe skedat e fëmijëve dhe të rinjve të dëmtuar, të keqtrajtuar ose të shfrytëzuar duhet të ruhen mirë dhe jo të gjithë duhet të kenë akses në përdorimin e tyre si

dhe nuk duhet të përdoren për ndonjë qëllim tjetër.

- » Emrat dhe të dhëna të tjera mbi identitetin e personave të përfshirë në ngjarjet që kanë ndodhur ose supozohet të kenë ndodhur, nuk duhet të komunikohen jashtë grupit të përfshirë në proces derisa çështja të sqarohet.
- » Nëse informacioni i fshehtë mbi situatën e abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunimit mund ta vendosë fëmijën në rrezik të mëtejshëm dhunimi ose dëmtimi, informacioni duhet të përhapet me kujdes duke paralajmëruar prindërit e fëmijës / të rinjve ose kujdestarët ligjorë.
- » Kur rrezikohet siguria dhe mirëqenia e fëmijëve dhe e të rinjve, fshehtësia ose mbajtja e sekretit të plotë nuk garantohet. Duke vepruar për hir dhe interes të mbrojtjes së fëmijës, ky rast nuk duhet të konsiderohet si një shkelje e konfidencialitetit.

» **Formulari Standart i raportimit rekomandohet të përmbajë:**

- » Të dhënat e personit që raporton shqetësimin.
- » Një shpjegim nëse raportuesi ka qenë i pranishëm apo është informuar, për shqetësimin e fëmijës apo të të riut, nga të tjerët.
- » Një përshkrim i hollësishëm rreth incidentit që ka ndodhur, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e saktë, personat e përfshirë ose të dyshuar.
- » Të dhëna për fëmijën ose të rinjtë që janë dëmtuar ose janë në rrezik të lëndimit / abuzimit.
- » Informacion rreth personit që ka shkaktuar dëmin, veprimet e tij/saj si dhe sjelljet ndaj fëmijës/të të rinjve.
- » Komentet e fëmijës/të të rinjve për incidentin dhe personat që dinë ose kanë qenë të pranishëm gjatë incidentit. Komentet jepen duke përdorur tekstualisht fjalët e vërteta të thëna nga fëmija/nga të rinjtë.
- » Një përshkrim i plagëve ose lëndimeve të dukshme, shenjat e sjelljes, shenja indirekte (mos e kontrolloni fizikisht fëmijën).
- » Detaje për çdo dëshmitar.
- » Detaje për cilindo person tjetër, që është konsultuar, si dhe informacionin e tyre.
- » Nëse raporti përpilohet nga dikush tjetër në emër të fëmijës, ai duhet të plotësohet duke iu referuar fjalëve të fëmijës.
- » Pikëpamja e fëmijës për situatën.
- » Mbështetja e dhënë fëmijës/të të rinjve së dëmtuar ose fëmijës/të të rinjve në rrezik dëmtimi dhe lëndimi.
- » Të dhënat dhe kontaktet e kujdestarit / prindërve, komentet e tyre nëse ata janë kontaktuar dhe se si mund të kontaktohen.
- » Hapa të mëtejshëm të ndërhyrjes për të trajtuar situatën dhe për të rehabilituar fëmijën dhe të rinjtë

Formularin e raportimit të kompletuar, çdo shënim, intervistë ose koment i bërë në kohën e zbulimit/raportimit të abuzimit, të dyshuara ose reale, do të mbahen të sigurta me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe të të rinjve.

9.3. Kodi i Sjelljes dhe Etikës për punonjësit që ofrojnë shërbime të fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë.

Kodi i Sjelljes dhe Etikës i Organizatës ARSIS paraqet një kuadër të përgjithshëm të sjelljes së të gjithë të rriturve në kontakt me fëmijët (me përjashtim të fëmijëve të tyre). Kodi i Sjelljes dhe Etikës është një udhëzues për të kuptuar se çfarë e bën një sjellje dhe praktikë të pranueshme kur punon me fëmijët dhe të rinjtë. Kodi i Sjelljes dhe Etikës është një element kyç i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në një organizatë dhe i gjithë stafi duhet të pajtohet me të, si dhe të tregojë respekt të

madh. Ky kod tregon rastet e sjelljeve ose praktikave që nuk janë të pranueshme kur punojnë me fëmijët dhe të rinjtë. Kur kodi zbatohet më së miri, zvogëlon dhe kufizon rrezikun e abuzimit të fëmijëve dhe të të rinjve.

Kodi i Sjelljes dhe Etikës synon të:

- » mbështesë dhe forcojë të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve dhe ti mbajë ato të sigurt.
- » ofrojë udhëzime për punonjësit e OJQ-ve dhe të përcaktojë pritshmëritë lidhur me parandalimin, pengimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe të të rinjve të identifikuar zyrtarisht ose që dyshohen të jenë në rrezik;
- » zvogëlojë rrezikun e abuzimit ndaj fëmijëve dhe të rinjve përmes zbatimit të Standarteve të rekrutimit dhe të përzgjedhjes së stafit.
- » zvogëlojë rrezikun e abuzimit ndaj fëmijëve dhe të rinjve duke zhvilluar një kulturë menaxhimi të hapur dhe të ndërgjegjshme.

Sjellja: Të gjithë punonjësit e OJQ-ve dhe të tjerët që punojnë me / në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë janë të detyruar të:

- » trajtojnë fëmijët dhe të rinjtë me respektin e duhur dhe ti konsiderojnë si individë me vlera, ti kuptojnë fëmijët dhe të rinjtë në kontekstin e kulturës, fesë dhe kombësisë së tyre;
- » punojnë me fëmijët dhe të rinjtë, me një frymë bashkëpunimi dhe partneriteti të ndërtuara në besim dhe respekt të ndërsjelltë;
- » punojnë me fëmijët dhe të rinjtë në një mënyrë të tillë që të identifikojnë, promovojnë dhe zhvillojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre;
- » merren dhe vlerësojnë pikëpamjet e fëmijëve dhe të të rinjve dhe i konsiderojnë ato seriozisht.
- » ndihmojnë në fuqizimin e fëmijëve dhe të të rinjve duke promovuar të drejtat e tyre si dhe duke rritur gjithashtu vetëdijen e tyre në lidhje me të drejtat e tyre njerëzore;
- » dëgjojnë me kujdes, ti presin dhe ti respektojnë idetë dhe mendimet e fëmijëve dhe të të rinjve;
- » nxisin dhe të ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që i prekin ato;
- » garantojnë që fëmijët dhe të rinjtë do të konsiderohen si aktorë në zhvillimin e shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies, si dhe të vënë, interesin e tyre më të mire, me rëndësi parësore;
- » garantojnë që nevojat e fëmijëve dhe e të rinjve do të identifikohen dhe të plotësohen kur kjo të jetë e mundur.
- » garantojnë mbështetje dhe mbrojtje ndaj fëmijëve dhe ndaj të rinjve në rastet kur vërehen dyshime, deklaratat ose prova të abuzimit ndaj tyre.
- » identifikojnë, raportojnë dhe menaxhojnë çdo çështjeje kur ekziston ndonjë dyshim ose verifikohet që kërcënohen integriteti fizik dhe psiko-emocional i fëmijëve dhe e të rinjve.

Etika e punonjësve dhe të tjerëve në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë:

- » Nuk duhet të përdoren ndëshkime fizike ose psikologjike të asnjë lloji kundër fëmijëve dhe të rinjve.
- » Duhet të ketë një ndërgjegjësim më të madh në lidhje me kujdesin fizik të treguar ndaj fëmijëve dhe të rinjve, në mënyrë që të mos shfaqet ndonjë keqkuptim.
- » Asnjë sjellje abuzive nuk duhet të tregohet. Asnjë aktivitet abuziv ose tjetër, që vë fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, nuk duhet të lejohet.
- » Asnjë marrëdhënie abuzive apo shfrytëzuese nuk duhet të zhvillohet me fëmijët dhe të rinjtë;
- » Asnjë marrëdhënie seksuale e asnjë lloji nuk duhet të lejohet;

- » Përfituesi nuk duhet të ftohet në banesën e tij ose të qëndrojë vonë natën në të njëjtën dhomë pa prezencën e kolegëve ose anëtarëve të familjes;
- » Nuk duhet të ketë ndonjë aktivitet ditor të një lloji personal apo intime që fëmijët dhe të rinjtë mund të trajtojnë personalisht së bashku me punonjësit si larja e vetes, zhveshja e vetes, shkuarja në tualet etj.
- » Asgjë nuk duhet të bëjë që fëmijët dhe të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete të karakterizuara me sjellje që mund të sjellin veprime të kundërligjshme ose abuzive;
- » Fëmijët dhe të rinjtë nuk duhen fajësuar, poshtëruar, keqtrajtuar, degraduar ose të përfshihen në abuzim emocional;
- » Nuk duhet të lejohet asnjë diskriminim ndaj fëmijëve dhe të rinjve duke u dhënë trajtim të padrejtë preferencial;
- » Imazhet e fëmijëve (fotografi, video, etj.) që e dëmtojnë dinjitetin e tyre dhe i poshtërojnë ato nuk duhet të tregohen;
- » Duhet të bëhet shmangia e të gjitha kushteve kompromentuese dhe / ose të rrezikuara që çojnë në dyshime dhe akuza;
- » duke bërë vizita në familje, duke pasur takime, intervista dhe udhëtime, etj. me fëmijët dhe të rinjtë, duhet të merren masa, në mënyrë që të zbatohet rregulli i pranisë së dy njerëzve gjatë procesit dhe të sigurohet vizibiliteti.

9.4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjve me anë të përzgjedhjes së stafit (Udhëzime dhe procedura për OJQ-të)

Këto udhëzime janë shkruar kryesisht për të ndihmuar OJQ-të në zbatimin e një procesi efektiv dhe të drejtë të rekrutimit dhe përzgjedhjes që do të sigurojë emërimin e kandidatit më të përshtatshëm për vendin e lirë të punës. Sidoqoftë, duhet të merren parasysh parimet e barazisë në punësim, kërkesat e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe ligjet në fuqi të punësimit. Arsyeja për të cilën inkorporohen këto udhëzime në këtë document, nuk është që të shpjegohen të gjitha detajet e fazave të procesit të rekrutimit, pasi ato janë të përcaktuara qartë në ligjet përkatëse të punësimit. Qëllimi është që të ndihmohen OJQ-të në përqëndrimin dhe vlerësimin e disa momenteve kryesore gjatë procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes, në mënyrë që askush, i cili ka kërcënuar ose rrezikuar sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, të lejohet të punësohet në një OJQ që punon me fëmijë dhe të rinj.

» Proçesi i Rekrutimit

Rekrutimi është procesi i gjetjes, identifikimit dhe tërheqjes së kandidatëve të përshtatshëm dhe të duhur për të punuar në një organizatë. Është një proces i rëndësishëm sepse cilësia e punonjësve ndikon drejtpërdrejt në funksionimin dhe zhvillimin efikas të organizatës. Rekrutimi bazohet në parimin e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, meritës, transparencës dhe profesionalizmit dhe konkurrencës së paanshme të vlerave dhe aftësive të secilit kandidat.

Rekrutimi është një proces që duhet të bëhet dhe duhet të garantojë transparencë në të gjitha fazat e saj. Ky proces fillon me krijimin e një vendi të lirë pune. Sipas legjislacionit të punës, shpalljet për vendet e lira të punës duhet të vihen në dispozicion në shtypin ditor, faqet e internetit, postimet, e-maillet dhe mjetet e tjera të komunikimit publik. Njoftimi duhet të përcillet në të gjitha burimet që të mund të sigurojë aplikantët potencialë. Nëse kandidatët e mundshëm nuk njoftohen për mundësinë e punës, atëherë të gjitha aspektet e tjera të procesit të përzgjedhjes bëhen fare të pakuptimta.

Njoftimi i konkursit duhet të adresohet për të gjitha palët e interesuara dhe nuk duhet të kufizohet në individë ose grupe preferenciale. Njoftimi i hapur dhe transparent mundëson kandidatët më të kualifikuar për të aplikuar dhe për këtë arsye mund të bëhen më shumë zgjedhje për të gjetur kandidatin më të përshtatshëm për këtë punë.

» Proçesi i Përzgjedhjes

Zgjedhja e kandidatëve kryhet duke ndjekur të gjitha fazat e procesit. Ngrihet një komision përzgjedhës, i cili shqyrton të gjitha dokumentet e aplikantëve dhe, më vonë, bazuar në një sistem të paracaktuar vlerësimi, ata bëjnë një listë të shkurtër të përbërë vetëm nga kandidatët që plotësojnë kriteret. Më pas, kryhen teste me shkrim dhe intervista të strukturuar dhe në fund të këtij procesi shpallet fituesi. Është një proces që duhet të zhvillohet me saktësi në të gjitha fazat e tij, pa neglizhuar ose nënvlerësuar ndonjë prej tyre. Procedurat korrekte përbëjnë filtrat e para në gjetjen e personit të duhur, veçanërisht kur merret parasysh një organizatë që punon me fëmijët dhe të rinjtë. Organizata duhet të konsiderojë që komisioni i përzgjedhjes përbëhet nga njerëz me integritet të lartë moral, specialistë dhe ekspertë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve dhe profesionistëve në fushën e të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që të garantojë një përzgjedhje që siguron konsideratën më të lartë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. Komisioni i përzgjedhjes është lidhja kryesore që siguron integritetin e procesit dhe prandaj duhet të vlerësohet si i tillë nga organizata.

Ekzistojnë disa momente të rëndësishme në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve që duhet të vlerësohen nga organizata maksimalisht. Komisioni i përzgjedhjes, i mandatuar nga organizata për të ndërmarrë të gjithë procesin, duhet të vlerësojë, verifikimin e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga secili aplikant në listën e ngushtë, si shumë të rëndësishme.

» Verifikimi i dokumenteve dhe i të dhënave personale të kandidatëve⁴³

Verifikimi i dokumenteve të kandidatëve dhe i të dhënave personale bëhet përmes kanaleve shtetërore dhe institucionale dhe mund të konsiderohet si një filtër i dytë në sigurimin e përzgjedhjes së kandidatit më të përshtatshëm për vendin e lirë të punës.

Duke verifikuar dokumentet, organizata siguron që kandidatët nuk kanë marrë masa administrative kundër tyre ose ndonjë hetim të veçantë në rastet e abuzimit, dhunës apo shfrytëzimit të fëmijëve dhe të rinjve. Dëshmia e Penalitetit është e një rëndësie të veçantë në interes të sigurimit të mbrojtjes së fëmijëve ose të të rinjve. Ky dokument, pasi vërtetohet për vërtetësinë e tij, është garancia e parë që kandidati mund të gëzojë të drejtën që të punojë me fëmijët dhe të rinjtë dhe se ai / ajo nuk paraqet rrezik potencial për ta nëse është i punësuar. Asnjë kandidat nuk duhet të përfshihet në listën e shkurtër nëse ky dokument nuk bën pjesë në dosjen e tij të aplikimit. Nëse dosja nuk ka Dëshmi Penaliteti, kandidati është i përjashtuar nga konkursi për vendin e lirë të punës. Kjo qasje i shërben vetëm mbrojtjes së fëmijëve dhe të të rinjve dhe në asnjë rast nuk duhet të konsiderohen diskriminues dhe nuk ndikon në barazinë e përfshirjes.

Komisioni i përzgjedhjes duhet të verifikojë letrat referuese ose rekomandimet e lëshuara nga punëdhënësit e mëparshëm ose të tjerë që kanë pasur marrëdhënie pune me kandidatin më me vëmendje dhe me kujdes, pa dashur të nxisë paragjykitime, duhet të kihet parasysh se njerëzit me një regjistër penal ose gjyqësor që kanë lidhje me marrëdhëniet e tyre me fëmijët dhe të rinjtë do të përdorin të gjitha mjetet e mundshme për t'u punësuar në vendet e punës që i vendosin në marrëdhënie me fëmijët dhe të rinjtë. Një verifikim strikt i këtyre dokumenteve do të parandalojë punësimin e njerëzve të pahijshëm në organizatat që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik.

⁴³Duke paraqitur formularët në organizatë, aplikanti konfirmon vërtetësinë e të dhënave personale dhe nënshkruan Deklaratën se ai është plotësisht në dijeni të arsyeve për përpunimin e tyre, duke supozuar se ato janë përpunuar vetëm për përdorim të brendshëm të organizatës në përputhje me qëllim e kësaj kërkese, dhe më pas mbahen të fshëta ose konfidenciale. Në çdo rast, organizata do të sigurojë që kandidati që aplikon për vendin e lirë të punës të ketë të drejtën të ketë qasje të plotë në informacionin e ofruar dhe ndër të tjera, do të sigurojë që me anë të një kërkese drejtuar organizatës, ai do të kërkojë njohje me, fshirjen ose korrigjimin e këtij informacioni. - By submitting the forms to the organization, the applicant confirms the authenticity of the personal data and signs the statement that he is fully aware of the reasons for their processing, assuming that they are processed only for the internal use of the organization in line with the purpose for this application, and are afterwards kept hidden or confidential. In any case, the organization shall ensure that the candidate applying for the job vacancy be given the right to have full access to the information provided and inter alia, shall ensure that through a request addressed to the organization, he or she shall seek acquaintance with, deletion or correcting of this information.

DUŽNOST KOJA JE BEZ PREGOVORA

Sve kazne i / ili administrativne istrage zlostavljanja djece, pedofilije, trgovine ljudima, porodičnog nasilja ili drugih srodnih krivičnih djela rezultiraće automatskim isključenjem kandidata iz procesa.

» **Praktika e përzgjedhjes**

Procesi i përzgjedhjes kurrë nuk do të bëhet vetëm në bazë të vlerësimit të aplikimeve të paraqitura. Komisioni i përzgjedhjes duhet të përdorë praktikat e duhura për të zgjedhur njerëzit më të mirë nga një grup i madh aplikantësh me kualifikim të lartë. Testet dhe intervistat janë praktika që ndihmojnë në përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm. Teknika e përzgjedhjes më të zakonshme është realizimi i një interviste formale të strukturuar, e kombinuar, kur shihet e nevojshme, me teknika të tjera të vlerësimit që organizata gjykon si të përshtatshme për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik dhe përfshin intervista të dyta, teste të ndryshme me shkrim të tilla si testet e personalitetit, testet e aftësive etj.

Në thelb, testet, intervistat, stërvitjet e improvizuara mbi situatat dhe problemet e fëmijëve dhe të rinjve synojnë të vlerësojnë njohuritë e kandidatëve për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë, njohuritë e tyre mbi legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, njohuritë e tyre mbi politikat dhe misionin e organizatës në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, në mënyrë që të bëhet e mundur një strukturim sipas niveleve të larta profesionale dhe një filtër i tretë është siguruar për zgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

» **Influencimi i vlerave profesionale dhe etike në procesin e përzgjedhjes**

Procesi i përzgjedhjes për një punonjës i cili do të punojë me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik nuk mund të përfundojë pa vlerësimin e vlerave etike dhe profesionale të kandidatëve. Komisioni i përzgjedhjes duhet të mundësojë këtë vlerësim përmes teknikave të ndryshme që ato mund të zbatohen, por disa nga vlerat që kandidatët duhet të kenë dhe që rrjedhin nga Politikat e Organizatës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe in të Rinjve të Sigurtë dhe Kodi i Sjelljes dhe Etikës janë përmbledhur si më poshtë:

- » Ata nuk duhet të jenë të përfshirë dhe/ose të dyshuar në ndonjë situatë diskriminimi ose abuzimi.
- » Ata duhet të kenë një qasje pozitive dhe jo diskriminuese kundrejt fëmijëve dhe të rinjve në rrezik.
- » Ata duhet të kenë integritet të lartë moral, personalitet të fortë dhe maturi në kapërcimin e problemeve dhe menaxhimin e situatave të rrezikshme.
- » Vlerat dhe qëndrimet e tyre duhet të jenë në përputhje me ato të organizatës për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » Ata duhet të kenë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik.
- » Ata duhet të kenë eksperiencë në punën me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik.
- » Ata duhet të njohin mirë legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » Është e detyrueshme që ata të jenë të mirënjohur dhe të kenë njohuri të plota të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rinjve, Protokollit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rinjve të Sigurtë, Kodit të Sjelljes dhe Etikës, procedurat që duhen ndjekur për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi.

» Konkluzione

Nëse gjatë gjithë procesit të rekrutimit dhe vlerësimit, organizata i kushton vëmendje përmbajtjes së procesit dhe jo vetëm fazave të tij, shanset për përzgjedhjen e punonjësve të duhur për të punuar me fëmijët, janë më të larta dhe më të shumta.

Në fund të gjithë procesit, pas shpalljes së fituesit dhe të vendimit për emërimin e tij, organizata duhet të kërkojë nga i punësuar, që përveç dokumenteve që janë detyrim ligjor për të rekrutuarit, të plotësojë dhe kërkesat e mëposhtme:

- » Të pranojë Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve të organizatës dhe më pas ta nënshkruajë atë.
- » Të pranojë që gjatë periudhës së praktikës së tij/saj do të veprojë në përputhje të plotë me të gjithë legjislacionin, duke garantuar mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve, me Kodin e Sjelljes dhe të Etikës, me Protokollin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rinjve të Sigurt dhe me të gjitha dokumentet strategjike të organizatës.

9.5 Kodi Profesional i Ofruesve të Shërbimeve për Fëmijët Rom dhe Egjiptian.

(Kualifikimet kryesore, detyrat dhe aftësitë e kërkuara nga praktikantët dhe palët e treta që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptian)

Rekomandohet që punonjësit e OJQ-ve që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë dhe fëmijët dhe të rinjtë në rrezik të jenë specialistë të punës sociale (punonjës socialë, psikologë, sociologë etj.) dhe të fushës arsimore. Ata duhet të kenë një përvojë pune jo më pak se dy vjet në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale. Punonjësit e OJQ-ve që punojnë me romët dhe egjiptianët dhe fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, duhet të mbajnë përgjegjësi si më poshtë.

» Punëtorët socialë, psikologët, mësuesit dhe animatorët socialë

Këto kanë përgjegjësinë të:

- » ruajnë integritetin personal dhe profesional, të zhvillojnë aftësitë dhe dijet, dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shërbimeve dhe të politikave duke menduar për përkujdesjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- » garantojnë që të gjitha aktivitetet e ndërmarra në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptian dhe të tjerët në rrezik të jenë të udhëhequra dhe të bazuara në parimet e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.
- » ofrojnë asistencë dhe ndihmë çdo fëmije dhe të riu Rom dhe Egjiptian duke parandaluar të gjitha problemet nëse është e mundur, ofrojnë mbrojtje kur është e nevojshme, si dhe ofrojnë kujdes dhe rehabilitim duke synuar eliminimin ose zgjidhjen e çështjeve në zhvillim.
- » kundërshtojnë çdo formë diskriminimi, shtypjeje apo shfrytëzimi për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.
- » garantojnë që përfituesi i shërbimit të ndihet i vlerësuar, dhe nuk ndihet i diskriminuar ose i veçuar.
- » sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë të jenë të mbrojtur, kanë një jetë të sigurt, kanë përkujdesje shëndetësore dhe mbështetjen e nevojshme psiko-sociale.
- » sigurojnë që të gjitha vendimet e mëpasshme në marrëveshje me fëmijët dhe të rinjtë, do të jenë në interesin e tyre më të mirë.
- » garantojnë që çdo informacion i marrë nga fëmijët dhe të rinjtë do të mbahet i fshehtë dhe kurrë nuk do të përdoret për ti lënduar ato.
- » Kontribuojnë në gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë në interesin më të mirë të fëmijës dhe të rinjve.

- » Lehtësojë zhvillimin alternativ dhe rritjen e çdo individi fëmijë ose i ri, kështu që ato të arrijnë potencialet e tyre në të gjitha aspektet.⁴⁴

» Punonjësit që merren me menaxhimin e rasteve

Ka një rekomandim i cili sygjeron që punonjësit që merren me menaxhimin e rasteve të jenë profesionistë të kualifikuar në punën sociale dhe të jenë të certifikuar nga institucionet përkatëse shtetërore. Ata duhet të trajnohen në menaxhim dhe të kenë një përvojë të mirë në këtë. Nëse ata nuk kanë përvojë për arsye të ndryshme, OJQ-të rekomandojnë që të mbështeten përmes trajnimit dhe ekspertizës gjatë procesit të menaxhimit. Niveli i kualifikimit dhe shkathtësia profesionale e menaxhuesit të rastit janë faktorët kryesorë që ndikojnë në zgjidhjen e rastit në përputhje me kushtet e përcaktuara dhe Standartet e shërbimeve të kryera.

- » Ata duhet të japin një vlerësim fizik dhe psikologjik të rastit; të ofrojnë mbrojtjen shëndetësore dhe psikologjike nëse duhet.
- » Ata duhet të garantojnë që po veprojnë në interesin më të mirë të fëmijëve dhe të të rinjve në rrezik.
- » Intervista ose dialogu me rastin (fëmijë ose i ri në rrezik) duhet të zhvillohet në prani të psikologut ose të një profesionisti tjetër të OJQ-së.
- » Ata duhet të dëgjojnë dhe të identifikojnë të gjitha shqetësimet e paraqitura nga fëmijët dhe të rinjtë në mënyrën më të mirë të mundshme.
- » Punonjësit duhet të përdorin një komunikim të përshtatshëm dhe të mirëkontrolluar me përfituesin duke i treguar, atij/asaj, respekt për dinjitetin, kulturën dhe traditat. Komunikimi si verbal ashtu dhe jo verbal duhet të mos tregojë diskriminim drejt përfituesit ose të lëndojë krenarinë e tij/saj.
- » Ata duhet të tregohen të kujdesshëm me informacionin, sidomos kur bëhet fjalë për raste delikate, duhet ta mbajnë të fshehtë.
- » Ata duhet të përfshijnë një palë të tretë vetëm nëse përfituesi i ri bie plotësisht dakort me këtë. Pala e tretë mund të jetë institucion shtetëror respektiv ose përfaqësues nga burimet e shërbimeve alternative.
- » Ata duhet të mbajnë shënime të detajuara rreth problematikës dhe të diskutojnë të gjitha zgjidhjet alternative të mundshme me përfituesin derisa të jenë tërësisht të zgjidhura.
- » Në rastet kur prezenca e përfituesit nuk është e nevojshme, punonjësi i OJQ-s që ndjek rastin, duhet që vazhdimisht të informojë përfituesin mbi proçdurat e ndjekura dhe progresin e arritur.
- » Sipas karakteristikave specifike të çështjes, ata duhet ti drejtohen ose ti raportojnë strukturave dhe institucioneve private ose publike respektive dhe t'i nxisë ato drejt një zgjidhjeje të çështjes.
- » Në rastet kur janë në kontakt/konflikt me ligjin, ata duhet të mundësojnë ofrimin falas të shërbimeve psiko-sociale.
- » Në rastet kur vërehen shenja abuzimi, shfrytëzimi seksual ose të çdolloj forme tjetër shfrytëzimi si dhe kur konfliktet janë gati të përkeqësohen në dhunë në komunitet ose familje, punonjësi ka detyrimin të njoftojë, për çështjen, strukturat respektive.
- » Ata duhet të dokumentojnë çdo proçedurë të ndjekur dhe të arkivojnë çdo dokument lidhur me rastin që po menaxhohet.

⁴⁴ Rrjeti i kujdesit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe të të Rinjve (CYC-Net) The International Child and Youth Care Network (CYC-Net).

10. Konkluzionet e Përgjithshme rreth punës së Organizatave të Shoqërisë Civile me Fëmijët dhe të Rinjtë Rom dhe Egjiptian children and youth

Çështja e komunitetit Rom dhe çështja e grupeve të marginalizuara janë bërë gjerësisht pjesë e axhendës politike dhe socio-ekonomike në dekadën që po jetojmë. Ekziston një angazhim aktiv dhe përfshirje e politikë bërësve në hartimin e strategjive, programeve dhe ligjeve, duke u përqendruar në mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të romëve, egjiptianëve, emigrantëve, refugjatëve, individëve dhe grupeve të cënueshme. Ka shumë strategji dhe programe që janë hartuar në secilin vend dhe fokusi i tyre është të arrijnë një përfshirje gjithnjë e në rritje të popullsisë rome dhe egjiptiane në sistemin arsimor, sistemin e mbrojtjes dhe përfshirjen sociale, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe strehimin, duke synuar kështu reduktimin e varfërisë, pabarazisë, diskriminimit dhe përjashtimit.

Ka një qasje shumë të ndjeshme të marrë nga shtetet dhe shoqëria për çështjen e romëve dhe ka një dëshirë shumë të mirë për t'u angazhuar në ndërhyrje të integruara për të siguruar një zgjidhje për problemet që prekin të gjithë sektorët jetikë. Kjo përbën një përpjekje vizionare që ndoshta do të sjellë rezultate pozitive dhe të frytshme në dekadat e ardhshme për të gjithë ata njerëz që sot ndjejnë sikur janë të përjashtuar ose atyre që realisht janë të përjashtuar. Të gjithë indikatorët e zhvillimit tregojnë parametrat e dobët shëndetësorë për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptianë, nivelin e shkollimit, fenomenin e braktisjes së shkollës për shkak të ngacmimit, diskriminimit, veçimit, varfërisë, nivelit të ulët të jetesës dhe të përjashtimit social. Fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe egjiptianë janë shndërruar në "punëtorët e mugës" duke përjetuar të gjitha rreziqet që ky stil jete përfshin si kërcënimi për jetën, rrezik abuzimi, trafikimi, shfrytëzimi etj.

Një situatë e tillë është e papranueshme për një shoqëri demokratike ku të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut, të gjitha liritë themelore pavarësisht përkatësisë etnike, besimit, kulturës dhe bindjeve janë të sanksionuara në mënyrë të vendosur në Konventat dhe ligjet ndërkombëtare, në Kushtetutë dhe në ligjet kombëtare. Popullsia me të cilën po përballemi është shumë më e vogël se moshë mesatare e popullsisë jo-rome dhe përfshin fëmijë dhe të rinj që, për shkak të varfërisë, etnisë dhe kulturës së tyre, përjetojnë varfërinë dhe mungesën e gjendjes civile, politike, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, në të gjithë Evropën dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor, ashtu siç shtrihet në këtë dokument.

Ekzistojnë pritshmëri për ndryshime pozitive dhe organizatat e shoqërisë civile po ushtrojnë një ndikim të madh dhe bashkëpunojnë me institucionet shtetërore për të përhapur dhe përsheptuar ndryshimet e nevojshme. Organizatat rome dhe vetë populli rom duhet të kuptojë se ata duhet të jenë të parët që të ushtrojnë presion mbi qeveritë dhe shoqërinë në mënyrë që të bëjnë ndryshimin e jetës së tyre dhe të fëmijëve të tyre. Ata duhet të influencojnë më tepër që të arrijnë të drejtat që i'u mungojnë, pavarësisht nga fakti se ligjet i garantojnë këto të drejta. Organizatat rome duhet të misin besimin në përpjekjet e tyre, të jenë të hapura dhe gjithëpërfshirëse, të largohen nga nepotizmi dhe korrupsioni dhe të fuqizojnë komunitetet rome për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ndryshimi duhet së pari të vijë nga vetë romët dhe egjiptianët që të angazhojë të gjithë shoqërinë për të adoptuar një qasje të re për të gjithë individët dhe grupet në nevojë.

Shtetet e kanë fuqinë për të bërë ndryshimet e shumëpritura, duke gjetur zgjidhje ligjore për çështjet e strehimit, punësimin, regjistrimit civil, zhvillimit dhe integritet. Edhe nëse zgjidhjet nuk mund të gjenden brenda kuadrit aktual ligjor, shtetet dhe shoqatat mund të ndikojnë në politikë në mënyrë që të ndryshojnë ligjet ekzistuese ose të hartojnë ligje të reja që pasqyrojnë situatën aktuale në fushat kryesore të jetës rome dhe egjiptiane. Ka ardhur momenti që të kapërcehet periudha e deklaratave politike dhe të merren iniciativa konkrete që mund të zgjidhin shumë çështje problematike dhe të sjellin ndryshime për të drejtat e romëve dhe egjiptianëve dhe fëmijëve të tyre.

11. Rekomandimet

Disa nga rekomandimet janë:

- » Duhet të bëhet një rregullim i gjëndjes ligjore të popullsisë rome dhe egjiptiane që jeton në rrethana të ligjshmërisë së pazgjidhur (p.sh. pasuria rome pa të drejta pronësie, ose që nuk janë të përfshirë në planet urbane të atij vendi, familje apo vendbanime/shtëpi pa status qëndrimi të ligjshëm në vendet ku romët dhe egjiptianët kanë jetuar realisht për dekada të tëra).
- » Duhet të sigurohen lehtësime administrative dhe financiare për të përfshirë më shumë familje rome dhe egjiptiane në programet e strehimit dhe punësimit.
- » Duhet të ndërmerren iniciativat ligjore dhe administrative për të zgjidhur çështjen e pashtetësisë për fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe egjiptianë dhe për të gjithë popullsinë Rome dhe/ose Egjiptiane në përgjithësi. Duhet të sigurohen zgjidhje për problemet që pengojnë qasjen e plotë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në shërbimet e gjëndjes civile.
- » Ligjet duhet të zbatohen dhe të bëhen efikase në parandalimin e martesave të hershme të fëmijëve Rom dhe Egjiptianë.
- » Duhet të sigurohet edukimi dy gjuhësor për fëmijët Rom që ndjekin klasën e parë, lektorë Rom në shkolla, pjesëmarrje të prindërve Rom në bordet e shkollave dhe një adresim dhe trajtim i duhur i problemeve të ngacmimit, veçimit dhe diskriminimit me qëllim të reduktimit të fenomenit të braktisjes së fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë.
- » Përmes zbatimit të akteve ligjore, duhet të arrihet një parandalim i veçimit të fëmijëve Rom dhe Egjiptianë në shkolla. Ekziston një përjashtim në ato raste kur veçimi bëhet për shkak të mësimdhënies në një gjuhë të caktuar ose për shkak të distancës më të madhe nga shkollat e dominuara nga nxënësit e komuniteteve të shumicës. Normat ligjore gjithashtu duhet të sigurojnë masa efektive për të parandaluar edhe zhdukjen e veçimit. Duhet të parashikohen masa efektive për të parandaluar diskriminimin.
- » Duhet të sigurohen zgjidhje ligjore për të drejtat kulturore të komunitetit Rom dhe Egjiptianë, të garantuara me Kushtetutë, por mendojmë se ato ndonjëherë janë të pamundura të aplikohen pasi Romët dhe Egjiptianët, në disa vende, nuk njihen si pakica kombëtare. Duhet të ketë promovim të njohjes së identitetit Rom dhe Egjiptian si pjesë integrale e trashëgimisë kulturore.
- » Duhet të parashikohet pasurimi i programeve zyrtare të trajnimit të mësuesve me një kurrikulum mbi tolerancën ose një metodologji të veçantë për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë Rom dhe Egjiptian dhe fëmijët dhe të rinjtë e tjerë të deprivuar ashpër.
- » Ligjet, VKM, Udhëzimet duhet të shoqërohen nga një projekt-ligj financiar që të zbatohen dhe të hyjnë në fuqi.
- » Duhet të krijohet një mekanizëm efektiv monitorimi për të zbatuar ligjet dhe programet e zhvillimit dhe për të siguruar mbrojtje dhe kujdes më të mirë social për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë.
- » Kualifikimet dhe trajnimet duhet të ofrohen për të rritur
- » profesionalizmin e administratës publike, në mënyrë që ligjet të bëhen të qasshme për të gjitha kategoritë në nevojë, pavarësisht nga arsimi i tyre, mosha, përkatësia etnike, vendbanimi etj..

- » Duhet të ndërmerren iniciativa ligjore dhe administrative për të ndaluar fenomenin e "daljes në rrugë" (Puna në rrugë e fëmijëve dhe e të Rinjve Rom dhe Egjiptianë)
- » duhet të miratohet një qasje e strukturuar ndërsektoriale për të zgjidhur shumë nga problemet sociale të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë dhe çdo individ tjetër në nevojë.
- » Duhet të sigurohet një bashkëpunim dhe partneritet i institucionalizuar midis OJQ-ve dhe shtetit me qëllim të zgjidhjes së problemeve të fëmijëve dhe të rinjve Rom dhe Egjiptianë si dhe të kategorive të tjera të prekshme.
- » Fuqizimi i familjes është parësore në adresimin dhe trajtimin e rreziqeve dhe pasojave të varfërisë dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja.

12. Bibliografia dhe Referencat

- » Dekada e Përfshirjes së Romëve në Shqipëri - PKV 2010-2015
- » Praktikant më të Mira të Integritimit të Romëve (BPRI): Raporti Rajonal për Anti Diskriminimin dhe Pjesëmarrja e Romëve në Vendimarrje Lokale, 29 Maj 2013.
- » Raport për situatën e Romëve dhe të Sintëve në zonë e OSBE-së - OSBE, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare.
- » Raport: Situata e Romëve në 11 Shtetet Anëtare të BE (2012).
- » Ma. Elisabeta Osmanaj: "E Drejta për Arsim e komunitetit Rom në kuadër të Integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian".
- » Raport: Të drejtat e njeriut të Komuniteteve Rome dhe Shtegtare në Evropë, Këshillin e Evropës, Shkurt 2012, www.commissioner.coe.int
- » OKB-ja e shqetësuar për situatën e komunitetit Rom në Serbi dhe Mal të Zi. Krijimi i një harte dhe analizim Maestral.
- » Raporti i gjendjes "Zbatimi i planit të veprimit për përmirësimin e gjendjes së Romëve dhe Sintëve brenda zonës së OSBE-së", Shkup, dhjetor 2010.
- » Plani i Veprimit të OJQ-ve për Përmirësimin e Situatës së Romëve në Ballkanin Perëndimor.
- » Udhëzues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Evropë. http://ec.europa.eu/governance/social-ngos_en.pdf.
- » Rrjeti Ndërkombëtar i Kujdesit të Fëmijëve dhe e të Rinjve (CYC-Net).
- » EU, UNICEF - Protokoll i Mbrojtjes së Punës për Fëmijët, Shqipëri, 2015
- » OSBE - Udhëzues i Procedurave për Identifikimin, Ndihmën e Menjëhershme dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Rruge, Tiranë 2015.
- » UNDP - Një studim i vlerësimit të nevojave për komunitetin Rom dhe Egjiptianë në Shqipëri, Tiranë, 29 shkurt 2012.
- » Një studim i vlerësimit të nevojave për komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, Tiranë, 29 shkurt 2012 (Raport i Romëve në Shqip.pdf).
- » Tijana Joksic: Diskriminimi i Romëve në Reagimet e Qeverisë Serbe, 6/18/2015
- » Raport për situatën e Romëve dhe Sintëve Zonën e OSBE-së -Shkup, dhjetor 2010.
- » Udhëzues praktik për OJQ-të për të parandaluar diskriminimin kundër Komunitetit Rom. NET-KARD.
- » Si të implementohen Standartet? – Koalicioni I Mbrojtjes së Fëmijëve të Sigurt- www.keepingchildresafe.org.uk
- » UNDP, INSTAT- Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: Profili socio-demografik dhe ekonomik i bazuar në Censusin e Prillit 2011, 2015
- » Raport i vlerësimit të nevojave në Serbi - Ana Popović, Jelena Stanković, Tetor 2013
- » Tekstin e plotë të Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit të OKB e gjëni në: http://www.ohchr.org/tbru/cescr/Serbia_and_Montenegro.pdf.
- » Një Memorandum të Përbashkët mbi Situatën e të drejtave të njeriut të Romëve në Serbi dhe Mal të Zi, përgatitur nga ERRC dhe Zyra e Komisionerit, të OKB-së, për të Drejtat e Njeriut në Beograd mund ta gjëni në: <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=333>
- » Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shkollë – Fondacioni "Terre des hommes", Kooperacioni Austriak i Zhvillimit, Zvicër.
- » Këshilli për Evropën "Pë të Mbrojtur të Drejtat e Romëve dhe Shtegtarëve", www.coe.int/roma

- » Më shumë angazhim për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Bashkimi Evropian, Prishtinë, Qershor 2013
- » Zhvillimi, Qëndrueshmëria dhe Përfshirja e CSO-ve në Proceset e Pjesëmarrjes - Botuar nga: PDCS, o.z. Partnerët e Shqipërisë për Ndryshim dhe Zhvillim.
- » Rrjeti Ndërkombëtar të Përkujdesjes së Fëmijëve dhe të Rinjve (CYC-Net):
- » <http://www.cyc-net.org/profession/pro-principles.html>
- » Këshilli i Evropës, të Drejtat e Njeriut të Romëve dhe Shtegtarëve, www.coe.int/roma
- » Procedurat Standarte të Riintegritimit të Familjes Retrak, maj 2013
- » Axhenda Kombëtare Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020.
- » http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc faqja 6
- » Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 Shqipëri.
- » UNICEF dhe Qendra për Studime Sociale dhe Ekonomike, Identifikimi i fëmijëve Rom në Shqipëri, 2011
- » Gjendja e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, (KFOS - SOROS), 2009.
- » Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit Rom. Shëndeti i Popullit Rom dhe Monitorimi i Grumbullimit të të dhënave në Shtetet, Anëtare të Bashkimit Evropian, Prill 2014.
- » Protokoll i Mbrojtjes së Fëmijëve: Shqipëri, datë 25.02.2015) /botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/33-2015.pdf
- » Për Standartet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore publike dhe jopublike Vendim Nr. 231, datë 20.03.2013, Shqipëri
- » Standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e së Drejtës dhe Konsumatorët, Njësia C.1: Të drejtat dhe të liritë themelore të fëmijës - Shkurt 2015.
- » Strategjia për Integrimin e Komunitetit ROM, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Komponent Arsimor 2007-2017, Prishtinë, korrik 2007.
- » "Roli aktiv i Organizatave Jo Fitimprurëse në mbrojtjen e të drejtave dhe Lirive përmes instrumenteve ligjore dhe kushtetuese" (Qendra e Nismave Ligjore Qytetare dhe Akademia Shqiptare e Shkencave), Tiranë, 28 Qershor, 2011
- » Strategjia për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.
- » Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut të Romëve dhe grupeve të tjera të prekshme në Mal të Zi, (IPA II) 2014-2020 – Komisioni Evropian

Marrëveshje, Konventa dhe Dokumente Ndërkombëtare të aplikuara:

- » Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj – 3 Shtator 1953.
- » Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.
- » Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj.
- » Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve, 1951 CAT.
- » Konventa kundër Torturës dhe ndonjë trajtimi ose ndëshkimi tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, CDE.
- » Konventa kundër diskriminimit në arsim, 1960 CEDAW.
- » Konventa e OKB-së "Për të drejtat e fëmijës".
- » Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1979 CERD.
- » Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1965.
- » Rekomandimi i Asamblesë Parlamentare 1596 (2003) "Situata e Emigrantëve të Rinj në Evropë".
- » Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 1989 CRS.

- » Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë, 1961.
- » Konventa për ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve, ILO C182, 1999
- » Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
- » Kuadri i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1 shkurt, 1998).
- » Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (10 April, 1997).
- » Protokoll nr.12 për diskriminimin (1 Prill, 2005).
- » Direktiva mbi Abuzimin dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve (2011/93/EU).
- » Axhenda e BE-së për të drejtat e fëmijës.
- » Strategjia e BE-së për zhdukjen e trafikimit të qënieve njerëzore 2012-2016 (COM (2012)286 përfundimtar).
- » Udhëzuesit e BE-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
- » Forumi i BE-së për të drejtat e fëmijës, 2012.
- » Forumi European mbi të drejtat e fëmijës, 2013.
- » Platforma e 8-të Evropiane për përfshirjen e Romëve.
- » Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (2007).

13. ANEKSET

PRAKTIKË E MIRË⁴⁵

Më 2009, Brenda kuadrit të "Zhvillimit të rjetit për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve", organizata zvicerane "Terre des hommes" ngriti Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (CPU) në Shqipëri. Këto njësi funksionojnë si struktura brenda njësive të qeverisjes vendore dhe kanë marrë përgjegjësinë për vetëfinancim. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve trajtojnë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin dhe trafikimin si forma të diskriminimit. Fëmijët e identifikuar nga stafi i CPU-së si fëmijë në rrezik ose që kanë nevojë për mbrojtje ndihmohen duke u dhënë shërbime mbështetëse sipas nevojave të tyre të analizuara. Fëmijët Rom dhe Egjiptianë përbëjnë një nga grupet kryesore të synuara të CPU-së (por jo vetëm) dhe e përbëjnë shumicën e përfituesve të shërbimeve të ofruara nga këto njësi

Themelimi dhe funksionimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri është dëshmuar si një praktikë e suksesshme për mbrojtjen e fëmijëve. Praktika e CPU-ve në mbrojtjen e fëmijëve është zhvilluar në përputhje me Udhëzimin e 4-të Ministror: "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes për të ndihmuar fëmijët me rrezik"⁴⁶ dhe "Udhëzimet për Procedurat e Identifikimit, Ndihma e Menjëhershme dhe Referimi i Fëmijëve në situatë ruge"⁴⁷

Këto udhëzues përmbajnë një tërësi formularësh që lehtësojnë punën e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, institucioneve të tjera shtetërore dhe OJQ-ve për të identifikuar dhe siguruar mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë në rrezik. Disa nga këto formularë (të ofruara si shtojca në këtë udhëzues) mund të jenë të aplikueshme për OJQ-të që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, madje edhe në vende të tjera të rajonit.

45 Praktikrat më të mira për integrimin e Romëve (BPRI): Raporti rajonal kundër diskriminimit dhe pjesëmarrjes së romëve në vendimmarrjen vendore, 29 maj 2013 - Best Practices for Roma Integration (BPRI): Regional Report on Anti-Discrimination and Roma Participation in Local Decision-Making, May 29, 2013

46 Protokollin I Mbrojtjes së Fëmijëve nga Puna EU, UNICEF, Albania 2015 - Labor Protection Protocol for Children, EU UNICEF, Albania 2015

47 Guidë për Procedurat e Identifikimit, Ndihmës së shpejtë dhe Referimin e Fëmijëve në situatë Ruge, OSCE, Tirana 2015 - Guide to Procedures for Identification, Immediate Help and Referral of Children in Street Situation, OSCE, Tirana 2015.

DEKLARATA E PËRSHTATJES SË POLITIKËS PËR SIGURINË E FËMIJËVE

Nga: Persona që janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë, me kohë të pjeshme, vullnetarë (Emri i CSO)

Unë, i/e nënshkruari/a...
me anë të kësaj deklaroj se:

- 1) Që në të kaluarën nuk kam qenë subjekt i ndonjë dënimi për sjellje individuale të papajtueshme me përgjegjësinë e kujdesit ose mbikëqyrjes së fëmijëve apo të miturve dhe asnjëherë nuk janë nënshtruar asnjë masë administrative të hetimit për vepra penale ose shkelje të sjelljes që rrezikojnë integritetin fizik ose psikologjik të fëmijëve;
- 2) Se kam marrë parasysh dokumentin që lidhet me Kodin e Sjelljes (Procedurat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Materialet Mbështetëse) dhe se unë marr përsipër ta respektoj këtë politikë; ky dokument duke u ripërcaktuar vazhdimisht, versioni i fundit do të jetë i arritshëm dhe të gjithë anëtarët e stafit do të këshillohen në mënyrë adekuate për çdo zhvillim të ri;
- 3) Që unë jam informuar se në rast dyshimi për sjellje të papërputhshme me përgjegjësinë për fëmijët dhe në kundërshtim me politikën e parandalimit të krijuar nga OJQ-ja, institucioni rezervon të drejtën për të marrë masa mbrojtëse që përfshijnë pezullimin e përkohshëm;
- 4) Se unë kam qenë i informuar se në rast të dëshmive të qëndrueshme dhe incidenteve të kundërta në mbrojtjen e fëmijëve të vendosur nën përgjegjësinë time, institucioni do të marrë masat e duhura administrative dhe ligjore, pa kufij kohe ose vendi, qoftë në vend ku incidenti është supozuar të ketë ndodhur dhe në vendin tim të origjinës dhe / ose vendbanimin kryesor;
- 5) Që unë jam informuar se në rast të ndërprerjes së kontratës / mandatit për shkak të shkeljes së integritetit fizik dhe / ose psikologjik të fëmijëve, institucioni rezervon të drejtën për të informuar institucionet e tjera që mund të aplikojnë për referenca profesionale të përfundimit të kontratës për shkelje të rëndë të parimeve të mbrojtjes së fëmijëve, në kuadrin ligjor të zbatueshëm për mbrojtjen e informacionit.

Firmosur më (data)

Nënshkrimi :

(Draft i) Plotësimit të Deklaratës

Me anë të kësaj, konfirmoj se i pranoj kushtet e Kodit të Sjelljes dhe Etikës siç u përmend më lart. Unë e kuptoj se mos respektimi i këtij Kodi mund të çojë në ngritjen e dyshimeve ose në ndërprerjen e kontratës së punës.

Emër dhe Mbiemër:.....

Nënshkrimi:.....

Datë.....

SHTOJCA I: Formulari i Referimit për Mbrojtjen e Fëmijës

Ky formular është për t'u përdorur kur bëhet një referim dhe duhet të kompletohet nga institucioni ose nga ofruesi i shërbimit i cili merr referimin lidhur me personin që e bën këtë referim.

FORMULARI I REFERIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Emër dhe Mbiemër/ Identiteti i Fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia:
Emër, Mbiemër dhe adresa e Prindit të parë Kujdestar:	Vendodhja e fëmijës / Ku fëmija jeton:	
Shkolla:	Shërbime të tjera në kontakt me fëmijën (p.sh. shëndeti, etj.)	
Të dhënat për fëmijë të tjerë në shtëpi:		
Histori e shkurtër e famijes: (nëse dihet):		
Arsyet e referimit / Shqetësimi:		
Puna e kryer/Shërbimet e ofruara gjatë 7 ditëve të fundit:		
Emër & Detajet e Kontaktit të Personit që bën Referimin:	Emër & Detajet e Kontaktit të Personit që merr Referimin:	Data e regjistrimit të referimit:

SHTOJCA II – Formulari i Vlerësimit dhe i Analizës së Rrezikut

Ky formular është për të regjistruar informacionin e marrë përmes procesit të vlerësimit. Duhet të shpërndahet paraprakisht në Mbledhjen e Grupit Teknik Multidisiplinar. Disa pjesë të Formularit, si për shembull, niveli i rrezikut, duhet të plotësohet në fund të mbledhjes.

FORMULARI I VLERËSIMIT DHE I ANALIZËS	
Emri dhe Mbiemri i Fëmijës:	Referenca e Identitetit:
Mosha / Data e lindjes:	Gjinia:
Data e plotësimit të vlerësimit dhe e analizës:	Vlerësimi u krye nga:
Përbërja e Familjes/ Anëtarët e familjes:	Adresa e familjes:
Shërbimet/ Agjencitë në kontakt me fëmijën:	Shkolla:
ARSYET E REFERIMIT	
Formimi i familjes / Përmbledhje e shkurtër e historisë së kohëve të fundit/ Ngjarje kritike:	
Zhvillimi dhe Mirëqenia e Fëmijës (fizike, emocionale, njohës, shpirtëror, etj. si dhe çdo nevojë tjetër ndryshe – p.sh. paaftësia):	
Prezantimi i fëmijës dhe lidhjet e tij/saj me të tjerët (përfshirë familjen dhe miqtë):	
Arsimi:	
Aftësia Prindërore & Aftësia për t'u përballur me të:	
Funksionet e Familjes (Marrëdhëniet & Dinamikat):	
Kushtet e Jetesës & Situata Ekonomike/Punësimi:	
Mbështetje nga familja/Komuniteti:	

Histori të Mëparshme Abuzimi:

Nëse referimi bëhet lidhur me një incident specifik, cili është rezultati i hetimit të kryer (nëse është përfunduar)

RREZIQET DHE RISQET PËR FËMIJËN:

Opinionet e Prindërve /Kujdestarëve:

Pikëpamjet/ Dëshirat e Fëmijës:

Burime Shtesë / Mbështetje e disponueshme:

Përparësitë e fëmijës dhe të familjes:

Informacion tjetër lidhur me këtë çështje:

SHTOJCA III – Vizita në Shtëpi/Analizë e Shënimeve në Bllokun e Shënimeve

VIZITA NË SHËTËPI/ANALIZË E SHËNIMEVE NË BLOKUN E SHËNIMEVE

Ky formular është hartuar për të ndihmuar punonjësit që ta përdorin sa më mirë në vizitat e shtëpive duke marrë informacion të mirë strukturuar dhe për të reflektuar mbi këtë informacion të mbledhur se si e gjithë kjo mund të ndikojë në mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës.

SHËNIM – Kur aty përmendet prindi, zakonisht i referohet atij që zakonisht dhe rregullisht kujdeset për fëmijën - për shembull gjyshi / gjyshja

DATA / ORA: MBIEMRI I FAMILJES: PUNONJËSI:

Personat që janë të pranishëm:

	Nuk shfaqet asnjë shqetësim	Shfaqet një lloj shqetësimi	Shfaqet shumë shqetësim	Kommente / Shënime
Ambjenti Fizik				
A është shtëpia e përshtatshme? Për shembull, a ka hapësirë të mjaftueshme? A ka ujë pa shkëputje / po tualet? A është mjaftueshëm ngrohtë?				
A është shtëpia e pastër dhe e rregullt? A ka ndonjë të dhënë që tregon se aty mund të ketë rrezik për shëndetin e fëmijës?				
A ka një vend të përshtatshëm për të fjetur fëmija?				
A ka përreth rreziqe fizike të dukshme apo rreziqe, p.sh. xhama, thika dhe objekte të mprehta ose janë të ekspozuara ndaj një vendi të fshehtë (to a busy road)?				
A ka lodra të përshtatshme për moshën e fëmijës?				

Vrojtim & Sjellja e Fëmijës			
A është fëmija i veshur në mënyrën e duhur?			
A është fëmija i pastër?			
Duke patur parasysh moshën e fëmijës, a shfaq ai/ajo fazat e një zhvillimit normal?			
A është ndërveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm, duke pasur parasysh moshën e tij / saj?			
A është e folura e fëmijës dhe gjuha e përputhshme me moshën e tyre?			
A luan fëmija, ose kalon kohën e tij/saj siç duhet?			
A i ndjek fëmija instruksione /kërkesat?			
A ka shenja abuzimi të tilla si mavijosje ose ndonjë lëndim të pashpjegueshëm?			
A shfaq ndonjë sjellje që mund të konsiderohet shqetësuese apo që nuk mund të konsiderohet si sjellje normale?			

Bashkëveprimi Prind-Fëmijë

A ka ndonjë lloj dashurie fizike ose të përzemërt midis prindit dhe fëmijës?			
A bën prindi komente positive rreth fëmijës në presencë të tij/saj?			
A është bashkëveprimi prind-fëmijë i një lloji udhëzimi (ose kontrollues) apo lejojnë mundësi dhe zgjedhje për fëmijën?			
A kanë prindërit dhe fëmija kontakt drejt e në sy?			
A duket marrëdhënia midis prindërve dhe fëmijës e ngrohtë dhe natyrale (ose a duket fëmija i frikësuar ose i kujdesshëm)?			
A duket fëmija i lumtur?			
A duket të ketë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në sjelljen apo qëndrimin ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?			
Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket marrëdhënia ndërmjet fëmijëve e mirë dhe siç duhet? A është ndonjëri prej tyre që mbizotëron ose ushtron dhunë kundër të tjerëve?			

Prezantim i Prindërve/ Të Rriturve

A tregojnë prindërit pritshmëri joreale për fëmijën dhe sjelljen e tij / saj?			
A flet prindi keq për fëmijën apo ai/ajo duket shumë kritik?			
A duket se prindërit sillen duke ruajtur vetëkontrollin e tyre apo duken sikur janë nën ndikimin e drogës, alkoolit, etj.?			
A ka ndonjë tregues të dhunës në familje brenda familjes			
A ka ndonjë shenjë apo ndonjë vështirësi në marrëdhënien e vendosur midis të rriturve në shtëpi?			
A përmendin prindërit ndonjë sjellje të kujdesit për fëmijët që mund të shkaktojë shqetësim, për shembull, ndëshkimin trupor?			
A ka ndonjë gjë "të çuditshme" ose shqetësuese për prindërimin që mund të sugjerojë praninë e çështjeve shqetësuese, siç janë problemet e shëndetit mendor?			
A ishte prindi agresiv apo mbështetës gjatë vizitës?			

PAS VIZITËS NË SHTËPI

Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?

A patët mundësi të flisni me fëmijën personalisht?
Nëse po, a keni ndonjë gjë që dëshironi flisni dhe të diskutoni?

A ka ndonjë çështje që duhet trajtuar?

Duke menduar për vizitat në shtëpi që keni kryer, a jeni të shqetësuar për mirëqenien dhe sigurinë e fëmijës?
A mendoni se po përballen me ndonjë rrezik? Nëse po, atëherë lutem shpjegoni pse e mendoni këtë?

SHTOJCA IV – Formulari i Analizës së Progresit / Plan Individual për Mbrojtjen e Fëmijës

FORMULARI I ANALIZËS SË PROGRESIT / PLAN INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS			
Emri dhe Mbiemri i Fëmijës:	Data e hartimit të planit:	Data e Analizës së Progresit të Programit:	
Emri dhe Mbiemri i Personit që plotëson Planin:			
Personi Përgjegjës për Monitorimin e Planit të Brëndshëm (deri sa të dale Analiza e Progresit të Programit)			
Plani në rastet e paqartësisë: çfarë veprimesh do të ndërmerren nëse plani nuk mund të zbatohet derisa analiza e progresit të jetë e mundur ose nëse situata e fëmijës ndryshon?			
Lutem konfirmo nëse prindërit / fëmija ishin të pranishëm (nëse jo, si u morën parasysh mendimet e tyre gjatë hartimit të planit?)			
Datat e Analizës së Mëparëshme:			
Shënim: Analiza duhet të ndërmerret – Analiza nr. 1 duhet të kryhet 6 javë pas zhvillimit të planit dhe më pas çdo 3 muaj.			
Ju lutemi listoni nevojat e identifikuara për secilën nga dimensionet. JU LUTEM referojuni analizës dhe vlerësimit dhe jepni detaje se si do të zvogëlohet ose eliminohet çdo faktor rreziku.			
Dimensionet – Janë identifikuar nevojat të veçanta	Shërbimet e domosdoshme që plotësojnë nevojat	Agjencia Përgjegjëse & Afatet kohore.	Përditësim gjatë Analizës / Ndryshimit të Planit.
Nevojat për Ruajtje dhe Siguri:			
Banimi/Akomodimi & Nevojat bazike:			
Shëndeti & Nevojat zhvëllimore (përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike:			

Arsimi & Aftësitë:			
Raportet Sociale:			
Lidhjet familjare: (përfshirë sesi do të mbahen kontaktet nëse fëmija është i shkëputur nga familja)			
Kulturë/ Identitet:			
Nevoja për Aktivitet Qetësuese:			
Çdo metodë tjetër e Veçantë e nevojës (p.sh. Këshillimi, etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës):			

SHTOJCA V – Mbyllja e çështjes

Ky formular duhet të plotësohet dhe të arkivohet në dosje kur çështja të mbyllet.

MBYLLJA E ÇËSHTJES	
Emri dhe Mbiemri i Fëmijës:	Numër Identifikimi:
Arsyet e referimit/ Data e referimit:	
Pse u mbyll çështja? Si ka ndryshuar situata (jepni informacion specifik)	
Perspektiva e Fëmijës/Prindërve lidhur me Mbylljen e çështjes:	
Emrat e atyre të cilët morën pjesë në vendimin për të mbyllur çështjen:	
Data Mbylljes së Çështjes:	





